

Print ISSN 2222-5846
Online ISSN 2312-5349

Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike

REVISTA SHQIPTARE SOCIAL EKONOMIKE
ALBANIAN SOCIO ECONOMIC REVIEW
Revistë Social Ekonomike katërmujore

Viti XXIX, Nr. 3 (112)
(Shtator – Dhjetor 2023)

Tiranë, 2023

QSHKE
QENDRA SHQIPTARE PËR KËRKIME EKONOMIKE
REVISTA SHQIPTARE SOCIAL EKONOMIKE
ALBANIAN SOCIO ECONOMIC REVIEW
Revistë Social Ekonomike katërmujore
Viti i XXIX, Nr. 3 (112)
(Shtator – Dhjetor 2023)

Komiteti shkencor

Dr. Zef PREÇI – Kryeredaktor - Shqipëri
Prof. Dr. Ana Paula FERREIRA FERNANDES LOPES - Portugali
Prof. Dr. Antonio DA SILVA ROBALO - Portugali
Prof. Dr. Dorota WITKOWSKA, Poloni
Prof. Dr. Elena HORSKA, Sllovaki
Prof. Dr. Fatmir MEMAJ - Shqipëri
Prof. Dr. Heinz-Dieter WENZEL - Gjermani
Prof. Dr. Iraj HASH - UK
Prof. Dr. Janez PRAŠNIKAR - Slloveni
Prof. Dr. Justina SHIROKA PULA - Kosovë
Prof. Dr. Luigi D'AMBRA - Itali
Prof. Dr. Nasir SELIMI – Maqedonia e Veriut
Prof. Dr. Statty STATTEV – Bullgari
Prof. Dr. Shyqyri LLACI - Shqipëri
Prof. Dr. Tomasz MROCZKOWSKI - ShBA
Prof. Dr. Yannis TSEKOURAS – Greqi
Prof. Dr. Zhaklina PETO – Shqipëri
Prof. Asoc. Dr. Dorina HOXHA - Shqipëri
Prof. Asoc. Dr. Etleva LEKSKAJ - Shqipëri
Prof. Asoc. Dr. Florian NUTA – Rumani
Prof. Asoc. Dr. Laura TAFARO - Itali
Prof. Asoc. Dr. Zamira SINAJ - Shqipëri

Redaktor:

Prof. Dr. Fatmir MEMAJ

Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike – QSHKE nuk është përgjegjëse për mendimet e shprehura nga autorët në artikujt e tyre. Mendimet janë thjeshtë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë as opinionet e QSHKE-së dhe as qëndrimet dhe opinionet e institucioneve ku autorët punojnë.

Me kërkesë zyrtare të palëve të treta të interesuara, botuesi vë në dispozicion deklaratën e origjinalitetit të nënshkruar prej autorëve të shkkrimeve të botuara.

Adresa e Redaksisë:

Rr. "Ismail Qemali", Nr. 1, Hyrja 1, Kati 3, Ap. 6

Kutia Postare 2934, Tiranë, SHQIPERI

Tel/Fax: 04 2274 603

Tirazhi: 1000 kopje

PËRMBAJTJA

Armend BERISHA Rrezart DEMA	Ndërkombëtarizimi në Shtëpi dhe Efektet e Tij: Rasti i Shqipërisë	f. 5
Ines DIKA Fatmir MEMAJ	Sfida të Arsimit Profesional në Shqipëri	f. 11
Armira LAZAJ Ejona DUCI Albra SHPATI	Një qasje teorike e investimeve të huaja direkte dhe rritjes ekonomike në ditët e sotme në vendet në zhvillim	f. 19
Evis KUMI	Ndikimi i sistemit tatimor shqiptar në ekonominë e vendit	f. 29
Zhaneta NDREGJONI Liljana ELMAZI (BILLA)	Matja e ndikimit të faktorëve që i kanë shtyrë kompanitë të adoptojnë aplikacione për tregtinë elektronike	f. 35
Enriko CEKO	Spektori i turizmit në Ballkanin Perëndimor dhe një analizë deskriptive për Indeksin e Turizmit Kuptimplotë	f. 45
Blerina VIKA Dhimitri TOLE	Kornizë e të mësuarit të thellë për parashikimin e serive kohore me një ndryshore për një apo shumë hapa përpara	f. 57
Iva SULAJ Brunela TREBICKA	Strategjia "Çmimi sipas tregjeve". Një qasje teorike	f. 71
	Komiteti shkencor	f. 81
	Recenzentë në këtë numër	f. 86
	Kriteret për botimin e artikujve	f. 87

NDËRKOMBËTARIZIMI NË SHTËPI DHE EFEKTET E TIJ: RASTI I SHQIPËRISË

Armend BERISHA¹ & Rrezart DEMA²

Abstract

This paper attempts to discuss the relatively novel concept of Internationalization at Home and more specifically tries to put this process in the context of Albania. The paper first attempts to conceptualize Internationalization at Home as there are continuous efforts to define the concept and its scope in particular. Furthermore, there has been made an attempt to showcase both merits and demerits of the phenomenon. As presented in the paper, while Internationalization at Home has been designed in such a way as to positively impact higher education institutions in various capacities, there are also disadvantages and difficulties in particular when thinking about its practical implementation. The advantages of Internationalization at Home mainly lie in its ability to foster internationalization of higher education institutions, but also in promoting inclusion and reducing differences between different categories of students. On the other hand, perhaps the most important difficulty is the fact that many countries lack the proper infrastructure which would allow for this process to thrive. The final part of the paper links Internationalization at Home process with the country Albania. There is discussion regarding the attempts of the country to provide the necessary infrastructure for such processes to thrive. In addition to this, there are clear governmental efforts toward fulfilling the requirements of European Union in many areas and subsequently this includes efforts in the area of education. Again, Internationalization at Home represents a novel concept in general, but it is in its particularly early phases in the context of Albania.

Hyrje

Ndërkombëtarizimi në shtëpi (Internationalization at Home) përfaqëson një proces të rëndësishëm në drejtim të shkëmbimit të praktikave drejt ngritjes së standardeve në veprimtarinë e institucioneve të edukimit të lartë. Në këtë drejtim, edhe shteti i Shqipërisë nuk është imun ndaj praktikave të tilla që tashmë mund të thuhet janë të një karakteri global. Në fakt, shumë institucione në tërë Ballkanin dhe rrjedhimisht edhe në Shqipëri duket që janë duke përqaftuar idenë e ndërkombëtarizimit. Prandaj, duke u nisur nga ky realitet, ky punim tenton që të analizojë konceptin e ndërkombëtarizimit në shtëpi duke vënë në pah rëndësinë e tij por njëkohësisht duke analizuar edhe meritat dhe problemet e asociuara me një proces të tillë. Në rrethanat e mungesës evidente të literaturës në këtë drejtim, punimi tenton edhe që në një formë të kontekstualizojë procesin e ndërkombëtarizimit në shtëpi duke e ndërlidhur atë me shtetin e Shqipërisë. Në fund të punimit do të ofrohen edhe disa rekomandime të cilat supozohet që do të shërbejnë në drejtim të krijimit të një klime të mendimit kritik kundrejt implementimit sa më efektiv të praktikave të ndërlidhura me ndërkombëtarizimin në shtëpi.

Ndërkombëtarizimi në Shtëpi

Para se të vazhdohet me diskutimin lidhur me atë se çfarë përfshin në vete procesi i ndërkombëtarizimit në shtëpi, është e rëndësishme që të ofrohet një definicion lidhur

¹ Universum International College

² Universum International College

me këtë koncept. Definicioni më i pranueshëm deri më tani për ndërkombëtarizimin në shtëpi ofrohet nga Knight dhe e konsideron atë si procesi i integritit të një dimensionit ndërkombëtar, ndërkulturor ose global në qëllimin, funksionet ose ofrimin e arsimit pas të mesëm." (Knight, 2004). Elemente të forta të këtij përkufizimi janë perceptimi i ndërkombëtarizimit si proces dhe përmendja e dimensioneve ndërkombëtare dhe ndërkulturore të përfshira në kurrikulë. Ky përkufizim konsiderohet gjithashtu mjaft i gjerë sa për të përfshirë të gjitha aktivitetet e një universiteti bashkëkohor (Beelen & Jones, 2015).

Ndërlidhur me këtë, është po ashtu me rëndësi që të përmenden edhe aspektet e asocuara me ndërkombëtarizimin në shtëpi. Një artikull i titulluar "Internationalisation at Home" liston këto elemente si pjesë e këtij procesi: a) u ofron të gjithë studentëve perspektiva globale brenda programit të tyre të studimit, pavarësisht nëse ata kalojnë ose jo kohë jashtë vendit; b) është pjesë e kurrikulës së institucioneve dhe u ofrohet barabartësisht të gjithë studentëve; c) mbështetet nga aktivitetet informale (bashkë) kurrikulare në të gjithë institucionin; d) përdor me qëllim diversitetin kulturor në klasë për praktikën e mësimdhënies dhe vlerësimit gjithëpërfshirës duke ndihmuar studentët që të kuptojnë realitetin global; e) Përfshin të gjithë stafin, jo vetëm akademikët dhe zyrën ndërkombëtare; f) mund të përfshijë lëvizshmërinë virtuale përmes punës në internet me universitetet partnere; g) nxit angazhimin me studentët ndërkombëtarë (Jones & Reiffenrath, 2018). Një diversitet i tillë i aspekteve të ndërlidhura me ndërkombëtarizimin në shtëpi dëshmojnë për natyrën gjithëpërfshirëse të ndërkombëtarizimit në shtëpi dhe potencialit të këtij fenomeni për të patur ndikim potencial në edukimin e lartë.

Duhet theksuar që koncepti i ndërkombëtarizimit në shtëpi së paku në dekadën e fundit por edhe më herët ka gjetur një zbatim të gjerë në kontekstin evropian. Në nivel politikash, ndërkombëtarizimi në shtëpi paraqet një fushë prioritare kyçe të politikës së Komisionit Evropian për bashkëpunimin ndërkombëtar në arsim dhe trajnim me vendet jashtë BE-së, përkatësisht nëpërmjet mbështetjes së ofruar nga Komisioni për të ndihmuar institucionet e edukimit të lartë drejt ndërkombëtarizimit. Prandaj komunikimi i Komisionit 'Arsimi i Lartë Evropian në Botë' (2013) ka bërë të ditur tre fushat e tij të veprimit: (1) lëvizshmëria e studentëve dhe stafit; (2) ndërkombëtarizimi dhe përmirësimi i kurrikulave dhe mësimi dixhital; dhe (3) bashkëpunimi strategjik, partneritetet dhe ngritja e kapaciteteve nëpër institucione (Almeida et al., 2018). Në këtë drejtim, derisa shteti shqiptar bënë përpjekje të intensifikojë përpjekjet për evropianizim dhe rrjedhimisht për integrim të procesit të ndërkombëtarizimit në shtëpi, tashmë mund të thuhet që është bërë evidente rëndësia e një procesi të tillë dhe rrjedhimisht edhe rëndësia e kuptimit dhe integritit të mëtejshëm të tij.

Efektet Pozitive të Ndërkombëtarizimit në Shtëpi

Literatura e ndërlidhur me ndërkombëtarizimin në shtëpi jep shpjegim edhe lidhur me përfitimet ose avantazhet e asocuara me këtë proces. Natyrisht, ndërkombëtarizimi në shtëpi ka në qendër procesin e ndërkombëtarizimi në përgjithësi dhe rrjedhimisht edhe praktikën integruese. Në këtë mënyrë, ndërkombëtarizimi në shtëpi do të mund të

përdorej për të ndërtuar praktika më inkluzive të ndërlidhura me procesin e pranimit të të gjithë studentëve e veçanërisht të grupeve të marginalizuara (Muniz & Borg, 2022). Në këtë mënyrë, vërehet një komponente e qartë e ndërkombëtarizimit në shtëpi si një mjet për unifikim brenda institucioneve të arsimit të lartë.

Artikulli “Internationalization at Home: Developing Global Citizens Without Travel” liston një sërë përfitimesh që asocohen me procesin e ndërkombëtarizimit në shtëpi që kanë të bëjnë me ndërkombëtarizimin në shtëpi si një mjet i cili promovon qëndrueshmërinë dhe frymën bashkëpunuese. Ndërkombëtarizimi në shtëpi është parë edhe si rezultat i synimeve të përcaktuara në 17 objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (SDGs). Këto synime kanë nxitur diskutime të mëtejshme në sektorin e arsimit të lartë rreth mënyrave se si universitetet mund të luajnë një rol kyç në përmirësimin e qëndrueshmërisë së aktiviteteve dhe veprimeve të tyre. Kjo përfshin edhe përpjekjet për të zvogëluar ndikimin mjedisor të udhëtimit ndërkombëtar të studentëve dhe stafit. Përveç kësaj, institucionet inkurajohen të marrin në konsideratë rolin e tyre në promovimin e paqes. Ky aspekt është i rëndësishëm në kontekstin e bashkëpunimit të tyre me komunitetin lokal dhe organizatat tjera në nivel global. Gjithashtu, është e rëndësishme të ndihmohet në kuptimin dhe respektimin reciprok të kulturave të ndryshme për të arritur këto qëllime (Partridge, 2021)

Më tej, një raport tjetër i cituar nga Partridge i cili ka përfshirë institucione të cilat operojnë në SHBA, Britani të Madhe dhe Australi përmend një sërë përfitimesh të cilat ndërlidhen me ndërkombëtarizimin në shtëpi dhe përfshijnë: përfshirjen, qëndrueshmërinë, integrimin dhe të kuptuarit e përbashkë, më shumë mundësi për të përmirësuar proceset mësimore, rritjen e shkathësisë në përgjithësi për studentët dhe po ashtu edhe potencialin për të rritur bashkëpunimin mes një sërë mekanizmash të ndryshëm (2021). Duhet përmendur që ky raport shërben edhe si një lloj argumenti tjetër lidhur me natyrën gjithëpërfshirëse të procesit të ndërkombëtarizimit në shtëpi. Një referencë tjetër për rëndësinë e procesit të ndërkombëtarizimit në shtëpi është edhe artikulli “Innovations in Internationalization at Home” i cili diskuton rëndësinë e një procesi të tillë. Sipas këtij artikulli, ndërkombëtarizimi në shtëpi është relevant edhe për atë që arrin të sjellë një komponente ndërkombëtare për studentët të cilët ndonjëherë mund të jenë skeptikë lidhur me idenë e studimeve jashtë vendit. Më tej, ndërkombëtarizimi në shtëpi dhe ndërkombëtarizimi në shtëpi është parë si i favorshëm edhe në dritën e parandalimit të paragjyqimeve mes kulturave të ndryshme dhe në këtë mënyrë edhe si faktor i praktikave integruese (Manning & Colaiacomo, 2021). Këto argumente dëshmojnë për rolin bashkues dhe transformues të ndërkombëtarizimit në shtëpi duke konfirmuar gjithmonë rolin e rëndësishëm të këtij procesi.

Sfidat e Ndërlidhura me Procesin e Ndërkombëtarizimit në Shtëpi

Natyrisht, procesi i ndërkombëtarizimit në shtëpi është shoqëruar edhe me sfida të ndryshme të cilat natyrisht meritojnë vëmendje. Kritika e parë dhe ndoshta edhe më përmbajtësore në drejtimin të ndërkombëtarizimit në shtëpi është që nuk ekziston një qasje e drejtë lidhur me atë se si do të duhej të funksiononte një proces i tillë në rast të

implementimit në një kontekst të caktuar (Weissova, 2021). Më tej, Weissova vazhdon me kritikën kundrejt ndërkombëtarizimit në shtëpi duke theksuar që ky proces është perceptuar nga shtetet tjera si një proces me një lloj fokusi ose karakteri perëndimor. Njëkohësisht, ndërkombëtarizimi në shtëpi është kritikuar edhe si iniciativë e cila nuk i ka shërbyer një qëllimi më të lartë por që e cila është shndërruar në iniciativë në vete. Vlen të theksohet që ndërkombëtarizimi në shtëpi është kritikuar edhe si një lloj nisme e cila ka qenë me një lloj natyre moraliste dhe që në fakt nuk ka arritur që të zbatojë atë që ka predikuar (2021). Një kritikë e tillë sugjeron që ndërkombëtarizimi në shtëpi në vete paraqet një lloj procesi me karakter amorf dhe që ende ka nevojë për më shumë definim në mënyrën e ndërtimit dhe funksionimit të tij.

Është mirë të theksohet që ndërkombëtarizimi në përgjithësi si proces është kritikuar edhe nga një lloj këndi socio-ekonomik. Më konkretisht, procesi i ndërkombëtarizimit në shtëpi ka një prirje të natyrshme që të kushtëzohet edhe nga rrethanat ose më saktë vështirësitë socio-ekonomike të shteteve të cilat mëtojnë të zbatojnë një proces të tillë. Vendet e botës së tretë në mënyrë të veçantë përballen me probleme të ndryshme si mungesë të politikave të zbatimit të ndërkombëtarizimit në shtëpi, mungesë të infrastrukturës përkatëse për të bërë zbatimin e këtyre proceseve. Njëkohësisht, procesi i ndërkombëtarizimit në shtëpi është kushtëzuar edhe nga problemet e ndërlidhura me teknologjinë informative e po ashtu edhe nga sfidat e ndryshme kulturore që pengojnë pranimin e procesve të tilla (Moshtari & Safarpour, 2023). Këtu mund të vërehet se idealizmi i ndërlidhur me procesin e zbatimit të ndërkombëtarizimit vazhdimisht kushtëzohet nga rrethanat praktike që përgjithësisht limitojnë suksesin e një procesi të tillë.

Shqipëria: Gjendja Socio-Ekonomike dhe Përpjekjet në Fushën e Edukimit të Lartë

Shqipëria është angazhuar në zbatimin e reformave të rëndësishme strukturore me qëllim të promovimit të zhvillimit të barabartë, rritjes së produktivitetit dhe konkurrencës në ekonomi, krijimit të më shumë vendeve të punës, si dhe përmirësimit të qeverisjes dhe shërbimeve publike. Përveç kësaj, përmirësimi i lidhjeve dhe aksesit në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare, së bashku me rritjen e eksportit dhe diversifikimin e tregut, mund të kontribuojë në ndihmën e shpejtësisht të rritjes ekonomike. Pas tejkalimit të pasojave të tërmetit të vitit 2019, pandemisë dhe krizës së çmimeve, fokusi i qeverisë shqiptare është tani në rimëkëmbjen e plotë me theks të veçantë në turizëm, bujqësi dhe dixhitalizimin (Banka Botërore, 2022). Kjo situatë në dukje të parë shpresëdhënëse është e rëndësishme në sensin që shërben si të paktën si një lloj konteksti përgjithësisht i favorshëm për përpjekjet fillestare të institucioneve të edukimit të lartë për ndërkombëtarizimin e specifikisht për proces të ndërkombëtarizimit në shtëpi.

Duhet të theksohet që ekziston kërkim, ndonëse i limituar, për efektet ekonomike të ndërlidhura me edukimin e lartë në vendet e Ballkanit Perëndimor. Studimi “The Contribution of Higher Education to Economic Growth of Western Balkans: Evidence from Kosovo, Albania, North Macedonia, and Montenegro” dëshmon që edukimi i

lartë në këto shtete ka një efekt pozitiv në rritjen ekonomike të këto shtete (Osmani & Jusufi, 2022). Studime të tilla ofrojnë një lloj baze për një lloj optimizmi të matur mbi perspektivën e nismave që kanë të bëjnë me ndërkombëtarizimin dhe ndërkombëtarizimin në shtëpi. Pra, në një formë mund të diskutohet që konteksti i edukimit të lartë në Shqipëri nuk do të mund të përceptohej si pengesë në vete për fillimin e krijimit të një baze për ndërkombëtarizimin në shtëpi si proces.

Në lidhje me kontekstin përgjithësisht të favorshëm për implementimin e ndërkombëtarizimit, duhet theksuar që shteti shqiptar tashmë që disa vite ka përqafuar nismat që kanë të bëjnë me “evropianizimin” e edukimit të lartë. Institucionet e Arsimit të Lartë Shqiptar kanë vazhduar zbatimin e projekteve në vazhdim të programeve Tempus, Erasmus Mundus dhe Jean Monnet. Shqipëria i kushtoi një vëmendje të veçantë angazhimit në grupet e punës, organizmat dhe projekteve të Bashkimit Evropian për të mundur shkëmbimin e praktikave më të mira evropiane dhe atyre të vendeve të Zonës Evropiane të Edukimit të Lartë në reformën e arsimit të lartë. Angazhime të tilla të Shqipërisë përfshijnë angazhimin në një sërë mekanizmesh për përmirësimin e arsimit të lartë. Pjesëmarrja e tyre ka rivendosur kontaktet duke bërë të mundur pjesëmarrjen e Shqipërisë në Eurostudent VI dhe anëtarësimin e vendit në EQAR si anëtarësi qeveritare (Komisioni Evropian, 2022). Iniciativa të tilla qeveritare për integrimin e arsimit të lartë shqiptar në mekanizmat evropiane nënkuptojnë qëndrimin proaktiv të shtetit shqiptar për të inkuorporuar me sukses nismat që ndërlihdhen me ndërkombëtarizimin në shtëpi dhe ndërkombëtarizimin në përgjithësi.

Konkluzione

Ky punim përbën një përpjekje drejtuar shqyrtimit të procesit të ndërkombëtarizimit në shtëpi. Siç edhe është vënë re në këtë përmbledhje, ndërkombëtarizimi në shtëpi përfaqëson një proces si kompleks ashtu edhe gjithëpërfshirës. Ky karakterizim vjen nga synimi i përpjekjeve të ndërkombëtarizimit në shtëpi për të ndikuar një sërë aspektesh të veprimtarisë së institucioneve të edukimit të lartë por njëkohësisht duke shërbyer si një influencë përgjithësisht pozitive për shtetet që janë duke përqafuar një proces të tillë. Përtej shpjegimit të përgjithshëm të ndërkombëtarizimit në shtëpi, punimi pati një fokus në shtetin shqiptar dhe analizimit të tij si kontekst për vendosjen dhe zhvillimin e praktikave të ndërlihdura me ndërkombëtarizimin në shtëpi.

Në punim është diskutuar mbi definimin e duhur të ndërkombëtarizimit në shtëpi dhe proceset e ndërlihdura me këtë koncept. Duhet të theksohet që ndërkombëtarizimi në shtëpi paraqet një proces i cili mund të konsiderohet gjithëpërfshirës por njëkohësisht edhe jo i përcaktuar saktë sa i përket fushëveprimit të tij. Më tej, është diskutuar edhe mbi avantazhet e implementimit të praktikave të ndërkombëtarizimit në shtëpi të cilat në masë të madhe kanë të bëjnë me ofrimin e një aspekti ndërkombëtar në kontekstet në të cilat vepron. Natyrisht, si çdo proces tjetër ndërkombëtarizimi në shtëpi shoqërohet edhe me sfida të ndryshme ose praktikalitete që kanë një prirje për të komplikuar zbatimin e suksesshëm të procesit. Natyrshëm, këto sfida janë më të theksuara në vendet të cilat përballen me probleme të natyrës socio-ekonomike.

Në fund të punimit ofruam edhe një përshkrim mbi mjedisin përgjithësisht të favorshëm të shtetit shqiptar për implementimin e ndërkombëtarizimit në shtëpi në institucionet e edukimit të lartë. Kjo në masë të madhe vjen edhe nga vullneti i shtetit shqiptar për të përqafuar evropianizimin e edukimit të lartë. Një proces i tillë më pas ka edhe potencialin që të ndikojë pozitivisht në vetë gjendjen ekonomike të vendit. Siç edhe është parë, një gjë e tillë mbështetet nga literatura ekzistuese te vendet e Ballkanit Perëndimor. Natyrisht, edhe pse ndërkombëtarizimi në shtëpi paraqet një koncept të ri në përgjithësi e veçanërisht në kontekstin shqiptar, pa dyshim që ekziston potenciali për implementimin praktik të suksesshëm të tij.

Rekomandime

Disa rekomandime mbi zbatimin efektiv të ndërkombëtarizimit në shtëpi në Shqipëri:

- 1) Zhvillimi i një strategjie të qartë për internacionalizimin në kuadër të institucioneve arsimore dhe qeverisjes së arsimit.
- 2) Përmirësimi i infrastrukturës dhe resurseve të institucioneve arsimore për të përmirësuar shkëmbimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.
- 3) Promovimi i programeve të studimit dhe trajnimeve të orientuara ndërkombëtarisht në nivelin e bachelor dhe master.
- 4) Inkurajimi i gjuhëve të huaja në mësimdhënie dhe ofrimi i kurseve të gjuhëve të huaja.
- 5) Ndihma për studentët dhe stafin akademik në marrjen e burseve ndërkombëtare dhe programeve të shkëmbimit.
- 6) Krijimi i partneriteteve strategjike me institucione të huaja për hulumtim dhe zhvillim të përbashkët.
- 7) Organizimi i konferencave dhe ngjarjeve ndërkombëtare për të promovuar punën dhe hulumtimin shkencor të bërë në vend.
- 8) Përmirësimi i përshtatshmërisë së kurrikulave shkollore për të adresuar sfidat dhe mundësitë e tregu ndërkombëtar.
- 9) Inkurajimi i studimeve të drejtura nga tregu dhe aplikimi i praktikave të mira ndërkombëtare në menaxhimin e universiteteve.
- 10) Monitorimi i ndikimit të ndërkombëtarizimit në nivelin lokal dhe ndërkombëtar për të vlerësuar efikasitetin dhe arritjet.

Sfida të Arsimit Profesional në Shqipëri

Prof. Asoc. Dr. Ines DIKA dhe Prof. Dr. Fatmir MEMAJ

Abstract

This article deals with some problems of vocational education in Albania.

First, the article deals with the history of the development of vocational education in Albania, focusing on the treatment of problems and challenges. In the following, the geographical distribution of this education as well as the requested and offered specialties are discussed.

A special place in the article is the analysis of the survey made with a questionnaire for the various actors that influence the vocational education in Albania.

Finally, the article closes with relevant conclusions.

Hyrje

Arsimi profesional (AP) ka qenë dhe është një sektor me rëndësi të madhe në kuadrin e zhvillimit të kapitalit human dhe është një prioritet në Strategjinë Kombëtare të Arsimit. Në këtë kuadër është e nevojshme që në të gjithë Shqipërinë të mund të ofrohet shërbimi i AP sipas nevojave lokale si dhe të tërhiqen ata studentë të cilët të paisur me njohuritë, aftësitë dhe zotësitë e duhura mund të integrohen në tregun e punës. Për të arritur deri në një rezultat të tillë, është e nevojshme që të ndërtohet një sistem i integruar i AP ku në mënyrë organike të mund të kombinohen inputet e këtij sistemi, proceset e transformimit dhe rezultatet për nxënësin në veçanti e përfitimet

1. Metodologjia

Të dhënat e këtij artillulli janë bazuar në një strategji kërkimi e mbështetur në kërkimin primar dhe sekondar. Fillimisht janë analizuar studime dhe raporte në fushën e AP si dhe baza ligjore dhe udhëzimet për arsimin në përgjithësi dhe AP në veçanti. Ky rishikim dokumentesh të rëndësishëm bashkë me rishikimin e literaturës bashkëkohore të fushës, kanë shërbyer si bazë për ndërtimin e një interviste gjysëm të strukturuar që është zhvilluar me tre target grupe të ndryshme: shkollat profesionale (publike e jo publike) në gjithë Shqipërinë, përfaqësues të institucioneve shtetërore që ndikojnë në politikat e financimit të AP si dhe përfaqësues të aktorëve ndërkombëtarë që kanë ndërmarrë projekte me influencë në fushën e AP. Të dhënat e përfuara janë përpunuar dhe nga ato kanë derivuar përfundime interesante lidhur AP, rolin e gjithsecilit aktor të intervistuar dhe mënyrës se si ai/ajo e percepton mardhënien me aktorët e tjerë, politikat e planifikimit, ekzekutimit, monitorimit dhe vlerësimit të efektivitetit të AP.

2. Situata e arsimit profesional

2.1. Këndvështrim historik i zhvillimit të arsimit profesional në Shqipëri

Arsimi Profesional në Shqipëri është karakterizuar nga tipare të ndryshme në periudha të ndryshme të zhvillimit ekonomik, politik e social të vendit. Etapa e parë e zhvillimit të AP në Shqipëri i përket periudhës para çlirimit (1921-1944) që përkon me hapjen e shkollave të para teknike apo profesionale. AP pas çlirimit deri në fillim të viteve '90 ishte në shërbim të ekonomisë socialiste. Në atë periudhë, në mënyrë të centralizuar përcaktoheshin lëndët dhe kurikulat nga Instituti i Studimeve Pedagogjike; lista e

profesioneve sipas nevojave të ekonomisë si dhe botoheshin librat nga Shtëpia Botuese e Librit Shkollor. Pjesëmarrësit në AP ishin jo vetëm të rinjtë por dhe punonjësit me arsim të ulët (8 vjeçar) të cilët ndiqnin shkollat teknike me kohe të pjesëshme, ndryshe të njohura si shkollat e natës (Mustafarai 2006). Gjatë kësaj periudhe, deri në vitin '90 numri i shkollave profesionale arriti deri 308 shkolla dhe mbizotëronin shkollat bujqësore që reflektonin strukturën e ekonomisë shqiptare të para tranzicionit. (Veirtel, Nikolovska, 2010)

Tabela 1. Të regjistruar në arsim sipas viteve

Viti shkollor / akademik	2018-19	2019-20	2020-21	2021-22	2022-23
Gjithsej:	641,161	612,534	589,604	577,869	554,222
Në Kopshte	78,942	77,858	71,332	72,384	69,750
Në arsimin 9 vjeçar:					
<i>Në fillore</i>	167,104	162,170	158,528	154,140	146,962
<i>Në ciklin e lartë të arsimit bazë</i>	139,426	132,709	127,958	123,998	120,313
Në arsimin e mesëm:	116,646	109,533	107,989	103,467	95,845
<i>Gjimnaz dhe Social-Kulturor</i>	95,359	89,869	88,965	85,188	79,032
Profesional	21,289	19,664	19,024	18,279	16,813
Në arsimin e lartë	139,043	130,264	123,797	123,880	121,352

Burimi: Të dhënat administrative nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Tranzicioni i pas viteve '90 i shoqëruar me ndryshmet ekonomike strukturore, migrimin e popullsisë, prezantimi i ekonomisë së tregut, hapja kufijve, privatizimi i sektorëve strategjikë, lejimi i pronës private etj., u shfaq dhe në AP ku ndryshimi më drastik ishte mbyllja e numrit më të madh të shkollave teknike, kryesisht atyre bujqësore në fshatra dhe në një pjesë të rasteve kthimi i tyre në shkolla të përgjithshme. Dëmtimi i shkollave teknike në qytete dhe rënia e kërkesës për teknike, çoi në rënie e numrit të të regjistruarve në shkollat profesionale krahasuar me shkollat e përgjithshme (Llaci, et. al 2009).

Nga 308 shkolla profesionale (shumica e tyre me profil bujqësor) me 148.185 nxënës në vitin akademik 1990-1991, në vitin akademik 2009-2010 vetëm 20006 nxënës studjonin në 41 shkolla teknike. Ky nivel regjistrimi është modest krahasuar me vendet OECD ku AP zë rreth 49% të numrit të nxënësve të shkollave të mesme (MASH 2007).

2. Gjendja aktuale e arsimit profesional

2.1 Shpërndarja gjeografike dhe e specialiteteve

Arsimi Profesional në Shqipëri është “me bazë shkollore” dhe ofrohet në 41 shkolla profesionale, si dhe në disa shkolla të mesme të përgjithshme (në këto të fundit, vetëm për drejtime mësimore të veçanta). Veprimtaritë profesionale të nxënësve realizohen kryesisht në mjediset e praktikave profesionale të shkollave (reparte, laboratorë, zyra mësimore, ferma etj.) por edhe në mjediset punuese të bizneseve lokale (pjesërisht).

Numri mesatar i nxënësve për shkollë është rreth 300 nxënës. Edhe oferta e shumicës së shkollave profesionale është nga 2 deri në 4 drejtime/profile mësimore.

Oferta e AFP ka pësuar ndryshime të ndjeshme gjatë viteve të fundit për tu përshtatur me ndryshimet në kërkesat e tregut të punës dhe me zhvillimet demografike. Ka ndryshuar përmbajtja e kësaj oferte, disa drejtime mësimore nuk ofrohen më dhe të tjera kanë gjetur një përhapje më të madhe. Tipari bazë është kalimi nga drejtimet mësimore që i referohen profesioneve prodhuese, drejt drejtimeve mësimore që kanë të bëjnë me shërbimet (ekonomi dhe biznes, hoteleri dhe turizëm, mirëmbajtje dhe riparim, teknologji informimi dhe komunikimi etj.)

Rreth 25% e shkollave profesionale ofrojnë 1-3 drejtime/profile mësimore dhe po kështu, rreth 25% e tyre ofrojnë 8-13 profile mësimore. Tipar i shkollave profesionale është se ato janë përgjithësisht “të specializuara”, pra, edhe kur ofrojnë një numër relativisht të madh drejtimesh/profilesh, ato i referohen një sektori të caktuar të ekonomisë.

Nga analiza e të dhënave vihet re që shpërndarja e ofertës numerike të AP publik përgjithësisht përputhet me përqendrimin e popullsisë në zonat urbane. Kështu, shkollat profesionale publike që ndodhen në trekëndëshin Tiranë-Durrës-Elbasan (ku është e përqendruar mbi gjysma e popullsisë së vendit), ndiqen nga rreth 45% e totalit të nxënësve në AP. Përsa i takon shpërndarjes gjeografike të shkollave profesionale publike, vihet re që shkollat profesionale janë të përqendruara në zonat urbane më të populluara (Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Korçë).

2.2. Aftësi/specialitete të kërkuara vs. të ofruara

Pas një krahasimi të ofertës së AP publik referuar strukturës së re dhe ofertës për punë në nivel kombëtar, vihet re që:

- Oferta maksimale për punë i referohet industrisë përpunuese (31%) ndërsa oferta e AP për profesione të këtij sektori (përpunim druri, teknologji ushqimore dhe tekstil-konfeksione) është rreth 5%.
- Oferta për punë në sektorin e shërbimeve-riparimeve-tregtisë është 26% ndërsa oferta e AP për këtë sektor (hoteleri-turizëm, elektroteknik, mekanik, shërbime mjetes transporti,) është rreth 24%.
- Oferta për punë në sektorin e ndërtimit është 8% ndërsa oferta e AP për këtë sektor (ndërtim, gjeodezi, termohidraulikë) është rreth 6%.
- Oferta për punë në sektorin e informimit dhe komunikimit është 19% ndërsa oferta e AP për këtë sektor (TIK, elektronikë) është rreth 18%.
- Oferta për punë në sektorin e administratës publike, shërbimeve financiare dhe shërbimeve social shëndetsore është rreth 5% ndërsa oferta e AP për këtë sektor (ekonomi-biznes, administrim zyre, shërbime social shëndetsore) është rreth 5%.

Në nivel rajonal, ka shumë raste të mospërputhjes së ofertës me kërkesën. Kështu p.sh., në Tiranë qarkullojnë më shumë 35% e automjeteve të vendit, ndërsa në drejtimin mësimor “Shërbime mjetes transporti” të shkollave profesionale të këtij rajoni janë të regjistruar rreth 20% e nxënësve të këtij drejtimi. Gjithashtu, në Tiranë, asnjë shkollë

nuk ofron drejtimin mësimor “Mekanik”, megjithëse pjesa më e madhe e industrisë mekanike dhe e shërbimeve të këtij sektori janë të përqendruara në këtë rajon. Nëse analizojmë ofertën e AP publik në rajonin e Vlorës, vihet re që, megjithëse ndërtimi përbën një veprimtari ekonomike të rëndësishme, AP në drejtimin “Ndërtim” (me strukturën e re) ndiqet nga pak nxënës. Gjithashtu, ofertës së shkollave profesionale i mungojnë edhe drejtime të tilla të rëndësishme si “Bujqësi”, “Teknologji ushqimore”, “Pyje” etj., për të cilat ka të dhëna që ka kërkesa në tregun e kualifikimeve profesionale në rajonin e Vlorës. Në mënyrë të ngjashme, mund të evidentohen mangësitë e ofertës së AP publik edhe në Durrës (ku mungon “Bujqësia” apo “Elektronika”), në Elbasan (ku mungon “Mekanika” apo “Elektronika”), në Fier (ku mungon “Ekonomi biznesi” apo “Teknologjia ushqimore”), në Berat, (ku mungon “Përpunim druri” apo “Ndërtimi”) etj. Këto mangësi të ofertës së AP janë akoma më të theksuara në rajone të tilla si Gjirokastra, Saranda, Kukësi, Peshkopia, Pogradeci, Lushnja, Kuçova, Kavaja, Lezha etj., që kanë vetëm nga një ose dy shkolla profesionale me pak nxënës, të cilat ofrojnë vetëm disa drejtime mësimore të caktuara. Janë disa drejtime/profile mësimore të cilat janë ofruar më parë nga AP publik dhe tashmë nuk ofrohen më me strukturën e re të AP në asnjë nga shkollat profesionale publike, megjithëse konsiderohen drejtime për të cilat ka nevoja në treg. Të tilla janë drejtimet që kanë të bëjnë me peshkimin, teknologjinë kimike, poligrafinë, gjeologjinë dhe minierat, nxjerrjen dhe përpunimin e naftës etj.

3. Analiza e rezultateve

3.1 Profil i subjekteve të intervistuar

Ndër kategoritë e përfshira në studim janë Shkollat Profesionale, disa përfaqësues të institucioneve publike politikëbërëse në arsim si dhe disa aktorë të huaj. Më poshtë paraqitet profili i grupit të të intervistuarve.

Shkollat profesionale Në studimin e ndërmarrë, janë përfshirë si shkolla **jobpublike** dhe **publike**. Kjo për të treguar diferencën e sistemit të financimit mes institucioneve të ndryshme si dhe me qëllim marrjen e eksperiencave të ndryshme. Shkollat teknike përbëjnë rreth 10% të shkollave të intervistuar, ndërsa shkollat publike të studiuara janë 90% të totalit të shkollave të studiuara.

Shpërndarja gjeografike e shkollave të përfshira në studim është në të gjithë Shqipërinë dhe është vizituar minimalisht një shkollë në çdo rajon që ka shkolla profesionale, por pjesa më e madhe e shkollave të marra në studim janë në Berat, Korçë, Shkodër dhe Tiranë (4-5 shkolla janë vizituar për çdo qytet), pastaj në Elbasan dhe Durrës (nga 3 shkolla për qytet).

Institucionet shtetërore Ndërsa ndër institucionet, punonjësit e të cilëve janë intervistuar, janë nga AKAFP, MFE, MASR dhe DAR. Nga ky burim informacioni janë përfutur dhe shumë të dhëna dytësore nga politika, strategji, bazë ligjore, statistika etj.

Aktorët ndërkombëtarë Ndërsa ndër aktorët e huaj të përfshirë në studim janë agjensi zbatimi më një ndikim të rëndësishëm në AP. Konkretisht janë intervistuar drejtues të PEM në Shqipëri – projekti i i AFP në Shqipërinë Veriore; *GOPA* – kompania e cila

ofron asistencen teknike të FASTIP ku është i vendosur dhe FSP, si dhe përfaqësues të projektit “Korniza e Investimeve në Arsim” (EIFP – TA-ALB-10) është një ndër projektet e realizuara nën Njësinë e Projekteve Infrastrukturore në Ballkanin Perëndimor (IPF) financuar nga BE, dhe zbatuar nga WYG International.

Specialitetet	Numri	Përqindja
Elektrik i përgjithshëm, automekanik, hidraulik, mirembajtje	7	23%
Mekanik i përgjithshëm, elektromekanik, automekanik, teknik	5	17%
Veteriner, agrobiznes	4	13%
Hoteleri-turizëm ekonomik, IT specialist,	8	27%
Teknik ndërtimi, mobilier, topograf,	3	10%
Specialist pyjesh	1	3%
Pa specifikime	2	7%
Totali	30	100%

3.2. Struktura organizative e shkollave

Nga studimi ka rezultuar një strukturë organizative pothuajse tipike e përshkruar në figurën e mëposhtme. Në krye të shkollës qëndron bordi i shkollës dhe drejtori i cili është shpesh here dhe kryetar i bordit (edhe pse kryetari i bordit zgjidhet dhe nuk është i paracaktuar). Rreth 42% e shkollave kanë nëndrejtor dhe 20% e tyre kanë një përgjegjës të bazës prodhuese.

Nga përgjigjet e pyetësorit, vihet re që drejtori i shkollës vazhdon të ketë ndikimin kryesor në drejtimin e shkollës dhe (pothuajse në të gjitha rastet), bordi ka një funksion këshillues, ku ndërkohë, sipas Ligjit të Arsimit, bordi është institucioni më i lartë në shkollë dhe është përgjegjës për marrjen e shumë vendimeve, sidomos financiare.

Të intervistuarit janë pyetur dhe për ekzistencën apo jo të një *zyrë karriere* për të identifikuar dhe përpjekjet e këtyre shkollave për rritjen e efektivitetit të tyre (meqë një ndër rezultatet kryesore të tyre është integrimi i të diplomuarve në tregun punës). Ndërkohë në përgjigjet e ekzistencës së një zyre karriere në rreth 20% të rasteve nuk është identifikuar një zyrë e tillë. Ndërkohë të pyetur për mënyrën e funksionimit të kësaj zyre, ato pak shkolla që kanë zyra karriere nuk kanë një mënyrë të qartë të drejtimit të kësaj zyre.

Një analizë interesante rezulton në bazë të përgjigjeve të lidhur me përgjegjësinë e menaxhimit të fondeve që vijnë nga burime të ndryshme, ku ashtu siç dhe pritej, kemi ndarjen në tre grupe kryesore:

- (i) shkollat jopublike të cilat kanë mundësi të menaxhojnë gati të gjitha fondet e tyre të cilat i marrin kryesisht nga pagesat e nxënësve;
- (ii) shkollat që menaxhojnë të gjitha fondet që i alokohen, që përfaqësohen nga shkollat me status kombëtar; dhe
- (iii) shkollat që menaxhojnë vetëm fondet e bordit të shkollës (kryesisht me të ardhura nga nxënësit e prindërit) dhe të bazës prodhuese, të cilat janë shkolla jo me status kombëtar dhe financimi i tyre është pothuajse tërësisht i varur nga organet e prore.

4. Analizë krahasuese e pritjeve dhe perceptimeve të aktorëve të ndryshëm

Në studim, një pjesë e veçantë i është dedikuar dhe perceptimit të institucioneve arsimore për marrëdhëniet mes aktorëve të ndryshëm të cilët autorët e këtij studimi i kanë parë me vlerë që t'i analizojnë. Të pyetur për marrëdhëniet me *qeverinë*, pjesa më e madhe e përfaqësuesve të shkollave të intervistuar shprehen të kënaqur me marrëdhëniet me qeverinë (MASR dhe MFE). Ndërkohë ata që shprehen të pakënaqur kanë së pari si arsye limitimin e fondeve dhe së dyti mungesën e transparencës së investimeve. Ndërsa zyrtarët e pyetur për këtë marrëdhënie sugjerojnë rritjen e transparencës dhe bashkëpunimit mes këtyre palëve të interesuara.

Siç pritej, të pyetur për marrëdhëniet me *pushtetin vendor*, një pjesë e madhe (më shumë se 50% e shkollave publike) e cilësojnë marrëdhënien si jo shumë efektive apo si inegzistente. Në rastet kur marrëdhëniet identifikohen si jo të mira, shkak janë vonesa në plotësimin e detyrimeve që kanë ndaj institucionit për mirëmbajtjen dhe ofrimin e shërbimeve të ndryshme, por në shumicën e rasteve këto marrëdhënie nuk egzistojnë. Interesante janë përgjigjet e marra nga grupi tjetër i të intervistuarve, pikërisht nga përfaqësuesit e qeverisë dhe të DAR. Këto të fundit nuk e konsiderojnë veten një aktor të rëndësishëm në financimin e AP. Kjo përlligj konkluzionin tonë më sipër, sipas të cilit struktura e re e DAR sipas të cilës këto njësi duhet të jenë aktivisht të përfshira në programimin e financimeve dhe investimeve, është në fakt akoma jo funksionale dhe roli i DAR është më tepër i përqendruar tek çështjet akademike sesa ato të financimit të arsimit.

Bizneset, siç u diskutua dhe më lart, janë një palë e interesuar me një rol mjaft të rëndësishëm në AP. Shkollat në 62% të rasteve i konsiderojnë marrëdhëniet me bizneset të dobëta. Në 24 % të rasteve duhen përmirësuar dhe në rreth vetem 19% të rasteve këto marrëdhënie janë të mira.

Në përpjekje për të pasur një bashkëpunim mes aktorëve të ndryshëm në drejtim të AP, është e nevojshme duke u fokusuar në institucionalizimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit mes tyre. Një nismë e tillë është krijimi i Bordi i institucioneve publike ofruese të AFP-së ku bëjnë pjesë aktorë të ndryshëm me interes në zhvillimin e AP në një rajon të caktuar. Kjo nismë vjen në kuadër të filozofisë së përshtatjes së shërbimit të AP me nevojat lokale të cilat vajojnë sipas rajoneve. Bordi është njohur nga ligji i ri i AFP, Neni 7/1, ku përshkruhet përbërja dhe misioni, por nuk ka një sqarim të mënyrës së funksionimit të tij. PEM, një ndër aktorët më të rëndësishëm ndërkombëtar në zhvillimin e AP në zonën e Veriut të Shqipërisë, ka ndërmarrë dhe nismën e detajimit të funksioneve dhe përgjegjësi të këtij organi.

Konkluzione

AP në Shqipëri ka pësuar ndryshime të cilat kanë ndjekur dinamikën e ndryshimeve të ndodhura në Shqipëri që para çlirimit e deri më sot. Por ndryshimi më drastik i këtij sistemi ka filluar i ndikuar nga tranzicioni i pas viteve '90 i shoqëruar me ndryshimet ekonomike strukturore, migrimin e popullsisë, prezantimi i ekonomisë së tregut, hapja kufijve, privatizimi i sektorëve strategjikë, lejimi i pronës private etj., dhe në AP u

shkaktua mbyllja e numrit më të madh të shkollave teknike, kryesisht atyre bujqësore në fshatra dhe në një pjesë të rasteve kthimi i tyre në shkolla të përgjithshme. Dëmtimi i shkollave teknike në qytete dhe rënia e kërkesës për teknikë, çoi në rënien e numrit të të regjistruarve në shkollat profesionale krahasuar me shkollat e përgjithshme (Llaci, et. al 2009)

Aktualisht ne kemi një ofertë të shumëllojshme të AP qoftë nga pikëpamja e specialiteteve por dhe e kohëzgjatjes së ciklit të studimit, si dhe e shtrirë në 41 shkollat në gjithë Shqipërinë. Tipari bazë është kalimi nga drejtimit mësimore që i referohen profesioneve prodhuese, drejt drejtimeve mësimore që kanë të bëjnë me shërbimet (ekonomi dhe biznes, hoteleri dhe turizëm, mirëmbajtje dhe riparim, teknologji informimi dhe komunikimi etj.) Ndërsa shpërndarja e ofertës numerike të AP publik përgjithësisht përputhet me përqendrimin e popullsisë në zonat urbane. Në nivel rajonal, ka shumë raste të mospërputhjes së ofertës me kërkesën pasi nuk përkojnë specialitetet e hapura me sektorët e ekonomisë të zhvilluar në atë zonë ku parashikohet të ketë më shumë nevojë për punonjës të kualifikuar.

Gjatë këtyre viteve, në sistemin e AP janë ndërmarrë disa nisma politike në drejtim të planifikimit të integruar të sistemit, të tilla si Ligji i Ri i AFP, Strategjia e Arsimit Profesional, Korniza Kombëtare e Kualifikimeve, krijimi i Bordeve të Shkollës etj., të cilët japin orientimet kryesore dhe për financimin e AP. Në bazë të këtyre dokumenteve strategjike, është ridimensionuar dhe roli i aktorëve të shumtë të AP në drejtim të financimit, ku një rol thelbësor luan MASR dhe MFE, si institucionet kryesor politikbërës.

Në thelb të bashkëpunimit mes këtyre aktorëve, faktikisht nuk qëndron një ndarje e qartë e detyrave dhe përgjegjësive që shpesh ka çuar në inefficiençë të sistemit të financimit dhe jo vetëm.

Në subjektet e intervistuar vihen re disa përgjithësime sidomos në rastin e të intervistuarve përfaqësues të shkollave jo-publike. Status të veçantë kanë shkollat kombëtare, si në rastin e planifikimit të fondeve dhe në miratimin dhe alokimin e këtyre fondeve. Nga studimi ka rezultuar gjithashtu një strukturë tipike organizative e cila supozohet të ndikojë në marrjen e vendimeve për financimin ku në krye qëndrojnë Bordi dhe Drejtori.

Mjaft situata interesante kanë rezultuar në drejtim të matjes së perceptimit të marrëdhënieve mes aktorëve të ndryshëm ku vlerësohen por kanë vend për përmirësim marrëdhëniet mes tyre.

Referenca

“Role of Regional Level in the Albanian Development Strategy”, SIPU report on Decentralization and Regional Development, Project in Albania Phase II, August, 2006
Arsimi Profesional në Estoni Mbledhja dhe përdorimi i informatave https://www.etf.europa.eu/sites/default/files/event/Presentation_Ms%20Piiskop_ALB.pdf (aksesuar Dhjetor 2023)

BB, 2019, “Ristrukturimi i Shpenzimeve Publike për një rritje të Qendrueshme, Analiza e Shpenzimeve Publike dhe Institucionale”

- Cipusheva, H., Havolli, S., Memaj, F., Mughal, A. G., Sejdini, A., Shehaj, E., ... & Sadiku, L. (2013). Brain Circulation and the Role of the Diaspora in the Balkans-Albania, Kosova and Macedonia. *Kosova and Macedonia (May 16, 2013)*.
- Dollani, P., & MEMAJ, F. Absorbing innovation in developing economies—a case study from Albania. Donaldson, Dibra, 2011, Report: Initial assessment of current CIP-related management capacities, organisational processes and decision-making frameworks within the Ministry of Education and Science”, The European Union's Programme for the Western Balkans, Infrastructure Projects Facility in the Western Balkans, EuropeAid/124605/C/SERMULTI, TA-ALB-10
- Memaj F., Hodaj, H., & Tabaku, J. (2006). Economic education in Albania and labour market challenges.
- Herczynski, 2007 “Current Problems of Education Finance in Albania”, Interdisciplinary Center for Mathematical and Computer Modeling, Warsaw University, Poland
- Kosta, B., & Memaj, F. (2019, September). Business models for the circular economy—case of Albania. In *iai academic conference proceedings*.
- Llaci. Sh., Tabaku, J., Dibra, S., (2009), “Politikat e Zhvillimit te Zotësive në Shqipëri” (një version i shkurtuar i raportit mund të gjendet në www.norrag.org/wg/documents/country-studies/Dibra,%20Llaci%20&%20Tabaku.pdf)
- Malaj, A., Mema, F., & Hida, S. (2005). *Albania, financial management in the education system: Higher education* (No. 54). BERG Working Paper Series on Government and Growth. MASR, Strategjia kombëtare e arsimit 2021-2026
MATJA E NDIKIMIT TË FAKTORËVE QË I KANË SHTYRË KOMPANITË TË ADOPTOJNË APLIKACIONE PËR TREGTINË ELEKTRONIKE

Zhaneta NDREGJONI Phd¹, Liljana ELMAZI (BILLA)²

Abstrakt

E-commerce is defined as the activity of buying or selling products and services online through the internet. E-commerce relies on technologies such as mobile commerce, electronic funds transfer, supply chain management, online marketing, online transaction processing, electronic data interchange, and data collection components. Advantages of e-commerce such as convenience, personalization and experience, access to a broader market, minimal costs, availability, etc., lead many companies, especially SMEs, to plan their doing business to the digital market. The aim of this application, is to increase sales, further develop investment capital, and promote overall business development.. Social media a powerful communication tool allows companies to reach customers quickly and easily, helping them increase online presence. The aim of this paper is to measure the level of adoption of e-commerce applications among SMEs in Tirana. To achieve this goal, the following hypotheses have been formulated and tested:

H1: The longer the company's lifespan in the market, the more willing they are to adopt e-commerce.

H2: Internal factors of the company influence the adoption of e-commerce.

H3: The higher the pressure from consumers and suppliers on the company, the higher their willingness to adopt e-commerce.

H4: The greater the support from the expertise of companies offering training for e-commerce and from the government, the more inclined companies is to adopt its applications.

Through testing these hypotheses, the aim is to determine the level the adoption of e-commerce applications among SMEs in Tirana, in enhancing their capabilities and competitive advantage through the use of this technology.

Keywords: SME, E-commerce, adoption, factors, dependent and independent variables, logistic regression.

1. Hyrje

SME-të ndeshen me presion konkurrues në rritje si rezultat i globalizmit dhe hapjes së tregjeve, të stimuluar nga teknologjitë e reja dhe novacionet. SME-të luajnë një rol të rëndësishëm në ekonominë e vendeve. Ato luajnë një rol të rëndësishëm në rritjen afatgjatë dhe të qëndrueshme, dinamizmin dhe punësimin (Thassanabanjong et al., 2009). SME-të konsiderohen si një nga elementët më të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të një vendi, që çojnë në stimulimin e sipërmarrjes private dhe të aftësive manaxheriale (Gadenne and Sharma, 2009

Komunikimi është sferë e jetës së njeriut, që egziston pothuajse, që prej ekzistimit të vet jetës. Komunikimi behët me mjete dhe forma të ndryshme : me të folur , shikim, shkrim/lexim letrash, gjeste, e shumë e shumë forma tjera. Një ndër format bashkëkohore të komunikimit janë edhe komunikimet përmes rrjetit global që e quajmë Internet. Një ndër shërbimet kryesore të

¹ University of Tirana, Faculty of Economics, Department of Marketing and Tourism
zhaneta.ndregjoni@unitir.edu.al

²University of Tirana, Faculty of Economics, Department of Marketing and Tourism
lilielmazi@yahoo.com

internetit, që përdoret nga bizneset është shitblerja elektronike- shitja dhe blerja e produkteve dhe shërbimeve përmes kompjuterit.² Interneti është një mundësi e shkëlqyeshme për bizneset të informojnë klientët potencial për mallrat dhe shërbimet e tyre. Posta elektronike dhe faqja në internet janë mënyra të mrekullueshme për mbledhje të informatave nga klientët potencial për nevojat e tyre dhe strukturimin e mallrave dhe shërbimeve që ju i ofroni për përmbushjen e atyre nevojave. Mënyra më efektive e përfitimit të informatave nga klientët dhe transmetimi i informatave tek klienti është të kemi një ueb faqe në internet të dizajnuar mirë që ofron dhe nxjerr informata nga klientët potencial.

Referuar Studimit të bankës Botërore, shumë biznese shqiptare nuk kanë investuar ende në zhvillimin e shitjeve në internet. Vetëm 5 përqind e bizneseve shqiptare raportuan shitje në internet në 2018, duke mbetur prapa dukshëm me vendet e rajonit. Anketa e Ndërmarrjeve në vitin 2020 tregon se pothuajse 20 përqind e të anketuarve, ndërmarrjet shqiptare ose kanë filluar ose kanë rritur aktivitetin e biznesit në internet gjatë COVID-19, duke ecur përpara në dixhitalizim për të përballuar krizën.

Qëllimi i studimit

Qëllimi i studimit është të tregojë sesi faktorët e gjeneruar nga analiza faktoriale (1) Performanca e kompanisë, (2) Eficienca operationale, (3) Kontrolli i kostove të biznesit, (4) Efikasitet në shërbimin konsumator, dhe 5) Ndërtim marrëdhëniesh me konsumatorët ndikojnë në performancën e SME.

Faktori i parë që është indeksuar si “*Performanca e kompanisë*” ka korrelacion më të lartë me variabla si përmirësimi i efektivitetit operacional, i eficiencës operationale, rritjet e shitjeve, fitimeve dhe përfitimeve, përmirësimin në mënyrë rrënjësore procesit të biznesit, rritjen e vlerës së biznesit, etj.

Faktori i dytë i indeksuar si “*Eficiencë operationale*” ka korrelacion më të lartë me variablat të tillë si lehtësimi i shkëmbimit të informacionit midis partnerëve të biznesit, lehtësimi i shkëmbimit të informacionit me mjedisin e jashtëm (klientë, furnitorë, banka, qeveri, transportues, partnerë biznesi, komunitetin, etj). Po ashtu ky faktor korrelohet pozitivisht dhe me variablat si akses për kompetenca manaxheriale, oportunitete të reja për aleanca strategjike, rritjen e koordinimit dhe kooperimit brenda firmës, oportunitet më të mirë për të arritur furnitorë të rinj, akses në tregjet e reja, akses në kompetencat teknologjike si dhe publikimin e informacioneve të përgjithshme të kompanisë (historikun e kompanisë, kontaktet e kompanisë, vendndodhjen fizike).

Faktori i tretë i emërtuar si “*Kontrolli i kostove të biznesit*” përbëhet nga nëntë variabla ku peshën më të madhe e ka variabli për uljen e kostove administrative. Po ashtu dhe variablat si “reduktimi i kostove totale të stafit”, “arritja e standarteve për shërbimet ndaj klientëve”, “reduktimi i kostove të marketingut”, “rritjen e shpejtësisë së dorëzimit të porosive”, “ndërtimin e marrëdhëniesh me konsumatorët”, “informimin e konsumatorëve për produktin”, “rritjen gjeografike” dhe “qarkullimin e shitjes” kanë korrelacione të larta me këtë faktor.

Faktori i katërt i indeksuar si “*Efikasitet në shërbimin konsumator*” ka korrelacion të lartë me variablat që lidhen me “pranimin e pagesave online”, “mundësinë e kontrollit të lëvizjes së porosisë së tyre”, “realizimin lehtësisht dhe të sigurtë të porosisë online”, përgjigjen menjëherë ndaj porosisë dhe ndaj ankimeve, informimin e klientëve për produktet dhe çmimet, mënyrat se si të kërkohet produkti, vendi, porosia dhe bërja e pagesës është i thjeshtë për të naviguar, dhe fleksibilitet të çmimeve në segmente të ndryshme tregu.

Faktori i pestë i indeksuar si “*Ndërtim marrëdhëniesh me konsumatorët*” është i lidhur me karakteristikën tilla si fuqizimi i marrëdhënies me konsumatorin, me besnikërinë konsumatore, dhe rritjen e kënaqësisë konsumatore.

2. Metodologjia e kërkimit

Në këtë studim u përdor metoda kërkimore sasiore për shkak të natyrës së të dhënave të mbledhura me anë të pyetësorit

2.1 Zgjedhja e kampionit

Meqë objekt i këtij studimi janë vetëm ndërmarrjet e vogla e të mesme që operojnë në rrethin e Tiranës atëherë u përdor si bazë zgjedhjeje libri “Çelësi – Udhëzuesi praktik i kryeqytetit”. Të dhënat mbi ndërmarrjet e listuara në këtë libër janë të ndara sipas aktiviteteve ekonomike si dhe janë lehtësisht të aksesueshme në faqet e internetit www.yellowpagesalbania.com dhe www.celesi.com.

Zakonisht për të marrë një zgjedhje të ndërmarrjeve bëhet fillimisht një shtresëzim sipas madhësisë së ndërmarrjes (bazuar në numrin e të punësuarve me pagë). Më pas bëhet shtresëzimi sipas aktivitetit ekonomik. Për të bërë zgjedhjen e ndërmarrjeve për t’i përfshirë në studim, fillimisht identifikohen aktivitetet kryesore ekonomike në të cilat tregtia elektronike gjen zbatim më së shumti. Nga libri “fletët e verdha” u përzgjedh një listë ndërmarrjesh sipas aktiviteteve në të cilat ato operojnë në treg. Por, kjo listë ndërmarrjesh nuk përmban informacion mbi numrin e të punësuarve të angazhuar në secilën prej tyre. Për këtë arsye, ndërmarrjet u kontaktuan fillimisht me anë të telefonit për të identifikuar numrin e të punësuarve. Numri i ndërmarrjeve të zgjedhuar ishte 150 nga të cilat pranuan të marrin pjesë në studim 124 prej tyre.

2.2 Instrumenti i kërkimit

Instrumenti kryesor i përdorur për mbledhjen e të dhënave të studimit është pyetësori i cili u përpilua për të mbledhur informacion se në ç’masë aplikohet e tregtia elektronike në Tiranë dhe për të vlerësuar përfitimet që sjell aplikimi i tregtisë elektronike për kompanitë.

Pyetësori u kërkua të plotësohet nga menaxheri i kompanisë, ndërsa mënyra e intervistimit ishte e drejtpërdrejtë.

është matja e qëndrueshmërisë së brendshme psh nëpërmjet llogaritjes së Cronbach alfa (George, D., & Mallery 2003).

Për vlefshmërinë e përmbajtjes u përdor metoda e ‘panelit të ekspertëve’. Pyetësori i’u dha disa ekspertëve në fushën e analizave statistikore për të gjykuar mbi variablat e përfshirë në të si dhe për të marrë opinionin e tij për llojin e analizës statistikore më të përshtatshme. Ekspertëve i’u kërkua që të vlerësojnë pyetësorin dhe të përcaktojnë se cilat pyetje mund të mbahen në pyetësor, cilat pyetje duhet të modifikohen dhe cilat duhet të largohen nga pyetësori (si pyetje të paqarta ose që nuk lidhen në mënyrë esenciale me studimin). Nga vlerësimi i pyetjeve të pyetësorit rezultoi se në përgjithësi pyetjet duhet të mbahen në pyetësor.

Pastaj u krye një test pilot në 10 kompani për t’u siguruar nëse pyetjet ishin të qarta, dhe lehtësisht të kuptueshme nga individët që i’u përgjigjën pyetësorit.

Intervistat pranë kompanive u kryen në periudhën Shkurt-Mars 2021. Pas mbledhjes së të dhënave përpunimi i tyre u bë në SPSS. Për të parë qëndrueshmërinë e brendshme të pyetësorit u përdorën koeficientët Chronbach alpha dhe Regresioni logjistik binar u përdor për të shpjeguar se si ndikojnë faktorët e gjeneruar nga analiza faktoriale mbi përfitimet e kompanive nga përdorimi i tregtisë elektronike në shanset që një kompani të adaptojë aplikimet e tregtisë elektronike.

3. Analiza e gjetjeve

3.1. Regresioni logjistik

Regresioni logjistik binar u përdor për të shpjeguar se si ndikojnë faktorët e gjeneruar nga analiza faktoriale mbi përfitimet e kompanive nga përdorimi i tregtisë elektronike në shanset që një kompani të adaptojë aplikimet e tregtisë elektronike. Regresioni logjistik përdoret për të parashikuar (apo shpjeguar) një variabël kategorik (zakonisht dikotomik) nga një grup i variablave parashikues apo shpjegues.

Në një regresion logjistik, variabli i varur i parashikuar është një funksion i probabilitetit që një subjekt i veçantë do të bëjë pjesë në një nga kategoritë. Në thelb, Regresioni Logjistik Binar parashikon vlerat e një variabli të varur bazuar në një ose më shumë variabla të pavarur. Regresioni Logjistik Binar vlerëson raportin e gjasave që një ngjarje e caktuar e variablit të varur të ndodhë bazuar në vlerat e një ose më shumë variablave të pavarura. Më konkretisht vlerësohet se sa herë më shumë ose sa herë më pak ka gjasa që një ngjarje e varur të ndodhë në varësi të kategorive të variablit të pavarur, një prej të cilave merret si kategori referencë. kompanitë janë grupuar në dy kategori: përdorues aktivë dhe përdorues pasivë të aplikimeve të tregtisë elektronike. Në analizën tonë ky variabël është konsideruar si variabël i varur, ndërsa si variabla shpjegues janë marrë këta faktorë (1) Krijim vlere dhe imazhi, (2) Eficienca operacionale, (3) Kontrolli i kostove të biznesit, (4) Efikasitet në shërbimin konsumator, dhe (5) Ndërtim marrëdhëniesh me konsumatorët.

Të dhënat e regresionit logjistik binar jepen në Tabelën 1.

Tabela 1: Rezultatet e modelit të Regresionit Logjistik Multivariabël							
	Odds Ratio (raporti i probabiliteteve)	Gabimi standart	z	P. Z	Intervali i besimit 95% për OR		
					Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm	
<i>Krijim vlere dhe imazh</i>	1,320	0,365	1,00	0.317	0,767	2,271	
<i>Eficiency operacionale</i>	1,752	0,473	2,08	0.038	1,033	2,973	
<i>Kontrolli i kostove të biznesit</i>	2,814	0,815	3,57	0.000	1,595	4,964	
<i>Efikasitet në shërbimin konsumator</i>	1,640	0,389	2,09	0.037	1,031	2,610	
<i>Ndërtim marrëdhëniesh me konsumatorët</i>	1,251	0,317	0,89	0.376	0,762	2,055	
Log pseudolikelihood = -53.870 Wald chi2(5) = 20,42 Prob > chi2 = 0,0010 Pseudo R2 = 0,2094 Numri i vrojtimeve: 105 Variabli i varur: Statusi i përdorimit të tregtisë elektronike Kodi 0 – Përdorues pasivë të aplikimeve të tregtisë elektronike Kodi 1 - Përdorues aktivë të aplikimeve të tregtisë elektronike							

Modeli i Regresionit Logjistik Binar ka raportuar këto parametra statistikorë:

- a) *Raporti i Gjasave* apo Odds Ratio (OR): Në thelb raporti i gjasave shpreh raportin e probabilitetit të ndodhjes së një ngjarjeje përmbi probabilitetin e mosndodhjes së saj. OR është madhësi e forcës së lidhjes sipas përpjesëtimit: sa më i lartë është OR, aq më e fortë është lidhja e vrojtuar midis dy variablave.

- b) *Intervali i besimit 95%* për raportin e gjasave (OR): Intervali i besimit 95% shpreh intervalin ku ne jemi të sigurt që gjendet vlera e raportuar e OR-së në 95% të rasteve. Duke qenë se kampioni ynë është një fraksion i popullatës referencë, atëherë asnjëherë nuk jemi të sigurt që vlera e raportuar e OR-ve nga kampioni ynë është saktësisht po kaq dhe në popullatën referencë.

Për këtë arsye raportohet Intervali i Besimit 95%, ku ne jemi të sigurt që ndodhet vlera jonë e OR-së në 95% të rasteve. Intervali i besimit 95 % është shumë i përdorshëm pasi ai na ndihmon që të kuptojmë se sa e lartë dhe sa e ulët mund të jetë vlera aktuale e parametrin të popullatës. Intervale të besimit lidhen me vlerat e p në mënyrë të tillë që koeficienti nuk është statistikisht i rëndësishëm nëse zero përfshihet në intervalin e besimit.

- c) *Vlera e P-së* apo e rëndësisë statistikore: Në thelb, P shpreh rolin që luan “rastësia” në shpjegimin e lidhjes së vërejtur midis variableve të ndryshëm. Sa më e lartë të jetë vlera e P -së, aq më shumë luan rol “rastësia” në shpjegimin e lidhjes dhe aq më pak përmbushen kriteret e shkakësisë midis variableve në një lidhje statistikore. Me marrëveshje, një vlerë e P -së prej 5% ose më pak merret si tregues i rëndësisë statistikore.

- d) *LR $\chi^2(5)$* – testi hi katror i raportit të përgjasisë, ku numri në kllapa tregon numrin e shkallëve të lirisë. Në modelin tonë kemi pesë variabla shpjegues prandaj janë 5 shkallë lirie.

- e) *Prob > χ^2* – ky është probabiliteti i përfutimit të statistikës hi katror kur supozojmë që hipoteza zero është e vërtetë. Me fjalë të tjera, ky është probabiliteti i përfutimit të statistikës hi katror në qoftë se variablat e pavarur të marrë së bashku nuk kanë efekt mbi variablin e varur. Kjo është padyshim, vlera p e cila krahasohet me vlerën kritike 0.05 ose 0.01 për të përcaktuar nëse modeli në tërësi është statistikisht i rëndësishëm. Në rastin tonë, modeli është statistikisht i rëndësishëm pasi vlera e p është më e vogël se .000.

- f) *Std. Err.* – gabimet standarde që lidhen me koeficientët. Gabimi standart përdoret për të testuar nëse parametri është në mënyrë të rëndësishme i ndryshëm nga zero. Duke pjesëtuar vlerësimin e parametrin me gabimin standart ne marrim një vlerë z . Gabimet

- g) *z dhe $P > |z|$* - këto kolona japin vlerën z dhe vlerën e dyanshme të p për testimin e hipotezës zero që koeficienti (parametri i vlerësuar) është zero. Nëse përdorim testin e dyanshëm atëherë krahasojmë secilën vlerë të p të vlerës së parapërzgjedhur të alfës. Koeficientët që i kanë vlerat e p më të vogla sesa alfa janë statistikisht të rëndësishme. Nëse përdorim një test të njëanshëm (pra predikojmë që parametri do të shkojë në një drejtim të veçantë) atëherë ne e pjesëtojmë vlerën e p me 2 para se të krahasojmë atë me nivelin e alfës së para zgjedhur.

Kompanitë që janë përdorues aktivë të aplikimeve të tregtisë elektronike kanë mundësi të krijojnë avantazh në kontekstin e kontrollit të kostove të biznesit (minimizimit të kostove). Sipas rezultateve të modelit logjistik shohim që kompanitë që janë përdorues aktivë të aplikimeve të tregtisë elektronike kanë 2,8 herë më shumë shanse sesa kompanitë që janë përdorues pasivë të tyre për të kontrolluar kostot e biznesit të tyre.

Kompanitë përdoruese aktive të aplikimeve të tregtisë elektronike kanë më shumë të ngjarë që të arrijnë një efikasitet operacionale më të lartë sesa ato kompani që janë përdorues pasivë të tregtisë elektronike. Kështu raporti i probabiliteteve për variablin e efikasitetit operacionale tregon që kompanitë përdoruese në mënyrë aktive të aplikimeve të tregtisë elektronike kanë një probabilitet prej 1.752 herë më të madh sesa kompanitë pasive në përdorimin e tyre për të krijuar lehhtësira në shkëmbimin e informacionit midis partnerëve të biznesit, me mjedisin e jashtëm (klientë, furnitorë, banka, qeveri, transportues, partnerë biznesi, komunitetin etj), për

të krijuar akses për kompetenca manaxheriale apo oportunitete të reja për aleanca strategjike, etj.

Efikasiteti në shërbimin konsumator përbën një element statistikisht të rëndësishëm në shpjegimin e përfitimit që kanë kompanitë përdoruese aktive të aplikimeve të tregtisë elektronike. Kompanitë përdoruese aktive të aplikimeve të tregtisë elektronike kanë 1.64 herë më shumë shanse që të arrijnë një efikasiteti të lartë në shërbimin konsumator në krahasim me kompanitë përdorues pasivë të aplikimeve të tregtisë elektronike.

Variablat “Krijim vlere dhe imazhi” dhe “Ndërtim marrëdhëniesh me konsumatorët” të përfshira në modelin logjistik si variabla shpjegues rezultuan si statistikisht të parëndësishëm. Për të parë efektin e faktorëve që kanë shtyrë kompanitë të adoptojnë aplikimet e tregtisë elektronike mbi statusin e përdorimit të tyre tek kompanitë, u ndërtua përsëri një model i regresionit logjistik binar.

Rezultatet e këtij regresioni jepen në tabelën 2 nga ku vemë re se faktorët e brendshëm të cilët kanë nxitur kompanitë të adoptojnë aplikimet e tregtisë elektronike e rrisin probabilitetin që kompanitë të jenë përdoruese aktive të këtyre aplikimeve krahasimisht me kompanitë përdoruese pasive. Pra siç pritej, kompanitë që kanë infrastrukturë të mjaftueshme IT për të suportuar tregtinë elektronike, punonjës kompetentë për të manaxhuar aplikimin e tregtisë elektronike, tregtia elektronike në linjë me strategjinë marketing, tregtia elektronike në linjë me strategjinë e biznesit, etj kanë 3 herë më shumë shanse për të qenë përdorues aktivë të aplikimeve të tregtisë elektronike.

Tabela 2 : Rezultatet e modelit të Regresionit Logjistik Multivariabël						
	Odds Ratio (raporti i probabiliteteve)	Gabimi standart	z	P. Z	Intervali i besimit 95% për OR	
					Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
<i>Faktorët e brendshëm</i>	3,011	0,696	4,77	0,000	1,914	4,735
<i>Kosto</i>	1,365	0,344	1,24	0,217	0,833	2,235
<i>Perceptimi i riskut</i>	0,696	0,177	1,43	0,153	0,423	1,144
<i>Faktorët e jashtëm</i>	0,970	0,256	0,11	0,909	0,579	1,627
Log pseudolikelihood = -57,134 Wald chi2(4) = 27,26 Prob > chi2 = 0,000 Pseudo R2 = 0,162 Numri i vrojtimeve: 105 Variabli i varur: Statusi i përdorimit të tregtisë elektronike Kodi 0 – Përdorues pasivë të aplikimeve të tregtisë elektronike Kodi 1 - Përdorues aktivë të aplikimeve të tregtisë elektronike						

Ndërsa faktorët e tjerë nxitës të adoptimit të aplikimeve të tregtisë elektronike si Kosto, Perceptimi i riskut dhe Faktorët e jashtëm nuk kanë ndonjë lidhje statistikisht të rëndësishme me përdorimin aktiv të tregtisë elektronike nga kompanitë. Ky përfundim është në përputhje edhe me analizën e variancës apo me testet hi katror të kryera në seksionin 4.1 me elementët e veçantë të këtyre faktorëve.

Nëse në modelin e mësipërm shtojmë si variabël shpjegues dhe jetëgjatësinë e kompanisë në treg, shohim që probabiliteti që kompanitë të jenë përdoruese aktive të aplikimeve të tregtisë elektronike rritet me numrin e viteve të kompanisë në treg.

Rezultatet jepen në Tabelën 3.

Tabela 3: Rezultatet e modelit të Regresionit Logjistik Multivariabël						
	Odds Ratio (raporti i probabiliteteve)	Gabimi standart	z	P. Z	Intervali i besimit 95% për OR	
					Kufiri i poshtëm	Kufiri i sipërm
<i>Faktorët e brendshëm</i>	4,206	1,528	3,95	0,000	2,064	8,573
<i>Kosto</i>	1,610	0,485	1,58	0,114	0,892	2,907
<i>Perceptimi i riskut</i>	0,669	0,194	1,38	0,166	0,379	1,181
<i>Faktorët e jashtëm</i>	0,905	0,294	0,31	0,758	0,478	1,712
<i>Jetëgjatësia në treg</i>						
<i>3-6 vjet</i>	4,288	2,465	2,53	0,011	1,389	13,234
<i>Mbi 7 vjet</i>	70,734	90,032	3,35	0,001	5,837	857,15
<i>Deri 2 vjet (kategoria referencë)</i>						
Log pseudolikelihood = -43,192 Wald chi2(6) = 23,66 Prob > chi2 = 0,0006 Pseudo R2 = 0,3661 Numri i vrojtimeve: 105 Variabli i varur: Statusi i përdorimit të tregtisë elektronike Kodi 0 – Përdorues pasivë të aplikimeve të tregtisë elektronike Kodi 1 - Përdorues aktivë të aplikimeve të tregtisë elektronike						

4. Konkluzione

Tregtia elektronike ka mundësuar një treg konkurrues, për pasojë shumë kompani janë duke e menduar ndryshimin e modelit të të bërit biznes, në mënyrë që të jenë sa më konkurrues në treg.

SME-të ndeshen me presion konkurrues në rritje si rezultat i globalizmit dhe hapjes së tregjeve, të stimuluar nga teknologjitë e reja dhe novacionet. Ato duhet të gjejnë mënyra efikase për tu përballur me këto sfida, sepse kemi të bëjmë me sfida afatgjata dhe në rritje. SME-të veprojnë si katalizatorë në aspektin e rritjes ekonomike, si edhe për zhvillimin e fushave të tjera të tilla si arte, burimet njerëzore, prodhimin dhe sektorin e sportit.

Manaxhimi i lartë luan një rol të rëndësishëm në adoptimin e tregtisë elektronike, për të mos thënë që ky adoptim varet tërësisht nga suporti i manaxhimit të lartë. Suporti i manaxhimit të lartë mund të ndikojë pozitivisht në procesin e asimilimit të tregtisë elektronike

SME-të mund të realizojnë bashkëveprimin brenda firmës midis departamenteve të tyre, duke kooperuar në aktivitete të tilla si trajnimet, zhvillimet teknologjike, zhvillimin e produktit, financës, kërkim zhvillimit, promocionit, kërkimit marketing, shpërndarje dhe transport.

Kompanitë që janë përdorues aktivë të aplikimeve të tregtisë elektronike kanë mundësi të krijojnë avantazh në kontekstin e kontrollit të kostove të biznesit (minimizimit të kostove). Sipas rezultateve të modelit logjistik shohim që kompanitë që janë përdorues aktivë të aplikimeve të tregtisë elektronike kanë 2,8 herë më shumë shanse sesa kompanitë që janë përdorues pasivë të tyre për të kontrolluar kostot e biznesit të tyre. Kompanitë përdoruese aktive të aplikimeve të tregtisë elektronike kanë më shumë të ngjarë që të arrijnë një efikasitet operacionale më të lartë sesa ato kompani që janë përdorues pasivë të tregtisë elektronike. Kështu raporti i probabiliteteve për variablin e efikasitetit operacionale tregon që kompanitë përdoruese në mënyrë aktive të aplikimeve të tregtisë elektronike kanë një probabilitet prej 1.752 herë më të madh sesa kompanitë pasive në përdorimin e tyre për të krijuar lehtësira në shkëmbimin e informacionit midis partnerëve të biznesit, me mjedisin e jashtëm (klientë, furnitorë, banka, qeveri, transportues, partnerë biznesi, komunitetin etj), për të krijuar akses për kompetenca manaxheriale apo oportunitete të reja për aleanca strategjike, etj.

Për të parë efektin e faktorëve që kanë shtyrë kompanitë të adoptojnë aplikimet e tregtisë elektronike mbi statusin e përdorimit të tyre tek kompanitë, u ndërtua përsëri një model i regresionit logjistik binar, nga ku vëmë re se faktorët e brendshëm të cilët kanë nxitur kompanitë të adoptojnë aplikimet e tregtisë elektronike e rrisin probabilitetin që kompanitë të jenë përdoruese aktive të këtyre aplikimeve krahasimisht me kompanitë përdoruese pasive. Pra siç pritej, kompanitë që kanë infrastrukturë të mjaftueshme IT për të suportuar tregtinë elektronike, punonjës kompetentë për të manaxhuar aplikimin e tregtisë elektronike, tregtia elektronike në linjë me strategjinë marketing, tregtia elektronike në linjë me strategjinë e biznesit, etj kanë 3 herë më shumë shanse për të qenë përdorues aktivë të aplikimeve të tregtisë elektronike

Ndërsa faktorët e tjerë nxitës të adoptimit të aplikimeve të tregtisë elektronike si Kosto, Perceptimi i riskut dhe Faktorët e jashtëm nuk kanë ndonjë lidhje statistikisht të rëndësishme me përdorimin aktiv të tregtisë elektronike nga kompanitë. Ndërkohë po të shtojmë si variabël shpjegues dhe jetëgjatësinë e kompanisë në treg, shohim që probabiliteti që kompanitë të jenë përdoruese aktive të aplikimeve të tregtisë elektronike rritet me numrin e viteve të kompanisë në treg.

5. Rekomandime

Manaxhimi i lartë i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ta shohë aplikimin e tregtisë elektronike si një aset për të krijuar avantazh konkurses. Në këtë këndvështrim ata duhet të rrisin investimet e tyre në teknologji si dhe të ndërmarrin iniciativa për të trajnuar dhe ndërgjegjësuar punonjësit e tyre lidhur me këtë aplikim.

Nga ana tjetër, kompanitë duhet të mundohen të aplikojnë të gjitha format e tregtisë elektronike, në mënyrë që të realizojnë performancë sa më të lartë. Ato nuk duhet të ngelen vetëm në aplikimin e e-mailit apo të promovimit të produktit dhe kompanisë në faqen e internetit, por duhet të përqipen që filozofinë e aplikimit të tregtisë elektronike ta përshtasin dhe ta adoptojnë me menyrën e të bërit biznes. Sa më shumë ta përfshijnë tregtinë elektronike në strategjinë e biznesit të tyre, sa më shume ta përshtasin strategjinë e marketingut me aplikimin e tregtisë elektronike aq më shumë avantazhe dhe përfitime ato do të realizojnë si në redukimin e kostove ashtu edhe në efikasitetin operacionale, si në komunikimin me konsumatorët ashtu edhe me krijimin e bazës së konsumatorëve besnikë.

Kompanitë e reja nuk duhet të presin deri sa të konsolidohen në treg për të përdorur tregtinë elektronike. Ato duhet menjëherë të fillojnë këtë aplikim për të përfituar në kohë avantazhet që ofron tregtia elektronike.

Kompanitë duhet të përpiqen të realizojnë një perceptim sa më mirë nga ana e konsumatorëve dhe të komunikojnë sa më afër me ta duke përdorur aplikimin e tregtisë elektronike. Në këtë mënyrë ata do të rrisin performancën e kompanisë në treg.

Nga ana tjetër edhe qeveria duhet të ofrojë suport më të lartë për bizneset e vogla dhe të mesme. Qoftë kjo në aspektin financiar, sepse dihet që këto biznese kanë burime financiare të limituara, qoftë në aspektin e suportit të infrastrukturës apo të ekspertizës.

REFERENCA

- Aghaunor, L. & Fotoh, X. 2006. *Factors Affecting e-commerce Adoption in Nigerian Banks*. JÖNKÖPING UNIVERSITY
- Alemayehu, M. (2005). *Exploring the reality of e-commerce benefits among businesses in developing countries*; Development Informatics. Paper No 22.
- Bakos, Yannis; Brynjolfsson, Eric (2000); *Bundling and Competition on the Internet: Aggregation Strategies for Information Goods*,
<http://www.stern.nyu.edu/~bakos/data> 2013-11-16.
- Chaffey, D. (2003), *Internet Marketing – Strategy, Implementation and Practice*, 2nd ed., Harlow, Prentice-Hall.
- Chaffey, D., Ellis-Chadwick, F., Mayer, R. and Johnston, K. (2009), *Internet Marketing – Strategy, Implementation and Practice*, 4th ed., Harlow, Prentice-Hall.
- Cape Province of South-Africa: Electronic Journal on Information Systems in Developing Countries*.
- Coupey, E. (2001), *Marketing and the Internet*, New Jersey, Prentice-Hall.
- Cragg, P.B. and King, M. (1993). *Small-firm computing: Motivators and inhibitors* MIS Quarterly, 17(1).
- Curtis, G. & Cobham, D. 2008. *Business Information Systems: Analysis, Design and Practice*. Pearson Education. United Kingdom
- Daniel, E. 2003, 'An exploration of the inside-out model: E-commerce integration in UK SMEs', *Journal of Small Businesses and Enterprise Development*, vol.10, no.3.
- Daniel, E., Wilson, H. and Myers, A. (2002). *Adoption of E-commerce by SMEs in the UK: towards a stage model*, *International Small Business Journal*, Vol.20, Iss. 3.
- Fillis, I., Johansson, U. & Wagner, B. 2003, 'A conceptualization of the opportunities and barriers to e-business development in the smaller firm', *Journal of Small Businesses and Enterprise Development*, vol. 10, no.3.
- Hofstede, G. (1984). *Cultural*
- KALAKOTA, R., ROBINSON, M. and TAPSCOTT, D. (2000). *e-Business 2.0: Roadmap for Success*, Addison-Wesley Pub.Co.
- Kalanje, C. (2002). *Enhancing the Competitiveness and Growth of SMEs: Marketing Challenges for SMEs*, 5th NASME International Conference and Exhibition [online]
<http://www.wipo.int/sme/en/documents/pdf/nasme.pdf> data 25.102013.
- Martinsons, M.G. (2008). *Relationship-based E-commerce: theory and evidence from China*. *Information Systems Journal*, 18.
- McAdam, R., Stevenson, P. & Armstrong, G. (2000), "Innovative change management in SMEs: beyond continuous improvement", *Logistic Information Management*, vol. 13, no. 3.
- Molla, A., & Licker, P. (2005). *eCommerce adoption in developing countries: a model and instrument*. *Information & Management*, 42(6).
- Montazemi, A., R. (2006). *How they manage IT: SMEs in Canada and the U.S.* *Communications of the ACM*, 49 (12).

- Moodley S. (2002). *Global market access in the Internet era: South Africa's wood furniture industry*. Internet Research: Electronic Networking Applications and Policy, 12(1).
- Moodley S., Morris, M., and Velia, M., (2003). *E-commerce for exporting garments from South Africa, digital dividend or leap of faith?*, Institute of development studies, University of Natal, Durban, 4041, Republic of South Africa.
- Moodley, S. (2003). "*The promise of e-business for less developed countries (LDCs)*", Int. J. Electronic Business, Vol. 1, No. 1 [online] <http://www.cob.calpoly.edu/~ijeb/5.pdf> data 25.04.2012.
- World Economic Forum. (2008b). *The Global Competitiveness Report 2008-2009*. <http://www.weforum.org/documents/GCR0809/index.html>
- Adoption of the Web: A Methodological Problem in Assessing Adoption of the World Wide Web for Electronic Commerce, Journal of the American Society for Information Science 35.
- Wrycza S & Gajda D.(2007). *Verification of E-business adoption models*. Proceedings of the 16th annual ISOnEworld Conference held in Las Vegas.
- Zott, C. and Donlevy, J. (2000). *Strategies for value creation in E-commerce: Best practice in Europe*.
- Zwass, V. (2000), "*Structure and macro-level impacts of electronic commerce: from technological infrastructure to electronic marketplaces*".

SEKTORI I TURIZMIT NË BALLKANIN PERËNDIMOR DHE NJË ANALIZË DESKRIPTIVE PËR INDEKsin E TURIZMIT KUPTIMLOTË

Enriko CEKO¹

Abstract

The purpose of this study is to examine some aspects related to the future of the tourism sector, making a comparison of the countries of the Western Balkans about this sector, which is influenced by political, economic, social, legal, cultural, etc.

The methodology used in this study was the collection of data related to the tourism sector and a comparative analysis of this sector among the countries of the Western Balkans.

The method used in this study was a descriptive analysis about the meaningful tourism index.

The main conclusion of the research is that tourism will be a sector with a growing trend in the short, medium, and long term and as such, it is a sector where the standardization of processes and procedures would increase comparative and competitive advantages between countries.

Key words: tourism, development, meaningful tourism index, standards, quality, quality management, ISO, economic advantages.

Hyrje

Midis viteve 1995 - 2019, turizmi ndërkombëtar pati një prirje pothuajse të qëndrueshme në rritje. Në këto 24 vite, numri i vizitorëve u rrit me më shumë se 130%. Vetëm në vitet pas 11 shtatorit 2001 dhe në kohën e krizës ekonomike në 2008 pati rënie të dukshme, ndërsa rënia globale më masive dhe e paprecedentë ndodhi përgjatë periudhës së pandemisë COVID-19, ndërsa pas saj të tëra vendet po bëjnë përpjekje që të kapin sa më shpejt parametrat e viteve 2018, 2019 në lidhje me numrin e turistëve, netëqendrimet, shpenzimet për natë qëndrimi për person dhe si pjesë e GDP (World Data. 2023). Gjithashtu, në vendet e Ballkanit Perëndimor pas periudhës së pandemisë vërehet një qasje e orientuar nga sektori i turizmit.

Rishikim literature

Turizmi ne Shqiperi

Shqipëria regjistroi gjithsej gjashtë milionë turistë në vitin 2021, duke u renditur e 25-ta në botë në terma absolute, ndërsa në vitin 2023 mendohet se kjo shifër të jetë rreth 10 milionë. Duke vendosur numrat e turistëve në raport me popullsinë e Shqipërisë, rezulton një pamje shumë e qartë. 3 – 4 turistë për banor, një ndër shifrat më të larta në rajon dhe në Evropë. Në vitin 2021, Shqipëria gjeneroi rreth 2.48 miliardë dollarë amerikanë vetëm në sektorin e turizmit. Kjo korrespondon me 13.13 për qind të produktit të brendshëm bruto dhe afërsisht 2 për qind të të gjitha të ardhurave nga turizmi ndërkombëtar në Evropën Jugore, ndërsa në vitin 2023 rreth 4 miliardë dollarë. Në vitin 1995, të ardhurat nga turizmi arritën në 70.00 milionë USD, ose rreth 2.9 për qind e prodhimit kombëtar bruto. Brenda 28 viteve, varësia e vendit nga turizmi është rritur në mënyrë drastike (Eordl Data. Albania. 2023)

Turizmi në Bosnje dhe Hercegovinë

Bosnja dhe Hercegovina regjistroi gjithsej 502,000 turistë në vitin 2021, duke u renditur e 100-ta në botë në terma absolute. Numrat e turistëve në raport me popullsinë e Bosnjë-Hercegovinës janë 0.16 turistë për banor, Bosnja dhe Hercegovina renditet e 90-ta në botë. Në Evropën

¹ Instituti Kanadez i Teknologjisë, Rruga Xhanfize Keko, Nr 12, Tiranë, Shqipëri, enriko.ceko@cit.edu.al, ORCID: 0000-0002-3372-2785

Jugore, ajo u rendit e 12-ta. Në vitin 2021, Bosnja dhe Hercegovina gjeneroi rreth 1.00 miliardë dollarë amerikanë vetëm në sektorin e turizmit. Kjo korrespondon me 4.1 për qind të produktit të brendshëm bruto dhe afërsisht 1 për qind të të gjitha të ardhurave nga turizmi ndërkombëtar në Evropën Jugore. Në vitin 1998, të ardhurat nga turizmi arritën në 257.00 milionë USD, ose rreth 6.2 për qind e prodhimit kombëtar bruto. Brenda 23 viteve, varësia e vendit nga turizmi është ulur lehtë. Para shpërthimit të pandemisë COVID-19, shitjet ishin 1.23 miliardë dollarë, 6.0 përqind e prodhimit kombëtar bruto.

Në vitin 2020, të ardhurat turistike ranë për shkak të pandemisë COVID-19. Nga 1.23 miliardë dollarë (2019), mbetën vetëm 438.00 miliardë dollarë. Kjo është një rënie prej 64 për qind në Bosnje dhe Hercegovinë.

Mesatarisht, secili nga turistët e mbërritur në vitin 2021 ka shpenzuar rreth 1897 dollarë amerikanë (Eorl Data. Bosnia & Herzegovina. 2023).

Turizmi në Mal të Zi

Mali i Zi regjistroi gjithsej dy milionë turistë në vitin 2021, duke u renditur i 56-ti në botë në terma absolutë. Duke i vendosur numrat e turistëve në raport me popullsinë e Malit të Zi, rezultati është një pamje shumë më e krahasueshme: Me 2.5 turistë për banor, Mali i Zi renditet i 13-ti në botë. Në Evropën Jugore, ajo u rendit e 4-ta.

Në vitin 2021, Mali i Zi gjeneroi rreth 902.00 milionë dollarë amerikanë vetëm në sektorin e turizmit. Kjo korrespondon me 14.80 për qind të produktit të brendshëm bruto dhe afërsisht 1 për qind të të gjitha të ardhurave nga turizmi ndërkombëtar në Evropën Jugore. Në vitin 2007, të ardhurat nga turizmi arritën në 660,00 milionë USD, ose rreth 17,93 për qind e prodhimit kombëtar bruto. Brenda 14 viteve, varësia e vendit nga turizmi është rritur ndjeshëm. Para shpërthimit të pandemisë COVID-19, shitjet ishin 1.28 miliardë dollarë, 23.02 për qind e prodhimit kombëtar bruto. Në vitin 2020, të ardhurat turistike ranë për shkak të pandemisë COVID-19. Nga 1.28 miliardë dollarë (2019), kanë mbetur vetëm 180.00 miliardë dollarë. Kjo është një rënie prej 86 për qind në Mal të Zi. Mesatarisht, secili nga turistët e mbërritur në vitin 2021 ka shpenzuar rreth 551 dollarë amerikanë (Eorl data. Montenegro. 2023).

Turizmi në Maqedoninë e Veriut

Maqedonia e Veriut regjistroi gjithsej 294,000 turistë në vitin 2021, duke u renditur në vendin e 122-të në botë në terma absolutë. Duke i vendosur numrat e turistëve në raport me popullsinë e Maqedonisë së Veriut, rezultati është një pamje shumë më e krahasueshme: Me 0,14 turistë për banor, Maqedonia e Veriut renditet e 92-ta në botë. Në Evropën Jugore, ajo u rendit e 13-ta. Në vitin 2021, Maqedonia e Veriut gjeneroi rreth 387.00 milionë dollarë amerikanë vetëm në sektorin e turizmit. Kjo korrespondon me 2.9 përqind të produktit të brendshëm bruto dhe afërsisht 0 përqind të të gjitha të ardhurave nga turizmi ndërkombëtar në Evropën Jugore. Në vitin 1995, të ardhurat nga turizmi arritën në 19.00 milionë USD, ose rreth 0.40 për qind e prodhimit kombëtar bruto. Brenda 26 viteve, varësia e vendit nga turizmi është rritur në mënyrë drastike. Para shpërthimit të pandemisë COVID-19, shitjet ishin 401.00 milionë dollarë, 3.2 për qind e prodhimit kombëtar bruto. Në vitin 2020, të ardhurat turistike ranë për shkak të pandemisë COVID-19. Nga 401.00 milion dollarë (2019), mbetën vetëm 253.00 milion dollarë. Kjo është një rënie prej 37 për qind në Maqedoninë e Veriut. Mesatarisht, secili nga turistët e mbërritur në vitin 2021 ka shpenzuar rreth 1250 dollarë amerikanë (Eorl Data. Macedonia North Republic. 2023).

Turizmi në Serbi

Serbia regjistroi gjithsej 871,000 turistë në vitin 2021, duke u renditur e 76-ta në botë në terma absolutë. Duke u vendosur numrat e turistëve në raport me popullsinë e Serbisë, rezultati është një pamje shumë më e krahasueshme: me 0.13 turistë për banor, Serbia renditet e 97-ta në botë. Në Evropën Jugore, ajo u rendit e 14-ta.

Në vitin 2021, Serbia gjeneroi rreth 2.17 miliardë dollarë amerikanë vetëm në sektorin e turizmit. Kjo korrespondon me 3.4 për qind të produktit të brendshëm bruto dhe afërsisht 2 për qind të të gjitha të ardhurave nga turizmi ndërkombëtar në Evropën Jugore. Në vitin 2002, të ardhurat nga turizmi arritën në 77.00 milionë USD, ose rreth 0.45 për qind e prodhimit kombëtar bruto. Brenda 19 viteve, varësia e vendit nga turizmi është rritur në mënyrë drastike. Para shpërthimit të pandemisë COVID-19, shitjet ishin 2.00 miliardë dollarë, 3.9 për qind e prodhimit kombëtar bruto. Në vitin 2020, të ardhurat turistike ranë për shkak të pandemisë COVID-19. Nga 2.00 miliardë dollarë (2019), mbetën vetëm 1.42 miliardë dollarë. Kjo është një rënie prej 29 për qind në Serbi. Mesatarisht, secili nga turistët e mbërritur në vitin 2021 ka shpenzuar rreth 2,368 dollarë amerikanë (World Data. Serbia 2023).


Tabela 1. Numri i turistëve, faturat dhe të ardhurat si përqindje e GDP për vendet e Ballkanit Perëndimor.

	ALB	ALB	ALB	B&H	B&H	B&H	MNG	MNG	MNG	MKD	MKD	MKD
Year	Tourists	Receipts	%GNP	Tourists	Receipts	%GNP	Tourists	Receipts	%GNP	Tourists	Receipts	%GNP
1995	0.304	0.700	2.90							0.147	0.019	0.40
1996	0.287	0.940	2.90							0.136	0.035	0.75
1997	0.119	0.340	1.50	0.115						0.121	0.029	0.74
1998	0.184	0.600	2.40	0.148	0.257	6.20				0.157	0.030	0.80
1999	0.371	0.218	6.80	0.147	0.258	5.50				0.181	0.080	2.10
2000	0.317	0.398	11.44	0.171	0.246	4.40				0.224	0.088	2.30
2001	0.354	0.451	11.50	0.139	0.279	4.80				0.990	0.049	1.30
2002	0.470	0.492	11.32	0.160	0.307	4.60	0.136			0.123	0.055	1.40
2003	0.557	0.537	9.60	0.165	0.404	4.80	0.142			0.158	0.086	1.70
2004	0.645	0.756	10.52	0.190	0.507	5.00	0.188			0.165	0.103	1.80
2005	0.748	0.880	10.93	0.217	0.557	5.00	0.272			0.197	0.116	1.90
2006	0.937	1.060	11.88	0.256	0.658	5.10	0.378			0.202	0.156	2.30
2007	1.060	1.480	13.85	0.306	0.804	5.10	0.984	0.660	17.93	0.230	0.219	2.60
2008	1.250	1.850	14.36	0.322	0.913	4.80	1.030	0.859	18.90	0.255	0.262	2.60
2009	1.710	2.010	16.71	0.311	0.753	4.30	1.040	0.792	19.04	0.259	0.232	2.50
2010	2.190	1.780	14.91	0.365	0.662	3.90	1.090	0.765	18.46	0.262	0.199	2.10
2011	2.470	1.830	14.22	0.392	0.722	3.90	1.200	0.926	20.38	0.327	0.242	2.30
2012	3.160	1.620	13.17	0.439	0.686	4.00	1.260	0.860	21.04	0.351	0.237	2.40
2013	2.860	1.670	13.07	0.529	0.752	4.10	1.320	0.929	20.81	0.400	0.270	2.50
2014	3.340	1.850	13.98	0.536	0.755	4.10	1.350	0.959	20.88	0.425	0.298	2.60
2015	4.130	1.610	14.17	0.678	0.794	4.80	1.560	0.947	23.36	0.486	0.268	2.70

2016	4.740	1.820	15.35	0.778	0.875	5.10	1.660	0.978	22.34	0.510	0.283	2.70
2017	5.120	2.050	15.75	0.923	0.984	5.40	1.880	1.110	22.86	0.631	0.331	2.90
2018	5.930	2.310	15.21	1.000	1.150	5.60	2.080	1.220	22.23	0.707	0.387	3.10
2019	6.410	2.460	15.96	1.000	1.230	6.00	2.510	1.280	23.02	0.758	0.401	3.20
2020	2.660	1.240	8.20	0.197	0.438	2.20	0.351	0.180	3.80	0.118	0.253	2.00
2021	5.520	2.480	13.83	0.502	1.000	4.20	1.550	0.902	15.39	0.294	0.387	2.80
2022	7.100			0.908			2.184			0.537		


Burimi: World Data. 2023

Grafiku 1. Numri i turistëve në vendet e Ballkanit Perëndimor 1996 - 2022




Burimi: World Data. 2023

Grafiku 2. Faturat në sektorin e turizmit në vendet e Ballkanit Perëndimor 1996 – 2022



Burimi: World Data. 2023

Grafiku 3. Të ardhurat nga turizimi në vendet e Ballkanit Perëndimor 1996 – 2022



Burimi: World Data. 2023

Siç shikohet edhe nga trendi i tabelës dhe grafikëve të numrit të turistëve, numrit të faturave dhe ndikimit që ka sektori i turizmit në GDP të vendeve të Ballkanit Perëndimor, ky sektor është një sektor që ka të ardhme të garantuar në rajon, por mbështetja e sektorit me politika zhvillimore dhe me aplikimin e proceseve, procedurave, rregulloreve dhe rekordeve që sektori i turizmit kërkon, të cilat janë attribute të standardeve ISO (dhe jo vetëm), është një domosdoshmëri imediate.

Rajoni i Ballkanit mund të ofrojë shumë përvoja të ndryshme nga gastronomia, në trashëgiminë natyrore dhe kulturore, traditat, mikpritjen, vendet historike, brigjet mbresëlënëse dhe shumë më tepër. Rajoni shtrihet në një udhëkryq, ku perandoritë u takuan, luftuan dhe u kombinuan për të formuar një kaleidoskop kulturash unike në Evropë, që lanë gjurmën e tyre të pashlyeshme në arkitekturën, kuzhinën, gjuhët, muzikën dhe traditat lokale.

Ka disa çështje themelore që do të sfidojnë çdo përpjekje për të zhvilluar një vizion të përbashkët për turizmin rajonal të bazuar në zhvillimin e qëndrueshëm. Mbetet një mungesë konsensusi për përfitimet reciproke (të ardhurat, vendet e punës dhe mundësitë e investimeve) të produkteve të përbashkëta turistike. Këmbëngulja dhe rritja e kohëve të fundit në ndjenjat nacionaliste ka përforcuar konkurrencën mbi qasjet bashkëpunuese, ka përkeqësuar “problemin e markës” të rajonit dhe e ka bërë të vështirë festimin e diversitetit të rajonit. Lidhja është e kufizuar midis qyteteve të rajonit dhe rrjetet e transportit janë të dobëta. Mungesa e një platforme për shkëmbimin e informacionit për këshilla dhe udhëzime të dobishme është identifikuar gjithashtu si një sfidë.

Për sa i përket kapacitetit, rajoni nuk performon më mirë në cilësinë dhe statusin e programeve turistike, ndërkohë që mungojnë mjetet ose rrjetet bashkëpunuese që mund të lehtësojnë bashkëpunimin dhe të ndihmojnë në menaxhimin dhe promovimin e një 'produkti' turistik rajonal.

Forcimi i infrastrukturës së transportit identifikohet si kritik për përmirësimin e turizmit rajonal dhe rritjen e qëndrueshme ekonomike në Ballkan. Megjithatë, investimet në infrastrukturë nuk do të ndodhin pa bashkëpunimin rajonal, ndërtimin e konsensusit dhe vullnetin politik; këto janë parakushte. Për shembull, planet aktuale për projekte transporti me përfitim reciprok, si Autostrada e Adriatikut, kërkojnë më shumë promovim të avantazheve të qarta që ato do të ofronin nëpërmjet nismave modeste që lidhin bashkitë përtej kufijve, prodhojnë përfitime të prekshme për komunitetet dhe gjenerojnë kërkesë lokale për infrastrukturë të përmirësuar. Problematika e bashkëpunimit:

- Veprimi i përbashkët është thelbësor për zhvillimin dhe rritjen e mëtejshme të rajonit.
- Ka një lidhje dhe bashkëpunim të kufizuar ndërmjet vendeve në fushën e turizmit.
- Institucioneve (si publike ashtu edhe private) u mungon vullneti politik apo kapaciteti për të zhvilluar dhe zbatuar një model të zhvillimit të integruar të turizmit.
- Ka shfrytëzim të pamjaftueshëm të fondeve në dispozicion të BE-së dhe institucioneve të tjera zhvillimore ndërkombëtare dhe dypalëshe.
- Edukimi joadekuat i profesionistëve të turizmit që operojnë në terren, në të gjithë rajonin (Balkan Forum. 2022).

Disa nga potencialet që rekomandohen janë:

- Mbështetja e bizneseve familjare në turizëm, veçanërisht në zonat rurale dhe vendet që luftojnë me nivele të larta të papunësisë tek të rinjtë dhe gratë.
- Rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e ekologjisë dhe eko-qëndrueshmërisë në ritmin me zhvillimin e turizmit
- Inkurajimi i sipërmarrësve vendas për hapjen e bizneseve anësore me oferta plotësuese në vendet e pa populluara.
- Eksplorimi i potencialit për lidhjet ndërkufitare dhe itineraret ndërkufitare dhe rretëzimin e biznesit
- Promovimi i mundësive për qasje të unifikuar të vendeve të Ballkanit ndaj tregjeve të largëta në vend të qasjes së njohur të “konkurrentëve”.
- Edukimi i popullsisë – banorët vendas që mund të marrin pjesë në krijimin e ofertës nuk janë aktualisht të sigurt me shpikjet, kryesisht sepse ata janë lloji i kundërt i udhëtarit sesa turistët që do t'u ofrojnë. Ky boshllëk mund të kapërcehet vetëm me arsimim joformal dhe duke treguar përvoja pozitive nga dora e parë (Balkan Forum. 2022).

Përsa i përket turizmit në rajon, e tëra është më e madhe se shuma e pjesëve. Edhe pse relativisht e vogël në sipërfaqe dhe popullsi, vendet individuale ofrojnë përvoja spektakolare më vete. Promovimi i rajonit, përtej aktivitetëve promovuese specifike të vendit që zakonisht ndërmerren nga programet e turizmit, rrit më tej atraktivitetin e vendeve të Ballkanit për turistët në të gjithë botën. Një integrim i tillë rajonal zgjeron dhe thëllon ndikimin e zhvillimit ekonomik të vendeve individuale dhe komuniteteve të lidhura dhe ringjall marrëdhëniet ndërkufitare që pësuan ose u ndërprejnë pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë (Balkan Forum. 2022).

Standardet ISO dhe turizmi

Organizata Ndërkombëtare për Standardizim (ISO) publikon standarde që ndihmojnë në zbatimin e sistemeve të sistematizuara të menaxhimit për të siguruar produkte dhe shërbime cilësore si dhe mundësojnë pajtueshmërinë me rregulloret përkatëse. Çertifikatat ISO kanë një rëndësi të madhe në një gamë të ndryshme industrish. Ato jo vetëm që ndihmojnë në përmirësimin e proceseve brenda organizatës, por gjithashtu sigurojnë një rrjedhë të qetë të shërbimeve në të gjithë zinxhirin e furnizimit. Çertifikatat ISO të akredituara globalisht janë të dobishme për pothuajse të gjitha industritë në botë. Industria e turizmit është sektori kryesor që kontribuon jashtëzakonisht shumë në rritjen ekonomike të vendit. Industria e turizmit besohet të jetë nxitësi i të ardhurave të ekonomisë së çdo vendi. Prandaj, kohët e fundit ka pasur një rritje të menjëhershme të kërkesës për ruajtjen e cilësisë dhe efikasitetit në industrinë e turizmit. Çertifikimi ISO për industrinë e turizmit mund të ndihmojë bizneset turistike të ofrojnë

produkte ose shërbime cilësore për turistët ose vizitorët. Certifikimi ISO për sektorin e turizmit është gjithashtu mjaft produktiv në përmbushjen e nevojave dhe kërkesave të turistëve. Çertifikatat ISO kanë potencialin më të lartë në ofrimin e produkteve ose shërbimeve të garantuara me cilësi për industrinë e turizmit, gjë që ndihmon në krijimin e fitimeve të mëdha për kompaninë. Çertifikatat ISO ndihmojnë në ngritjen e reputacionit të kompanisë duke demonstruar se organizata e biznesit është e përkushtuar në përmbushjen e standardeve të përsosmërisë të njohura ndërkombëtarisht. Çertifikatat ISO janë standarde të njohura ndërkombëtarisht që nevojiten shumë për t'u përmbushur nga industria e turizmit në mënyrë që ato të shfaqen si sisteme menaxheriale efikase dhe efektive. Industrinë e turizmit janë ato industri që përfshijnë shumë rreziqe si terrorizmi, lufta ose paqëndrueshmëria politike. Si rezultat, ekziston një shqetësim i lartë në lidhje me cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve turistike. Me ndihmën e çertifikimit ISO për industrinë e turizmit, sektori i turizmit mund të provojë efektivitetin dhe efikasitetin e tij në përputhje me standardet e kërkuara për turistët apo vizitorët. Çertifikatat ISO ndihmojnë në:

- Ofrimin më metodik të shërbimeve, duke përmirësuar reputacionin dhe duke ndihmuar për të fituar turistë ose vizitorë të rinj dhe për të mbajtur turistët ose vizitorët aktualë.
- Marrjen e masave të nevojshme për të reduktuar ndikimin e incidenteve në vendin e punës.
- Njohjen dhe administrimin e rreziqeve aktuale dhe të ardhshme për biznesin.

Çertifikimi ISO vlen për pothuajse të gjitha llojet e industrive turistike, pavarësisht nga madhësia, lloji ose procesi i tyre. Çertifikatat ISO luajnë një rol të rëndësishëm në nxitjen e rritjes së çdo industrie në botë. Për çdo organizatë, çertifikimi ISO është arritja përfundimtare për të garantuar që produktet dhe shërbimet e tyre janë të cilësisë më të mirë. Kështu, arritja e çertifikimit ISO për bizneset tuaja turistike mund t'ju shpërblejë me fitime të mëdha.

Çertifikatat ISO për industrinë e turizmit reduktojnë ripërpunimin e proceseve në organizatë, gjë që në këmbim inkurajon kursimet e kostos në organizatën tuaj.

Disa nga përfitimet e të paturit të çertifikimit ISO për biznesin tuaj turistik janë si më poshtë:

1. Me ndihmën e çertifikimit ISO, subjektet mund të përmirësohen vazhdimisht në të gjitha proceset.
2. Çertifikimi ISO mund të manifestojë qëllime ose synime të reja për t'u arritur nga organizata.
3. Me ndihmën e çertifikimit ISO, subjekti mund të konkurrojë në nivel ndërkombëtar me konkurrentë të tjerë të fuqishëm.
4. Me ndihmën e çertifikimit ISO, subjekti mund të përmbushë pritshmëritë e turistëve ose vizitorëve duke u ofruar atyre produkte ose shërbime të sigurta dhe të bazuara në cilësi.
5. Me ndihmën e çertifikimit ISO, subjekti mund të ofronjë një bazë për ofrimin efektiv dhe efikas të produkteve dhe shërbimeve dhe t'u jepni theks të lartë balancimit të përdorimit të energjisë duke inkurajuar kursimin e kostos në organizatë.

Tabela 2. Standardet ISO që mbështesin zhvillimin e turizmit

No	ISO standard	Explanation
1	ISO 9001	Quality management system
2	ISO 14001	Environment protection
3	ISO 27001	Information technology management
4	ISO 45001	Health and safety at work
5	ISO 50001	Energy efficiency

Burimi: www.iso.org

Tabela 3. Standardet specifike lidhur me sektorin e turizmit

No	ISO standard	Explanation
1	ISO 13009	Tourism and related services — Requirements and recommendations for beach operation
2	ISO 14785	Tourism information offices — Tourist information and reception services — Requirements
3	ISO 17049	Accessible design — Application of braille on signage, equipment and appliances
4	ISO 21902	Tourism and related services — Accessible tourism for all — Requirements and recommendations.
5	ISO 23599	Assistive products for blind and vision-impaired persons — Tactile walking surface indicators, helps them visit new places more easily and safely

Burimi: www.iso.org

Indeksi i turizmit kuptimplotë

Indeksi i turizmit kuptimplotë 2023, i publikuar në maj 2023, ofron informacion dhe renditje që tregojnë gjendjen e zhvillimit të turizmit kuptimplotë për 88 vendet më të rëndësishme në turizmin ndërkombëtar.

Turizmi kuptimplotë është një mjet i fuqishëm për destinacionet dhe të gjithë ofruesit e shërbimeve në turizëm, mikpritje, shitje me pakicë dhe transport për të ecur përpara në arritjen e rezultateve pozitive të zhvillimit të turizmit pas pandemisë për të gjithë aktorët e përfshirë.

Për të dhënë një zgjidhje pozitive për zhvillimin e turizmit pas pandemisë, paradigma e turizmit kuptimplotë është zhvilluar si përgjigje ndaj nevojës për të ecur përpara nga konceptet e Turizmit të Qëndrueshëm dhe Turizmit të Përgjegjshëm, të cilat nuk kanë mundur të arrijnë ndryshime thelbësore në se si rritja e turizmit filloi të shndërrohej në një forcë negative, shkatërruese në vend të një aktiviteti të lidhur me kënaqësinë, përvojat, miqësinë, paqen dhe zhvillimin ekonomik veçanërisht të vendeve me të ardhura të ulëta (Meaningful tourism. 2023.a).

Bazuar në konceptet e Qëndrueshmërisë Hedonike, Psikologjisë Pozitive dhe gjeneratës së tretë të Ekonomisë së Eksperiencës si pjesë e ekonomisë së transformimit, Cilësia, Përfitimet dhe Kënaqësia për të gjithë aktorët janë elementët kryesorë të Turizmit kuptimplotë.

Turizmi i qëndrueshëm dhe i përgjegjshëm në shumicën e rasteve ofron propozime negative se çfarë duhet bërë më pak ose të mos bëhet fare dhe çfarë duhet paguar më shumë, pa dhënë shumë përfitime në këmbim, përveç një vetëdije të mirë. Turizmi kuptimplotë nuk ka të bëjë me sakrificat dhe reduktimet, përkundrazi ai ofron mënyra për të krijuar përfitime dhe kënaqësi bazuar në interesat specifike të të gjithë të përfshirëve: të ftuarit, nikoqirët, punonjësit, kompanitë, qeveritë dhe mjedisi (Meaningful tourism. 2023.b).

Tabela 4. Listimi i vendeve për turizmin kuptimplotë dhe ndarja e këtyre vendeve në kuartilje sipas ngjyrave, e verdhë kuartilja e parë (1 - 25%), portokalli kuartilja e dytë (26 – 50%), jeshile kuartilja e tretë (51 – 75%) dhe blu kuartilja e katërt (76 – 100%).

Country	Index	No	Country	Index	No	Country	Index	No	Country	Index	No	Country
Japan	55.09	19	Japan	44.69	37	Malaysia	39.58	55	Brazil	36.42	73	Tanzania
Italy	54.85	20	Italy	44.26	38	Mauritius	39.54	56	Dominic Rep	36.29	74	Turkiye
Belgium	50.4	21	Belgium	44.13	39	Chile	38.93	57	Bahrain	35.83	75	Serbia
Slovenia	49.52	22	Slovenia	44.12	40	Hungary	38.55	58	Albania	35.83	76	Ukraine
USA	48.91	23	USA	43.47	41	Slovakia	38.37	59	Oman	35.46	77	India
Bahamas	48.53	24	Bahamas	43.37	42	Mexico	38.19	60	Kazakhstan	35.38	78	Russia FED
Estonia	48.33	25	Estonia	42.1	43	Cuba	38.15	61	Argentina	35.3	79	Azerbaijan
Rep Korea	48.23	26	Rep Korea	42.69	44	Uruguay	37.99	62	Cambodia	35.21	80	S. Africa
Maldives	48.07	27	Maldives	41.53	45	Qatar	37.78	63	Colombia	35.2	81	Ethiopia
Czechia	47.93	28	Czechia	41.23	46	Poland	37.67	64	Tunisia	35.09	82	Iran
Costa Rica	47.62	29	Costa Rica	41.02	47	Romania	37.51	65	S. Arabia	35	83	Myanmar
Israel	47.51	30	Israel	41	48	China	37.39	66	Ecuador	34.99	84	Lebanon
Croatia	47.45	31	Croatia	40.98	49	Vietnam	37.23	67	Jordan	34.99	85	Nigeria
UAE	46.04	32	UAE	40.83	50	Jamaica	37.17	68	Morocco	34.89	86	Iraq
Greece	45.41	33	Greece	40.81	51	Bulgaria	36.94	69	Peru	34.69		
Cyprus	45.29	34	Cyprus	40.67	52	Panama	36.89	70	Indonesia	34.64		
Thailand	45.16	35	Thailand	40.07	53	Georgia	36.76	71	Sri Lanka	34.45		
Philippines	45.06	36	Philippines	39.96	54	P. Rico	36.44	72	Egypt	34.18		

3. Metodologjia dhe analiza e të dhënave

Metodologjia e përdorur në këtë studim ka qenë grumbullimi i të dhënave në lidhje me sektorin e turizmit dhe bërja e një analize krahasuese për këtë sektor midis vendeve të Ballkanit Perëndimor. Metoda e përdorur në këtë studim ka qenë ajo e analizës deskriptive në lidhje me indeksin e turizmit kuptimplotë. Rasti u zgjodh në bazë të tre kriterëve kryesorë: një qasje teorike, përshtatshmëria e marrëdhënieve dhe ndikimet praktike pozitive në sektorin e turizmit në vendet e Ballkanit Perëndimor. Të dhënat për turizmin në botë dhe në vendet e Ballkanit Perëndimor u grumbulluan nga Ëorl Data 2023, ndërsa të dhënat për turizmin kuptimplotë nga Raporti I turizmit kuptimplotë 2023, vizituar gjatë muajit dhjetor 2023. Të dhënat për turizmin në Ballkanin Perëndimor të mbledhura nga Raporti Ëorl Data, u përdorn për ndërtimin e tabelës përkatëse dhe për përgatitjen e grafikëve për numrin e turistëve, numrin e faturave dhe ndikimi e sektorit të turizmit në GDP të vendeve të Ballkanit Perëndimor, ndërsa të dhënat për turizmin kuptimplotë nga Raporti i Indeksit të Turizmit Kuptimplotë u përdorën për të ndërtuar analizën përshkruese dhe kuartiljet.

Tabela 5. Analiza deskriptive dhe kuartiljet për Indeksin e Turizmit Kuptimplotë.

Indeksi i Turizmit Kuptimplotë	
Mean	39.41244
Standard Error	0.632771
Median	38.07
Mode	35.83
Standard Deviation	5.868078
Sample Variance	34.43434
Kurtosis	-0.21541
Skewness	0.544291
Range	28.16
Minimum	26.93
Maximum	55.09
Sum	3389.47
Count	86
Largest(1)	55.09
Smallest(1)	26.93
Confidence Level(95.0%)	1.258118

Nga analiza deskriptive del se Mean është 39.41244, kur vlera maksimale është 55.09 dhe vlera më e ulët është 26.93. Ndërkaq, vetëm 9 vende janë në kuartiljen e parë, 17 vende në kuartiljen e dytë, 43 vende në kuartiljen e tretë dhe 11 vende në kuartiljen e katërt. Kjo tregon se ka një diferencë të madhe midis vendeve listuar në Indeksin e Turizmit Kuptimplotë kryesisht në aspektin e standardizimit të proceseve, procedurave, rregulloreve dhe rekordeve, për të cilat janë standardet ISO që ndihmojnë dhe kjo tregon se edhe pse në vendet përkatëse ka subjekte të çertifikuara me standard ISO, këto nuk janë të lidhura ngushtë me sektorin e turizmit.

3.1 Implikimet për teorinë dhe praktikën

Në lidhje me teorinë, bazuar në rezultatet përfundimtare të këtij hulumtimi, është hapur një dritare e re për kërkime të mëtejshme në fushën e turizmit kuptimplotë dhe marrëdhëniet eektorit të turizmit me standardet ISO.

Artikulli kontribuon jo vetëm në çështjen e rankimit të vendeve në lidhje me turizmin kuptimplotë, si një koncept mjaft i ri (vetëm në vitin 2023 është publikuar për herë të parë ky raport/indeks).

Artikulli shqyrton qasjet që promovojnë përgatitjen dhe përdorimin e indekseve për turizminsi një artikull teorik, i bazuar në një studim empirik, duke përdorur metoda sasiore, i orientuar drejt praktikës, që shpreh ndryshimet aktuale në ekonominë, shoqërinë dhe shkencën globale për çështjen e turizmit dhe marrëdhëniet e tij me standardet ISO.

3.2 Kufizimet dhe kërkimet e mëtejshme

Ky hulumtim është ndërmarrë duke përdorur të dhëna të besueshme nga World Data dhe hulumtime dhe llogaritje të mëtejshme nevojiten çdo vit për të prodhuar një indeks vjetor për turizmin kuptimplotë së bashku me analizat descriptive për këtë indeks. Kërkime dhe llogaritje të mëtejshme nevojiten çdo vit për të prodhuar indekse vjetore, dhe kjo është dera që ky kërkim hap për kontribues të tjerë në këtë lëmi.

Konkluzione

1. Midis viteve 1995 - 2019, turizmi ndërkombëtar pati një prirje pothuajse të qëndrueshme në rritje. Në këto 24 vite, numri i vizitorëve u rrit me më shumë se 130%. Vetëm në vitet pas 11 shtatorit 2001 dhe në kohën e krizës ekonomike në 2008 pati rënie të dukshme, ndërsa rënia globale më masive dhe e paprecedentë ndodhi përgjatë periudhës së pandemisë COVID-19, ndërsa pas saj të tëra vendet po bëjnë përpjekje që të kapin sa më shpejt parametrat e viteve 2018, 2019 në lidhje me numrin e turistëve, netëqendrimit, shpenzimet për natë qëndrimi për person dhe si pjesë e GDP.
2. Problematika e bashkëpunimit në lidhje me sektorin e turizmit ka të bëjë me veprimet e përbashkëta, bashkëpunimin e kufizuar ndërmjet vendeve në fushën e turizmit, mungesën e vullnetit politik apo kapacitetit për të zhvilluar dhe zbatuar një model të zhvillimit të integruar të turizmit, shfrytëzimin e pamjaftueshëm të fondeve në dispozicion të BE-së dhe institucioneve të tjera zhvillimore ndërkombëtare dhe dypalëshe, edukimin joadekuat të profesionistëve të turizmit që operojnë në terren, në të gjithë rajonin.
3. Zhvillimi i turizmit në rajon mund të mbështete dhe nxitet nga suporti i bizneseve familjare në turizëm, veçanërisht në zonat rurale dhe vendet që luftojnë me nivele të larta të papunësisë tek të rinjtë dhe grate, rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e ekologjisë dhe eko-qëndrueshmërisë në ritmin me zhvillimin e turizmit, inkurajimi i sipërmarrësve vendas për hapjen e bizneseve anësore me oferta plotësuese në vendet e pa populluara, eksplorimi i potencialit për lidhjet ndërkufitare dhe itineraret ndërkufitare dhe rrjetëzimin e biznesit, promovimi i mundësive për qasje të unifikuar të vendeve të Ballkanit ndaj tregjeve të largëta në vend të qasjes së njohur të “konkurrentëve”, edukimi i popullsisë – banorët vendas që mund të marrin pjesë në krijimin e ofertës nuk janë aktualisht të sigurt me shpikjet, kryesisht sepse ata janë lloji i kundërt i udhëtarit sesa turistët që do t'u ofrojnë. Ky boshllëk mund të kapërchet vetëm me arsimim joformal dhe duke treguar përvoja pozitive nga dora e parë.
4. Industria e turizmit është sektori kryesor që kontribuon jashtëzakonisht shumë në rritjen ekonomike të rajonit të Ballkanit Perëndimor. Industria e turizmit besohet të jetë nxitësi i të ardhurave të ekonomisë së çdo vendi në rajon dhe ë tërësi.
5. Çertifikimi ISO për industrinë e turizmit mund të ndihmojë bizneset turistike të ofrojnë produkte ose shërbime cilësore për turistët ose vizitorët, sepse është gjithashtu mjaft produktiv në përmbushjen e nevojave dhe kërkesave të turistëve.
6. Turizmi kuptimplotë është një mjet i fuqishëm për destinacionet dhe të gjithë ofruesit e shërbimeve në turizëm, mikpritje, shitje me pakicë dhe transport për të ecur përpara në arritjen e rezultateve pozitive të zhvillimit të turizmit pas pandemisë për të gjithë aktorët e përfshirë.
7. Sektori i turizmit në vendet e Ballkanit Perëndimor është një sektor që ka të ardhme të garantuar, por mbështetja e sektorit me politika zhvillimore dhe me aplikimin e proceseve, procedurave, rregulloreve dhe rekordeve që sektori i turizmit kërkon, të cilat janë attribute të standardeve ISO (dhe jo vetëm), është një domsodoshmëri imediate.

8. Nga analiza deskriptive e Indeksit të Turizmit Kuptimplotë 2023, del se Mean është 39.41244, kur vlera maksimale është 55.09 dhe vlera më e ulët është 26.93. Ndërkaq, vetëm 9 vende janë në kuartiljen e parë, 17 vende në kuartiljen e dytë, 43 vende në kuartiljen e tretë dhe 11 vende në kuartiljen e katërt. Kjo tregon se ka një diferencë të madhe midis vendeve listuar në Indeksin e Turizmit Kuptimplotë kryesisht në aspektin e standardizimit të proceseve, procedurave, rregulloreve dhe rekordeve, për të cilat janë standardet ISO që ndihmojnë dhe kjo tregon se edhe pse në vendet përkatëse ka subjekte të çertifikuara me standard ISO, këto nuk janë të lidhura ngushtë me sektorin e turizmit.

Literaturë

1. Balkan Forum. 2022. Research on tourism in the Western Balkans. <https://thebalkanforum.org/en/research-on-tourism-in-the-western-balkans>
2. ISO. 2023. **GET ISO Certification for the Tourism Industry.** <https://www.siscertifications.com/iso-certification-for-tourism-industries/#:~:text=The%20most%20commonly%20required%20ISO,Health%20and%20Safety%20Management%20System>. Vizituar nw 19 dhjetor 2023
3. Meaningful tourism. 2023.a. <https://meaningful-tourism.com/>. Vizituar nw 19 dhjetor 2023
4. Meaningful tourism. 2023.b. <https://meaningful-tourism.com/about/>. Vizituar nw 19 dhjetor 2023
5. World Data. 2023. <https://www.worlddata.info/tourism.php>. Vizituar nw 19 dhjetor 2023
6. World Data. Albania. 2023. <https://www.worlddata.info/europe/albania/tourism.php>. Vizituar nw 19 dhjetor 2023
7. World Data. Bosnia & Herzegovina. 2023. <https://www.worlddata.info/europe/bosnia-and-herzegovina/tourism.php>. Vizituar nw 19 dhjetor 2023
8. World Data. Montenegro. 2023. <https://www.worlddata.info/europe/montenegro/tourism.php>. Vizituar nw 19 dhjetor 2023
9. World Data. Macedonia North Republic. 2023. <https://www.worlddata.info/europe/northmacedonia/tourism.php>. Vizituar nw 19 dhjetor 2023
10. World Data. Serbia 2023. <https://www.worlddata.info/europe/serbia/tourism.php>. Vizituar nw 19 dhjetor 2023

KORNIZË E TË MËSUARIT TË THELLË PËR PARASHIKIMIN E SERIVE KOHORE ME NJË NDRYSHORE PËR NJË APO SHUMË HAPA PËRPARA

Blerina VIKA¹, Dhimitri TOLE²

Abstract

A lot of research works provide evidence that deep learning models are becoming an increasingly important tool for estimating and forecasting time series with various complexity characteristics. Time series have been highly used in various fields, such as meteorology, signal processing, economics, etc. Intelligent financial forecasting offers a promising approach that can considerably enhance the efficiency of decision-making analysis and processes.

In this paper, we provide a general framework for the way how the deep learning models have to be applied for time series forecasting problems in both one-step-ahead and multi-steps ahead. Also, we outline some of the different techniques and methods that significantly improve the accuracy of out-of-sample forecasting.

Keywords: *time series, multivariate, deep learning*

Hyrje

Një pjesë e konsiderueshme e veprimtarisë njerëzore ndikohet dhe drejtohet nga parashikimet e të ardhmes. Parashikimi përdoret në një numër të gjerë fushash të cilat mbështesin vendimmarrjet e tyre mbi pritshmërinë apo vlerësimet që ato kanë për të ardhmen, ku mund të përmendim në ndryshimet klimaterike, hidrologji, teknologji, ekonomi, politikë etj. Parashikimet luajnë një rol thelbësor në marrjen e vendimeve. Në të shumtën e rasteve parashikimi shihet si një pjesë integrale për aktivitetet e vendimmarrjes duke sjellë sukses ose dështim në aspektin politik, shoqëror si dhe ekonomik.

Metodat e të mësuarit të thellë (DL) që përdoret për të modeluar funksione komplekse, kanë gjetur përdorim të gjerë dhe në fushën e parashikimit të serive kohore financiare duke rritur rëndësinë e këtyre modeleve inteligjente në këtë fushë. Metodat DL që mbështeten në rrjetet nervorë kanë si veçori që në strukturën e tyre përfshijnë shumë shtresa të fshehta. [1] Karakteristikat që i bëjnë këto metoda të rëndësishme dhe të krahasueshme me ato statistikore për parashikimin e serive kohore lidhen me tiparet që këto metoda zotërojnë. Najafabadi et al. [2] sugjerojnë se algoritmet e të mësuarit të thellë janë një alternativë premtuese e kërkimit për bërë nxjerrjen e automatizuar të paraqitjeve komplekse (veçoritë) nga të dhënat, në një nivel të lartë të abstraktimit.

Ndër veçoritë më me vlerë janë: (1) metodat e DL-s janë në gjendje të nxjerrin apo prodhojnë rregulla nëpërmjet procesit të trajnimit që realizohet nëpërmjet një bashkësie shembujsh të formës: të dhëna hyrëse-të dhënat dalëse, pa përdorur supozime fillestare mbi të dhënat [3, 4]; (2) këto metoda njihen gjerësisht, për aftësitë

¹ Dr. Blerina Vika, DSIZ, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti Tiranës,

blerina.vika@unitir.edu.al;

² Prof. Dr. Dhimitri Tole, DIB, Fakulteti i Informatikës, Universiteti Mesdhetar,

dhimitri.tole@umsh.edu.al;

e tyre për të zbuluar dhe nxjerrë lidhjet lineare dhe jo-lineare në të dhënat që i ofrohen gjatë fazës së trajnimit [5, 6]; (3) në fushën ekonomike, treguesit e ndryshëm shpesh kanë një lidhje jo-lineare midis tyre dhe metodat tradicionale që përdoren gjerësisht për të shpjeguar sjelljet e këtyre tregueseve nuk marrin në konsideratë natyrën jo-lineare të tyre. Rrjetet nervore, të klasifikuara si modele jo-lineare, arrijnë në një shpjegim më të mirë [7]; (4) teknikat DL kanë një qëndrueshmëri më të lartë ndaj të dhënave që shoqërohen me zhurma, mungesa në të dhëna apo me gabime relative në matjen, dhe si rezultat arrijnë në parashikime me nivel më të lartë saktësie si dhe më efektive [7]; (5) një përparësi e algoritmeve DL është aftësia e tyre për të përgjithësuar. Trajnimi i bërë mbi një numër të caktuar shembujsh domethënës i pajis këto modele me njohuri përgjithësuese që shkojnë përtej të dhënave të përdorura për trajnimin e tyre [2], [8]. Këto tipare bëjnë që metodat e të mësuarit të thellë të jenë të përshtatshme për parashikimin e serive kohore.

Modelimi dhe implementimi i një modeli të përshtatshëm DL është në thelb të çdo aplikimi në fushën e inteligjencës artificiale. Pjesa më e madhe e këtyre aplikimeve kanë si qëllim të përdorin teknikat e DL të automatizuara, si dhe të evidentojnë dhe përfshijnë elementet e rëndësishme që ndikojnë në rritjen e efektivitetit dhe të saktësisë për aplikimet softuerike në IA. Në shumë punime të ndryshme të literaturës ndeshen të dhëna kontradiktore të rezultateve, gjë e cila vështirëson nxjerrjen dhe eksplorimin e faktorëve kryesorë për modelimin e programeve në IA si dhe kërkesave që duhet të përmbushin këto programe [4].

Pavarësisht avantazheve që ofrojnë teknikat DL, është e rëndësishme të përmendim se ato mund të jenë të shtrenjta nga pikëpamja llogaritëse (kërkojnë kohë të gjatë për të mësuar) si dhe për të pasur një saktësi sa më të lartë, kërkojnë sasi të mëdha të dhënash për t'u trajnuar.

Në këtë punim, kontributi kryesorë është modelimi i një strukture të bazuar në të mësuarit e thellë (mbështetur në arkitekturat DFNN, LSTM dhe 1D-CNN për zgjidhjen e problemeve të parashikimit jashtë periudhe me një hap³ si dhe shumë hapa përpara, për seritë kohore me një-ndryshore. Ky punim, në vazhdim, është i organizuar si më poshtë: seksioni i dytë përshkruan metodologjinë e përdorur për të specifikuar elementet dhe aspektet e rëndësishme që duhet të këtë aplikimi i DL për të tejkaluar mangësitë që mund të hasen. Seksioni pasues jep një përshkrim të serive kohore si dhe evidenton veçoritë e ndryshme që dallojnë seritë kohore ndërmjet tyre. Në seksionin e katër jepen përshkrimet e arkitekturave të ndryshme të modeleve që për përfshihen në algoritmet e të menduarit të thellë duke vijuar me seksionin e modelimit të sistemit të përgjithshëm për modelin DL të parashikimit të propozuar në këtë punim. Së fundmi, nxirren konkluzionet dhe përfundimet për vijimësinë e punës kërkimore.

Metodologjia

Synimi i këtij punimi është të plotësojë literaturën që ekziston në lidhje me analizimin dhe modelimin e një softueri që ndërton automatikisht një strukturë të përshtatshme

³ Lidhet me frekuencën e serisë kohore nëse ajo është p.sh ditore, javore etj.

DL parashikues, bazuar në të dhënat kohore të luhatshme me një dhe shumë ndryshore, që atij i paraqiten. Realizimi i këtij sistemi kërkon që fillimisht të realizohet eksplorimi dhe përcaktimi i parametrave apo faktorëve të rrjetit nervor që sigurojnë aftësi parashikuese më të mira.

Për përcaktimin e këtyre faktorëve është bërë një studim literature për format e ndryshme në përpunimin e të dhënave dhe strukturave të ndryshme të rrjeteve nervore artificiale si dhe variacionet e rregullave që lidhen me të mësuarin. Nëpërmjet studimit të këtyre faktorëve detajohen dhe ekzaminohen efektet që ato kanë mbi modelimin e sistemit të parashikimit me të dhëna kohore me një dhe shumë ndryshore.

Parashikimi i serive kohore

Një seri kohore është një sekuencë me vlerat e vëzhguara për një ndryshore fizike ose financiare të mbledhura në intervale kohore konstante Δt , dhe paraqiten me anë të një bashkësie me vlera diskrete, $X(t_1), X(t_2), X(t_3), \dots$, etj [9]. Analiza për një seri kohore përfshin kryesisht zhvillimin e modeleve që përdoren për studimin e strukturës së saj të brendshme (trendin, auto korrelacioni, sezonalitetin etj), për të fituar një kuptim më të mirë të procesit dinamik me të cilin janë krijuar të dhënat e serisë kohore. Parashikimi i serive kohore përfshin përdorimin e modelit që përshtatet më mirë për të parashikuar të ardhmen bazuar në vlerat aktuale dhe historike të të dhënave.

Vlerat e parashikuara nga të dhënat e serisë kohore ndihmojnë në marrjen e vendimeve në lidhje me veprimet pasardhëse që duhet të ndërmerren. Në analizën e serisë kohore, që shërben për të evidentuar karakteristikat përbërëse të serisë, duhet të përfshihen aktivitete të tipit: përcaktimi i serisë kohore, klasifikimi i tyre duke evidentuar karakteristika specifike të saj si dhe informacione statistikore që lidhen me të. Në varësi të karakteristikave që të dhënat mbartin, seritë kohore mund të jenë stacionare dhe jo-stacionare, sezonale dhe jo-sezonale, lineare dhe jo-lineare si dhe me një ose me shumë ndryshore [9]. Seritë kohore mund të shfaqin një ose më shumë nga këto tipare.

Seritë kohore, nisur dhe nga emri i tyre, kanë si tipar një renditje natyrale të tyre bazuar në kohën e vëzhguar. Parashikimi i serive kohore lidhet me përdorimin apo ndërtimin e një modeli që parashikon vlerat e ardhshme të ndryshores nisur nga vlerat e shkuara të vëzhguara të tij. Pasi identifikohen tiparet në serinë kohore, bëhet përzgjedhja e modelit parashikues që është në gjendje të nxjerrë strukturat në mënyrën më të përshtatshme [10]. Për një problem parashikues të serive kohore apo ekstrapoluese, si model me një-ndryshore, të dhënat hyrëse përbëhen nga vëzhgime të kaluara të ndryshores, ndërsa e dhëna dalëse është një vlerë e ardhshme e parashikuar [11].

Qëllimi i parashikimit të serisë kohore është modelimi i mekanizmit që mund të parashikojë vlerat e ardhshme të serisë në një afat të shkurtër apo të mesëm.

Strukturat e të mësuarit të thellë për parashikim në seritë kohore

Modelet e të mësuarit të thellë, kohët e fundi shihen si një qasje alternative dhe premtuese në fushën e kryerjes së parashikimeve. Modelet DL bazohen në rrjetet

nervore artificiale(ANN). Kërkimet e kryera në fushën e rrjeteve nervore artificiale kanë evidentuar aftësitë shumë efikase të këtyre modeleve në njohjen e shablloneve dhe klasifikimin e tyre. Si në metodat tradicionale statistikore, dhe metodat ANN procesin e të mësuarit e bëjnë bazuar në të dhënat historike të vëzhguara që mbajnë informacion [12], [13]. Këto modele mund të merren apo punojnë me të dhëna në sasi të mëdha në një kohë të arsyeshme.

Procesi i trajnimit të modelit DL përfshin adaptimin e modelit bazuar në informacionin e brendshëm ose të jashtëm që kalon në model, që ndikon në ndryshimin strukturor të tij. Përparësitë që sjellin aplikimet DL janë në identifikimin e jo-linearitetit në serinë kohore. Trajnimi në këto modele bëhet me anë formës së të mësuarit të mbikëqyrrur, ku modeli DL përshtatet në mënyrë të tillë që të realizojë modelimin e lidhjeve komplekse midis të dhënave hyrëse apo përshkruese dhe atyre që duhet të parashikohen duke gjetur shabllone në të dhënat që jepen në fazën e trajnimit.

Teknikat DL janë të afta të mësojnë në mënyrë të pavarur lidhjet lineare dhe jo-lineare, të nxjerrin veçoritë, të përpunojnë grupe të mëdha të dhënash si dhe janë të afta për të kapur varësitë e përkohshme nga të dhënat të njëpasnjëshme në prani të zhurmave apo dhe të vlerave të munguara. Disa nga arkitekturat më të përdorura në problemet e parashikimit [14], [15], që përfshihen në modelet DL, janë: rrjeti i furnizimit përpara i thellë (DFNN), rrjeti me memorie të gjatë afatshkurtër (LSTM) dhe rrjeti nervor thurës (CNN), më specifik me një-dimension (1D-CNN). Nga literatura, sugjerohet që kryesisht këto janë tre arkitekturat më të përshtatshme për problemet e parashikimit të serive kohore, [14], [16]. Ajo çfarë i bën rrjetet nervore të thella, është përdorimi i më shumë se një shtrese të fshehtë.

1. Rrjeti Nervor 'Feed-Forward' i thellë (DFNN)

Arkitektura DFNN bën pjesë në strukturat shumështrësore me *perceptrone* (MLP). Perceptron-i është një model i thjeshtë analog i një neuroni biologjik që shpesh haset dhe me emërtimin, neuron. Në arkitekturën DFNN, neuronet organizohen në shtresa të renditura njëra pas tjetrës. Vendosen lidhje të plota midis neuroneve që ndodhen në shtresat fqinje dhe informacioni rrjedh në një drejtim pa formuar cikle, nga shtresa hyrëse drejt shtresës dalëse. Lidhjet midis neuroneve shoqërohen me një peshë, që përcakton se sa do të influencojë e dhëna hyrëse në atë dalëse. Në strukturën e rrjetit DFNN, kemi tre lloje të ndryshme shtresash: hyrëse, të fshehur dhe dalëse. Figura 1, paraqet një arkitekturë të përgjithshme për rrjetin nervor DFNN.




Figura 1. Arkitektura e përgjithshme për rrjetin DFNN (Latif Sh. et al, 2021)

Përcaktimi i strukturës së përshtatshme të rrjetit DFNN që do të trajnohet fillimisht dhe më pas do përdoret për parashikim, është shumë i rëndësishëm pasi ndikon drejtpërsëdrejti në efikasitet. Problemet kryesore që rezultojnë janë se modelet e vogla DFNN shpesh shfaqin efikasitet të ulët, njëkohësisht në të dhënat e përdorura në fazën e trajnimit ngecin si dhe në të dhënat e përdorura në testim. Ndërkohë një rritje e konsiderueshme e madhësisë së modelit DFNN rrit probabilitetin për të hasur problemin e përshtatjes së tepërt, në rastin kur modelet arrijnë një saktësi parashikuese shumë të lartë në të dhënat e përdorura në trajnimin e rrjetit por një saktësi parashikuese të ulët për të dhënat që nuk kanë kaluar më parë në rrjet [17].

Algoritmi më i përdorur për trajnimin e DFNN-ve është zbritje sipas gradientit, që përpiket të minimizojë gabimin e modelit duke përditësuar peshat e tij deri në arritjen e konvergencës. Procesi i plotë i të mësuarit nëpërmjet trajnimit përfshin zbatimin në mënyrë të përsëritur njëri pas tjetrit përhapjen e përparme dhe të prapme të gabimit të modelit [18]. Në përhapjen e përparme, përpunimi i të dhënave bëhet duke u nisur nga neuronet në shtresën hyrëse dhe duke u transformuar matematikisht nga njëra shtresë e fshehur në tjetrën drejt shtresës dalëse. Vlerat dalëse të përlogaritura krahasohen me vlerën dalëse të dëshiruar. Ndërsa në përhapjen prapa, pasi llogaritet gabimi në fazën e përhapjes përpara, bëhet rregullimi i peshave për lidhjet midis neuroneve duke filluar nga neuronet në shtresën dalëse në drejtime të neuroneve në shtresën hyrëse.

2. Rrjeti Nervor thurës njëdimensional (CNN)

Një arkitekturë që ka gjetur përdorim të gjerë kohëve të fundit është rrjeti CNN. Fillimisht, CNN-të janë propozuar nga LeCun et al. [19] në modelin LeNet për përpunimin e imazheve. Pavarësisht se modeli CNN është projektuar për të dhënat e tipi imazh, në punime të ndryshme demonstron fuqia përdorimit të këtyre modeleve për të dhëna sekuenciale, duke transformuar shtresën thurëse nga me dydimensione në njëdimension, të quajtura 1D-CNN. Në Figurën 2, paraqitet një arkitekturë e përgjithshme për modelin 1D-CNN.




Figura 2. Arkitektura e përgjithshme e rrjetit 1D-CNN (Krohling B., et al., 2023)

Këto modele janë pjesë e arkitekturave të të mësuarit të thellë pasi në strukturën e këtyre modeleve shtohen disa shtresa të quajtura blloqe thurëse, të cilat sjellin disa avantazhe ku përmendim: së pari, çdo nyjeje i duhet të veprojë mbi një bashkësi më

të vogël të dhënash se gjatësia e të dhënave hyrëse të rrjetit, për të bërë vlerësimin për të gjithë parametrat e vetë modelit, në ndryshim kjo me strukturat DFNN, dhe së dyti, vlerësimi që bëhet për parametrat thurës kap dhe veçoritë e kohës për sekuencën e të dhënave [13].

Komponentët kryesorë që janë pjesë e modelit 1D-CNN janë:

Shtresa thurëse që përdoret për të bërë zbërthimin e tipareve duke zbatuar thurjen midis një filtri rrëshqitës dhe serisë së të dhënave hyrëse. Rezultati i kësaj shtrese është gjenerimi i hartës së veçorive që përmbajnë informacionin e përshtatshëm që nxirret nga të dhënat hyrëse origjinale. Mbi këto harta aplikohet funksioni i aktivizimit i cili ka si qëllim të shtojë jolinearitetin në model. Funksioni i aktivizimit që përdoret zakonisht me këto struktura është *njësi lineare e korigjuar (Rectified Linear Unit – ReLU)* i cili kthen vlerën 0 për të gjitha vlerat negative në hyrje dhe vetë vlerën për vlerat pozitive.

Shtresa e grumbullimit vendoset pas shtresës thurëse, ka si qëllim të zvogëlojë madhësinë e hartës së tipareve, duke eliminuar informacionin e tepërt dhe mban atë që është më i rëndësishëm [20]. Dy funksionet e grumbullimit që përdoren gjerësisht në këto modele janë funksioni i maksimumit dhe i mesatares. Kombinimi i shtresës thurëse me atë të grumbullimit kryen sheshimin e sekuencës së të dhënave.

Rrjeti nervor i lidhur plotësisht (MLP) pason blloqet thurëse që ka struktura 1D-CNN. Kjo komponente merr të dhënat e reja që janë rezultat i transformimeve që i është bërë serisë kohore fillestare, për të identifikuar më lehtë informacionin e përshtatshëm për të prodhuar të dhënën/dhënat dalëse të dëshiruara.

3. Rrjeti nervor kujtesë e gjatë afatshkurtër

Rrjeti nervor, kujtesë e gjatë afatshkurtër (*Long Short-Term Memory: LSTM*) është një nga arkitekturat më të përdorura për problemet e parashikimit të serive kohore me një ndryshore dhe pjesë e bashkësisë së rrjeteve nervorë rekurentë, RNN. Në strukturën e këtyre modeleve lejohet formimi i cikleve, duke mundur që vlera dalëse e prodhuar nga një nyje të mund të përdoret si vlerë hyrëse për përpunimin pasardhës në atë nyje. RNN-të përdoren kryesisht për të dhëna që kanë një lidhje kohore, duke rezultuar në një model rrjeti nervor që përdor të dhënat e kaluara dhe korrelacionin midis të dhënave të vonuara dhe atyre aktuale për të parashikuar të dhënat e ardhshme.

E meta që kanë modelet RNN është se vuajnë nga shuarja e gradientët në rastet kur ekziston një hendek i konsiderueshëm kohor midis informacionit të duhur dhe pikës së përdorimit të tij. Për të evituar këtë mangësi adresuar kësaj çështje, e ashtuquajtura teknikë LSTM prezanton gjendjet e qelizave, duke vepruar si një rrip transportues, në gjendjet e fshehura të një RNN. Nëpërmjet operacioneve rekursive, LSTM ruan si gjendjet e qelizave ashtu edhe gjendjet e fshehura, duke zbutur problemin e zhdukjes së gradientëve.

Modeli LSTM sjell si avantazh adresimin e problemit të shuarjes së gradientit duke bërë të mundur që gradienti të përçohet përgjatë rrjetit në një numër të konsiderueshëm hapash pa u shuar apo shpërthyer [13]. Forma e një qelize, në modelin LSTM, ndihmon modelimin sekuencial duke krijuar përgjatë fazës së trajnimit një gjendje të brendshme (Figura 3).




Figura 3. Struktura e përgjithshme për një qelizë LSTM (Introduction to Long Short-Term Memory, 2023)

Komponentët kryesorë përbërëse të qelizës LSTM janë: Gjendja e qelizës (C_{t-1} , C_t) shërben për të transmetuar në nyjet fqinje, informacion të patjetërsuar në të cilin është e lejuar të aplikohen vetëm disa veprime lineare. C_{t-1} është e dhëna hyrëse e prodhuar nga qeliza paraardhëse që futet në prodhim me vlerën e portës së harresës, vlerat e së cilës janë 0 ose 1. Në rast kur vlera është 1, rezultati i prodhimit mbliidhet me vlerën që jep porta hyrëse për të përditësuar vlerën e re për gjendjen e qelizës, C_t . Gjendja e qelizës njihet si kujtesa afatgjatë.

Gjendja e fshehur (H_{t-1} , H_t), njihet si kujtesa afatshkurtër dhe ka aftësinë e kujtesës së punës pasi ka si qëllim të mbartë të dhënën e mëparshme për ta mbishkruar atë në çdo hap. Porta **hyrëse** nga e cila futet informacioni në qelizë dhe përdoret për të mësuar të dhëna të reja prej saj. Porta **dalëse** transmeton informacionin e përditësuar për përpunimin në hapin pasardhës. Porta e **harresës**, që shpesh e njohin dhe si porta e kujtesës, përcakton nëse informacioni që ka hyrë në qelizë në hapin e mëparshëm duhet ruajtur apo është i parëndësishëm dhe duhet harruar.

Format specifike që kanë neuronet në shtresat LSTM sjellin si avantazh aftësinë për krijuar një kujtesë të gjatë afatshkurtër të informacionit. LSTM-a mundëson kapjen dhe ruajtjen e informacionit të rëndësishëm, edhe në rastet kur ka mungesa të konsiderueshme të informacionit kohor përgjatë serisë kohore. Gjithashtu duhet shtuar se koha e trajnimit për rrjetet LSTM është relativisht e lartë krahasuar me modelin MLP dhe numri i të dhënave duhet të jetë sa më i lartë.

Korniza e përgjithshme e modelit DL parashikues

Në këtë seksion përshkruhet analiza dhe dizejnimin për kornizën që propozojmë të ndiqen për të zhvilluar sistemin e thelluar për parashikimin e serive kohore me një ndryshore për një apo shumë hapa përpara. Aktivitete kryesore që duhen ndjekur përgjatë modelimit mund të përsëriten dhe organizohen në forma të ndryshme përgjatë zhvillimit dhe vlerësimit të aplikimit, në varësi të karakteristikave të serisë kohore. Përdorimi i teknikave të reja, si të mësuarit të thellë, në parashikimin e serive kohore kërkojnë metoda të reja apo të përshtatura për modelimin e tyre. Është e rëndësishme që të kuptojmë se çfarë është ndryshe në këto teknika për të përcaktuar hapat e duhur që duhen ndjekur në

modelimin e një sistemi i mësimit të thelluar për parashikim (SMThP). Projektet mbi bazën e të mësuarit të thellë ndryshojnë nga zhvillimi i projekteve softuerike standarde (Tarassenko, 1998) në këto drejtime:

- Sistemet DL janë të drejtuar nga të dhënat, dhe kjo gjë sjell që fazat e mbledhjes, analizës dhe parapërpunimit të të dhënave duhet të jetë pjesë e procesit të modelimit dhe trajnimit të arkitekturës DL.
- Përcaktimi i zgjidhjes së plotë për sistemin është i pamundur të bëhet që në fazën e modelimit. Kërkohej që të ndërtohen prototipa të cilët vlerësohen dhe vërtetohen mbi elementët e përfshirë.
- Efikasiteti i modelit DL është më i rëndësishëm se shpejtësia e përlogaritjes së rezultateve. Kontrolli i rendimentit shqyrtohet përgjatë të gjitha fazave që nga analiza, modelimi si dhe në testim. Në Figurën 4, paraqiten nëntë aktivitetet kryesore që duhen ndjekur për të zhvilluar një aplikim të bazuar në modelet DL për parashikimin me anë të serive kohore.




Figura 4. Aktivitete për zhvillimin e sistemit parashikues

Duhet theksuar, që pavarësisht se aktivitetet janë të njëjtë për çdo modele DL, detyrat që kryhen çdo fazë ndryshojnë në varësi të tipit të serisë dhe arkitekturës që zhvillohet.

1. Të dhënat dhe parapërpunimi

Përpara se të modelohet dhe të trajnohet modeli DL është e rëndësishme përzgjedhja dhe përgatitja e të dhënave që do të furnizojnë modelin DL me informacion të përshtatshëm dhe përgjithësues. Pavarësisht se ndër avantazhet e listuar për modelet DL është aftësia e tyre për të operuar me të dhëna me cilësi të ulët, të dhënat me cilësi të lartë ndikojnë shumë në realizimin e procesit të mësimit të rrjetit.

Për garantuar cilësinë e të dhënave është e nevojshme analizimi i serisë kohore për të evidentuar tiparet karakteristike të saj. Bazuar në këto karakteristika bëhen transformimet e duhura që sigurojnë rritjen e cilësisë së të dhënave por duhet shmangur përpunimet e tepërta mbi to. Parapërpunimi i të dhënave është një teknikë i gjermimit të të dhënave që përfshinë transformimin e të dhënave fillestare në një format më të kuptueshme.

Duke provuar forma të ndryshme të transformimit të serisë, korniza që propozojmë në Figurën 5, përipiqet të gjejë jo vetëm strukturën më të mirë të modelit DL parashikues, por

gjithashtu përzgjedh dhe teknikën më të mirë të përpunimit ndaj të dhënave. Ndërthurja e fazës së analizës së të dhënave, me atë të modelimit dhe testimit të modeleve DL të ndryshme, parimisht do të rezultojë në rritjen e kohës së përgjigjes së programit, por kjo do të ishte vetëm për trajnimin fillestar të rrjetit.

Disa veçori që janë specifike për përdorimin e të dhënave hyrëse për modelin DL për parashikim, listohen më poshtë:

- Nuk mund të përcaktojmë mënyrën më të mirë të përpunimit pa realizuar implementim të sistemit. Ky vendim ndërmerret nga vetë sistemi gjatë përpunimit dhe modelimit. Në këtë fazë duhet që në sistem të vendosen mënyrat alternative të përpunimit.
- E gjithë bashkësia e të dhënave që do të përdoren për të ndërtuar modelin më të mirë DL duhet të kenë të njëjtin përpunim. Këto të dhëna përdoren në hapa të ndryshëm të procesit modelues, prandaj është e nevojshme që të ruhen të gjitha specifikimet për çdo përpunim të kryer mbi të dhënat.
- Edhe pasi është përzgjedhur modeli D më i mirë që do të përdoret për parashikim, gjatë fazës së ritrajnimit të rrjetit me të dhëna të reja duhet që këto të dhëna të përpunohen në të njëjtën mënyrë si të dhënat ekzistuese.

2. Specifikimet për modelin DL

Elementët që duhen specifikuar për modelimin e strukturës DL më të mirë për parashikim lidhen me detajimin për këto pika bazë (Figura 5):

- Përcaktimin e elementëve përbërëse të modelit DL si: numri i shtresave, numri i njejeve në çdo shtresë, numri i vonesave kohore, i horizontit si dhe funksioni i aktivizimit në çdo shtresë.
- Si duhet të realizojë përlllogaritje çdo strukturë DL, pra përcaktimi i algoritmit të trajnimit që mundëson proces të mësuarit më të mirë.
- Çfarë kriteresh do të përdoren për të bërë përzgjedhjen dhe vlerësimin e efikasitetit të modelit DL për parashikim.

Për të adresuar çështjen e përzgjedhjes së modelit e të mësuarit të thellë të përshtatshëm, në kornizën e përgjithshme të prezantuar në këtë punim, është përdorur një trajtim me teknikën *brutë-forcë*. Duke qenë se nuk ekzistojnë metodologji që të mund të drejtojnë në ndërtimin e strukturës më të mirë DL-in për parashikim, është e nevojshme që të merren në shqyrtim një numër i konsiderueshëm modelesh DL, të cilat ndryshojnë nga njëri-tjetri nga numri i neuroneve për çdo shtresë, numri i shtresave dhe algoritmet e trajnimit. Kjo mënyrë e trajtimit gjen përdorim të gjerë në punime të ndryshme që përdorin strukturat e të mësuarit të thellë për parashikim. Pasi gjenerohen këto struktura të ndryshme të rrjeteve neurale, ato trajnohen dhe krahasohen për të zgjedhur më pas strukturën që ka aftësi përgjithësuese më të mira.

3. Trajnimi i modelit

Trajnimi i modelit DL, si proces, realizohet nëpërmjet një algoritmi i cili duhet të përfshijë ndryshimin e të dhënave hyrëse të algoritmit, ekzekutimin e përlllogaritjeve transformuese të këtyre të dhënave si dhe kontrollin e rezultateve që sjell ky ndryshim. Algoritmi i gradientit zbritës është më i përdoruri dhe më i preferuari për trajnimin e strukturave

DFNN. Për të bërë një trajnim sa më të mirë sugjerohet që vlerat e peshave fillestare për lidhjet midis neuroneve të vendosen në mënyrë të rastit dhe më pas procedohet me trajnimin e modelit. Ky proces përsëritet disa herë me vlera fillestare të peshave të ndryshme dhe përzgjidhet konfigurimi i modelit DL që rezulton me efikasitet më të lartë në arritjen e rezulttit të dëshiruar nga modeli.




Figura 5. Korniza e përgjithshme në Modelin DL për Parashikim

Hapi pasues është implementimi dhe integrimi i modelit më të mirë DL për parashikim në softuerë aplikativë për përdorim. Është e kuptueshme që pasi bëhet dizenjimi i softuerit duhet të konsiderohen disa faktorë shtesë, ku përfshihen zgjedhja e librarive e të mësuarit të makinës, mjediset e ekzekutimit si kërkesat për procesorin, kujtesën apo mënyrën e ruajtjes.

Konkluzionet

Nëpërmjet këtij studim përqipemi të japim një pamje të plotë për dizenjimin dhe implementimin e softuerëve që përdorin modelin e të mësuarit të thellë për parashikim duke përfituar nga avantazhet që ofrojnë këto teknika të inteligjencës artificiale. Rezultatet e këtij punimi shkencor mbështeten në: (i) një analizë mbi rishikimin e literaturës së gjerë bashkëkohore, dhe (ii) në rezultatet eksperimentale të kryera mbi seri kohore reale. Korniza e përgjithshme e sistemit është sugjeruar në mënyrë të tillë që elemente të ndryshme të sistemit të mund të trajtohen në veçanti si dhe mund të përdoren si module të pavarura.

Trajtimi i këtij punimi kryen analizën dhe dizenjimin e sistemit DL për parashikim të distancuar nga veçoritë teknike të implementimit, duke mos u përqendruar në ndonjë platformë specifike, duke krijuar mundësinë që zhvillues të ndryshëm të mund të ripërdorin dhe përshtatin arritjet e këtij punimi lehtësisht. Nga rezultatet e nxjerra nga ky studim evidentohet që elementët përbërës në modelimin e strukturës së modelit DL për parashikim, kanë ndikimi të ngushtë ndërmjet njëri-tjetrit. Ndryshimi i bërë në njërin prej tyre influencën në elementët e tjerë. Këto tipare, merren në konsideratë përgjatë automatizimit të gjenerimit të modelit të DL për parashikim që përshkruhet në kornizën e përgjithshme të propozuar, që i përgjigjet një serie kohore specifike.

Literatura

- [1] Xhabafti M., Vika B. and Sinaj V., «A Comparative Study of Statistical and Deep Learning Model-Base weather Prediction in Albania,» *WSEAS Transactions on Computer Research*, vëll. i 12, nr. 15, pp. 151-160, 2024.
- [2] Najafabadi M., et al, «Deep Learning applications and challenges in big data analytics,» *Journal of Big Data*, pp. 1-21, 2015.
- [3] Chang I. Ch., Hwang H. G., «Applying Neural Networks in Time Series Forecasting,» *Information and Management Science*, vëll. i 9, nr. 3, pp. 35-43, 1998.
- [4] Scowen M., et al., «The current and future uses of machine learning in ecosystem service research,» *Science of The Total Environment*, 2021.
- [5] S. Gonzaley, «Neural Networks for Macroeconomic Forecasting: A Complementary Approach to Linear Regression Models,» Canada, 2007.
- [6] Mahmoudi M. A., et al., «Learnable pooling weights for facial expression recognition,» *Pattern Recognition Letters*, vëll. i 138, pp. 644-650, 2020.
- [7] Basheer I.A. dhe Hajmeer M., «Artificial Neural Networks: fundamentals, computing, design, and application,» *Journal of Microbiological Methods*, vëll. i 43, pp. 3-31, 2000.

- [8] J. T. Yao, «Towards a Better Forecasting Model for Economic Indices,» në *International Conference on Computer Science and Informatics*, Durham, USA, 2002.
- [9] Palit A. K. et al. , në *Computational Intelligence in Time Series Forecasting*, 2005.
- [10] R. J. Hyndman, & G. Athanasopoulos, R. J. Hyndman, & G. Athanasopoulos (2021) *Forecasting: principles and practice*, 3rd edition, Melbourne, Australia: OTexts, 2022.
- [11] Vika B., Martiri E. & Xhaja D., «Improving Massive Time Series Forecasting Through Parallel Neural Networks,» *Ekonomia dhe Biznesi*, p. Vol.1.2.3 Albania, 2011.
- [12] Vika B., & Vika I., «Forecasting Albanian Time Series with Linear and Nonlinear Univariate Models,» *Academic Journal of Interdisciplinary Studies*, vëll. i 10, nr. 5, p. 293, 2021.
- [13] Vika B., & Çollaku D, «Forecasting LEK/EUR Exchange Rate: A Comparative Deep Learning Study,» në *RTA-CSIT*, Tirana, Albania, 2023 .
- [14] Bandara, K. et al., «Forecasting across time series databases using recurrent neural networks on groups of similar series: A clustering approach,» *Expert Systems with Applications*, vëll. i 140, nr. 112896, 2020.
- [15] Lara-Benitez P. et al., «An experimental review on deep learning architectures for time series forecasting,» *International Journal of Neural Systems*, vëll. i 31, nr. 21300001, 2021.
- [16] Claveria O., et al. , «An application of deep learning for exchange rate forecasting,» *Regional Quantitative Analysis* , 2022.
- [17] Pan et al., «BatTS: a hybrid method for optimizing deep feedforward neural network.,» *Peerj Computer Science* 9, p. e1194, 2023.
- [18] Orimolozé, L. et al, «Comparing the effectiveness of deep feedforward neural networks and shallow architecture for predicting stock price indices,» *Expert System appl.*, p. 139, 2020.
- [19] LeCun, et al., «Gradient-based learning applied to document recognition,» *Proceedings of the IEEE*, vëll. i 11, nr. 86, p. 2278–2324, 1998.
- [20] Goodfellow I., et al., «Deep Learning,» MIT Press Cambridge, 2016.
- [21] Latif Sh. et al., «Deep Learning for the Industrial Internet of Things (IIoT): A Comprehensive Survey of Techniques, Implementation Frameworks, Potential Applications, and Future Directions,» *Sensor*, vëll. i 21(22), nr. 7518, 2021.
- [22] Kiranyaz S., «1D convolutional neural networks and applications: A survey,» *Mechanical Systems and Signal Processing*, vëll. i 151, nr. 107398, 2020.
- [23] Krohling B., et al., «1D Convolutional neural networks and Machine Learning Algorithms for Spectral Data Classification with a case study for Covid-19,» *Neural and Evolutionary Computing*, 2023.
- [24] «Introduction to Long Short Term Memory,» 12 12 2023. [Në linjë]. Available: <https://www.geeksforgeeks.org/deep-learning-introduction-to-long-short-term-memory/>.
- [25] L. Tarassenko, *Guide to Neural Computing Applications*, New York: John Wiley & Sons Inc, 1998.

- [1] Xhabafti M., Vika B. and Sinaj V., «A Comparative Study of Statistical and Deep Learning Model-Base weather Prediction in Albania,» *WSEAS Transactions on Computer Research*, vëll. i 12, nr. 15, pp. 151-160, 2024.
- [2] Najafabadi M., et al, «Deep Learning applications and challenges in big data analytics,» *Journal of Big Data*, pp. 1-21, 2015.
- [3] ChangI. Ch., Hwang H. G., «Applying Neural Networks in Time Series Forecasting,» *Information and Management Science*, vëll. i 9, nr. 3, pp. 35-43, 1998.
- [4] Scowen M., et al., «The current and future uses of machine learning in ecosystem service research,» *Science of The Total Environment*, 2021.
- [5] S. Gonzaley, «Neural Networks for Macroeconomic Forecasting: A Complementary Approach to Linear Regression Models,» Canada, 2007.
- [6] Mahmoudi M. A., et al., «Learnable pooling weights for facial expression recognition,» *Pattern Recognition Letters*, vëll. i 138, pp. 644-650, 2020.
- [7] Basheer I.A. dhe Hajmeer M., «Artificial Neural Networks: fundamentals, computing, design, and application,» *Journal of Microbiological Methods*, vëll. i 43, pp. 3-31, 2000.
- [8] J. T. Yao, «Towards a Better Forecasting Model for Economic Indices,» në *International Conference on Computer Science and Informatics*, Durham, USA, 2002.
- [9] Palit A. K. et al. , në *Computational Intelligence in Time Series Forecasting*, 2005.
- [10] R. J. Hyndman, & G. Athanasopoulos, R. J. Hyndman, & G. Athanasopoulos (2021) *Forecasting: principles and practice*, 3rd edition, Melbourne, Australia: OTexts, 2022.
- [11] Vika B., Martiri E. & Xhaja D., «Improving Massive Time Series Forecasting Through Parallel Neural Networks,» *Ekonomia dhe Biznesi*, p. Vol.1.2.3 Albania, 2011.
- [12] Vika B., & Vika I., «Forecasting Albanian Time Series with Linear and Nonlinear Univariate Models,» *Academic Journal of Interdisciplinary Studies*, vëll. i 10, nr. 5, p. 293, 2021.
- [13] Vika B., & Çollaku D, «Forecasting LEK/EUR Exchange Rate: A Comparative Deep Learning Study,» në *RTA-CSIT*, Tirana, Albania, 2023 .
- [14] Bandara, K. et al., «Forecasting across time series databases using recurrent neural networks on groups of similar series: A clustering approach,» *Expert Systems with Applications*, vëll. i 140, nr. 112896, 2020.
- [15] Lara-Benitez P. et al., «An experimental review on deep learning architectures for time series forecasting,» *International Journal of Neural Systems*, vëll. i 31, nr. 21300001, 2021.
- [16] Claveria O., et al. , «An application of deep learning for exchange rate forecasting,» *Regional Quantitative Analysis* , 2022.
- [17] Pan et al., «BatTS: a hybrid method for optimizing deep feedforward neural network.,» *Peerj Computer Science* 9, p. e1194, 2023.
- [18] Orimolozé, L. et al, «Comparing the effectiveness of deep feedforward neural networks and shallow architecture for predicting stock price indices,» *Expert System appl.*, p. 139, 2020.

- [19] LeCun, et al., «Gradient-based learning applied to document recognition,» *Proceedings of the IEEE*, vëll. i 11, nr. 86, p. 2278–2324, 1998.
- [20] Goodfellow I., et al., «Deep Learning,» MIT Press Cambridge, 2016.
- [21] Latif Sh. et al., «Deep Learning for the Industrial Internet of Things (IIoT): A Comprehensive Survey of Techniques, Implementation Frameworks, Potential Applications, and Future Directions,» *Sensor*, vëll. i 21(22), nr. 7518, 2021.
- [22] Kiranyaz S., «1D convolutional neural networks and applications: A survey,» *Mechanical Systems and Signal Processing*, vëll. i 151, nr. 107398, 2020.
- [23] Krohling B., et al., «1D Convolutional neural networks and Machine Learning Algorithms for Spectral Data Classification wiith a case study for Covid-19,» *Neural and Evolutionary Computing*, 2023.
- [24] «Introduction to Long Short Term Memory,» 12 12 2023. [Në linjë]. Available: <https://www.geeksforgeeks.org/deep-learning-introduction-to-long-short-term-memory/>.
- [25] L. Tarassenko, *Guide to Neural Computing Applications*, New York: John Wiley & Sons Inc, 1998.

STRATEGJIA "ÇMIMI SIPAS TREGJEVE". NJË QASJE TEORIKE.

Dr proces. Iva SULAJ¹, Prof. Asoc. Dr. Brunela TREBICKA²

Abstract

During the last decades, "pricing to market" has become an important issue in the new theory of trade. The idea arises from the incomplete pass-through effect of the exchange rate and the distortion of the law of one price.

Krugman (1986), labeled the destination specific adjustment of the profit margin in response to exchange rate fluctuations, as "pricing to market". Fluctuations of the exchange rate, would create an additional profit margin between the price set by the exporter and the price paid by the importer, and could be used as an instrument of price discrimination. The literature provides ample evidence for the existence of "pricing to market", in both advanced and developing economies, a strategy carried out by the exporter, making a profit margin adjustment that is specific to each destination market, stabilizing the final price of export, in order to effectively face local competition and maintain the market share. Thus, the exchange rate is the main determinant in the price adjustment process, while differences in income between countries, are seen as not having the same level of importance.

Contrary to assumptions in the literature, during the last decade, there have been many empirical studies on small open economies, the results of which suggest that these economies are also able to apply "pricing to market", thus setting different prices to different markets, rejecting the hypothesis that they are price takers.

Keywords: exchange rate pass-through, destination market, local competition, market share, pricing to market, profit margin.

Hyrje

Që nga kolapsi i sistemit Bretton Woods, kursi i këmbimit është bërë qendra e debateve të politikave makroekonomike për ekonomitë e hapura. Krugman (1986), ishte një nga të parët që përshkroi fenomenin e firmave të huaja që rregullojnë çmimet e tyre të eksportit në tregje specifike dhe zyrtarizoi idenë e vendosjes të çmimit sipas tregjeve në lidhje me lëvizjet e kursit të këmbimit. "Çmimi sipas tregjeve", sugjeron që në një strukturë tregu me konkurrencë jo perfekte, firmat vendosin qëllimisht çmime të ndryshme në vende të ndryshme, sipas kushteve konkurruese lokale dhe strukturës së tregut. "Çmimi sipas tregjeve" varet nga elasticiteti i kërkesës me të cilën përballen firmat e huaja, pjesa e tregut në vendet e importit, zëvendësueshmëria e mallrave të importuara, kostot e transportit, marketingu dhe shpërndarja. Efektet dinamike të "çmimit sipas tregjeve" lidhen kryesisht me qëndrueshmërinë e çmimeve në një kuadër tregu jo perfekt konkurrues. Për të ruajtur reputacionin e tyre në treg, çdo rritje e vogël e papritur e kostos marxhinale të importit të një firme nuk do t'u kalohet konsumatorëve, për sa kohë që ndryshimet perceptohen të jenë të përkohshme. Studimet e përçimit të kursit të këmbimit, në vitet 1970 dhe 1980 theksuan kryesisht

¹ Asistent Lektore, Departamenti i Financës, Fakulteti Ekonomik, Kolegji Universitar Logos, Tiranë.

² Lektore, Departamenti Statistikë dhe Informatikë e Zbatuar, Fakulteti i Biznesit, Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës.

organizimin e ndryshëm industrial, rolin e segmentimit të tregut dhe diskriminimit të çmimeve në tregjet gjeografikisht të dallueshme (Campa dhe Goldberg, 2002). Literatura tradicionale mbi përcimin e kursit të këmbimit fokusohet në efektin mbi çmimet e importit dhe argumenton se, përcimi është në thelb një fenomen mikroekonomik, duke theksuar për këtë arsye rolin e fuqisë së tregut dhe diskriminimit të çmimeve në tregun ndërkombëtar. (Choudhri dhe Hakura (2006); Richardson (1978); Woo (1984); Knetter (1989); Marston (1990); Kasa (1992); Gagnon dhe Knetter (1995). Gjetjet nga këto studime sugjerojnë se ka dallime të rëndësishme dhe jo të përkohshme në elasticitetet e përcimit, për shkak të zëvendësimit jo të plotë ndërmjet mallrave ose për shkak të pranisë së tregjeve të segmentuara.

Sipas Krugman (1986), "çmimi sipas tregjeve" është një fenomen që ndodh për shkak të diferencimit të produktit ose konkurrencës jo perfekte, ku firmat eksportuese përpiqen të mbajnë të njëjtin nivel çmimi pavarësisht zhvlerësimit të monedhës së importuesit. Thënë ndryshe, "çmimi sipas tregjeve", nënkupton që prodhuesit tentojnë të përthithin luhatjet e kursit të këmbimit përmes marzhit të fitimit të aplikuar, kjo duke u reflektuar në një çmim përfundimtar relativisht të qëndrueshëm të eksportit, në mënyrë që të ruajnë pjesën e tregut në përputhje me konkurrencën në tregjet e destinacionit.

Firmat që prodhojnë produkte të ngjashme, përballen gjithashtu me konkurrencën kur hyjnë në tregjet e huaja. Por, në të njëjtën kohë ato duhet të diferencojnë produktet e tyre për nga çmimi dhe cilësia në krahasim me prodhuesit vendas.

Kështu, strategjia "çmimi sipas tregjeve" nuk është një proces i lehtë. Ajo varet nga faktorët e brendshëm që evoluojnë në tregjet përkatëse të destinacionit. Një faktor tjetër i rëndësishëm në strategjinë e "çmimit sipas tregjeve" të firmave prodhuese është shkalla e elasticitetit të kërkesës në vendet importuese dhe gatishmëria e tyre për të shkëmbyer kostot afatshkurtra me objektivat afatgjatë të pjesës së tregut.

Studime të ndryshme kanë treguar se shkalla e konkurrencës përcaktohet kryesisht nga peshja e eksportuesit në tregun e destinacionit dhe niveli i diferencimit të produktit. Studime të shumta empirike kanë eksploruar fenomenin "çmimi sipas tregjeve" dhe janë përpjekur të kontribuojnë në kuptimin e strategjive të çmimeve të eksportit në tregjet e huaja. Një literaturë e gjerë nga vitet tetëdhjetë i është kushtuar analizës së efekteve të ndryshimeve të kursit të këmbimit në çmimet e eksportit. Një përfundim i përgjithshëm i këtyre studimeve është prania e një përcimi jo të plotë të kursit të këmbimit të çmimet, ndoshta i lidhur me madhësinë ekonomike të vendit, ashtu si dallimet përkatëse të industrisë. Një zgjerim i kësaj literaturë është fokusuar në diferencat e përcimit të kursit të këmbimit tek çmimet sipas tregut të destinacionit, duke nënkuptuar një rregullim specifik të marzhit të fitimit sipas destinacionit dhe në këtë mënyrë, një shkallë të diskriminimit të çmimeve sipas tregjeve.

Ligji i një çmimi (LOOP) në ekonominë ndërkombëtare, supozon se çmimet duhet të jenë të barabarta në çdo vend, pasi të jenë shprehur në një monedhë të vetme. Megjithatë, një literaturë e gjerë empirike ka dokumentuar se Ligji i një çmimi, mund të qëndrojë vetëm në afat të gjatë dhe arritja në ekuilibër mund të zgjasë edhe dekada. Një shpjegim i mundshëm për dështimin e Ligjit të një çmimi është strategjia e "çmimit

sipas tregjeve", e cila bazohet në rolin e konkurrencës jo perfekte në tregti. Për më tepër, ndryshimet e vërejtura të çmimeve në tregje janë ndoshta edhe për shkak të natyrës karakterizuese të firmave. Goldberg dhe Knetter (1997) theksojnë se "në mënyrë ideale, ligji i një çmimi nënkupton transaksione, në të cilat kombësia e blerësve është i vetmi ndryshim në karakteristikat e transaksionit".

"Çmimi sipas tregjeve" mund të aplikohet nga eksportuesi për të ruajtur pjesën e tregut dhe shitjet, në tregun e destinacionit në varësi të rëndësisë së atij tregu. Sfondi teorik i "çmimit sipas tregjeve" është zhvilluar nga Krugman (1986) dhe më vonë modeli është aplikuar nga Knetter (1989 dhe 1993), Marston (1990), Lee (1995), Gil-Pareja (2000), Falk dhe Falk (2000), Glauben (2003), Campa dhe Goldberg (2005), Gagnon dhe Ihrig (2004), Bussiere dhe të tjerë (2008), Alessandria and Kaboski, (2011); Berman dhe të tjerë (2012); Pall dhe të tjerë (2013) dhe autorë të tjerë.

Rezultate dhe diskutime

Gjatë dekadave të fundit, "çmimi sipas tregjeve", është bërë një çështje e rëndësishme në teorinë e re të tregtisë. Ideja lind nga përcimi jo i plotë i efektit të kursit të këmbimit dhe shtrembërimi i ligjit të një çmimi. Kur zhvlerësohet monedha e eksportuesit, ai rregullon marzhin e fitimit dhe çmimi në terma të monedhës së importuesit bie "shumë pak". Në veçanti, që nga specifikimi i Krugman (1986), dihet se firmat eksportuese mund të vendosin fare mirë të rregullojnë marzhin e tyre të fitimit, në mënyrë që të kufizojnë me qëllim transmetimin e ndryshimeve të kursit të këmbimit në çmimet e konsumit. Ky mekanizëm, i njohur si "çmimi sipas tregjeve", ka marrë shumë vëmendje si një shpjegim i mundshëm për përcim jo të plotë të kursit të këmbimit, duke treguar se strategjitë e çmimeve janë heterogjene ndërmjet eksportuesve dhe varen nga niveli i tyre i produktivitetit, pjesa e tregut, intensiteti i importit, cilësia e prodhimit dhe karakteristika të tjera të ngjashme.

Çmimet e importit zakonisht ndryshojnë me një përqindje më të vogël se ndryshimi i kursit të këmbimit midis vendit eksportues dhe atij importues. Hulumtimet e fundit tregojnë se çmimet relative për mallra të ngjashme të eksportuara në tregje të ndryshme, janë shumë të lidhura me kurset e këmbimit midis këtyre tregjeve.

Përkufizimi teorik i përcimit të kursit të këmbimit është, ndryshimi në përqindje në çmimet e importit në monedhën vendase që rezulton nga një ndryshim prej një përqind në kursin e këmbimit midis vendeve eksportuese dhe importuese.

Interesi për çështjen e përcimit të kursit të këmbimit u rrit pas kalimit nga kursi fiks në atë të luhatshëm, pasi ai mbeti një komponent i çështjes së "rregullimit të jashtëm" dhe transmetimit të inflacionit. Periudha e normës së ndryshueshme, e cila filloi rreth vitit 1973, siguroi përfitimin e shtuar të luhatshmërisë më të madhe të kursit të këmbimit me të cilin mund të identifikoheshin koeficientë të interesit, por solli dhe ndërlikim të shtuar të çështjeve delikate të rregullimit dinamik, që lidheshin me pritshmëritë e sjelljes së kurseve të këmbimit të luhatshëm.

"Çmimi sipas tregjeve", nënkupton që eksportuesit i përshtatin çmimet e tyre me çmimet mbizotëruese në tregjet e eksportit. Për vendin importues, efektet e çmimit sipas tregjeve, mund të interpretohen si matës i qëndrueshmërisë së çmimeve vendase

kundrejt ecurisë të çmimeve të huaja dhe të kursit të këmbimit. Sjellja e çmimit sipas tregjeve, mund t'i atribuohet nivelit të konkurrencës dhe elasticitetit të çmimeve në vendin importues.

Çdo treg plotësisht konkurrues karakterizohet nga kushti që çmimi të jetë i barabartë me koston marxhinale. Një treg i segmentuar, nënkupton ekzistencën e fuqisë së tregut. Meqenëse blerësit përballen me çmime të ndryshme, jo të gjithë blerësit përballen me një çmim të barabartë me koston marxhinale. Ndërsa, një treg i integruar mund ose nuk mund të jetë plotësisht konkurrues. Një furnizues monopolist i një malli mund të vendosë një çmim mbi koston marxhinale, por të jetë i paafte për diskriminim të çmimit nëse blerësit janë të organizuar mirë ose produkti transportohet lehtësisht nëpër tregje. Çmimet e huaja dhe luhatjet e kursit të këmbimit transmetohen në çmimet e brendshme nëpërmjet deflatorit të importit. Deflatori i importit, si lidhja midis çmimeve vendase dhe të huaja, përcaktohet nga faktorë vendas dhe të huaj, si dhe nga kursi i këmbimit. Nëse do të kishte vetëm përcaktues të huaj të çmimeve të importit, do të kishte një përçim të plotë të lëvizjeve të çmimeve të huaja dhe të kursit të këmbimit. Kufizimi i përçimit lind sepse eksportuesit e huaj duhet të konkurrojnë kundër produkteve vendase.

Duke vepruar kështu, ata duhet të përafrojnë çmimet e tyre deri në një farë mase me çmimet mbizotëruese të tregut vendas në tregjet e tyre të eksportit. Një përcaktues vendas i deflatorit të importit është pra, niveli i çmimeve të brendshme. Për më tepër, shkalla në të cilën konkurrentët e huaj duhet të përafrojnë çmimet e tyre me çmimet e brendshme mbizotëruese, përcaktohet gjithashtu nga faktorët vendas, në veçanti shkalla e konkurrencës dhe qëndrueshmëria e çmimeve në tregjet e brendshme. Kjo sjellje e përcaktimit të çmimeve të eksportuesve të huaj në përgjithësi, referohet si efekt i strategjisë "çmimi sipas tregjeve". Efektet e çmimit sipas tregjeve, lindin për shkak se deflatori i importit ndikon në çmimet e brendshme, të cilat nga ana e tyre ndikojnë në çmimet e importit.

Efektet e "çmimit sipas tregjeve" korrespondojnë me masën në të cilën eksportuesit rregullojnë çmimet e tyre, për të pasqyruar çmimet mbizotëruese, të vendosura nga konkurrentët e tyre. Pra, efektet "çmimi sipas tregjeve" lindin nga përçimi i kufizuar i çmimeve të huaja dhe i kursit të këmbimit. Nga këndvështrimi i politikës monetare, me objektivin e stabilizimit të çmimeve, është e rëndësishme të përcaktohet se në çfarë mase çmimet e brendshme ndikohen nga zhvillimet e çmimeve të huaja dhe luhatjet e kursit të këmbimit. Shkalla e hapjes së ekonomisë është shpesh treguesi i vetëm që përdoret për të adresuar këtë çështje. Megjithatë, një përçim relativisht i kufizuar i çmimeve të huaja, do të kompensonte një shkallë relativisht të lartë hapjeje. Prandaj, analiza e efekteve të "çmimit sipas tregjeve" është një element i rëndësishëm në vlerësimin e qëndrueshmërisë së çmimeve të brendshme ndaj ndikimeve të huaja.

Efektet "çmimi sipas tregjeve" përshkruajnë përçimin e kufizuar të çmimeve të huaja dhe të kursit të këmbimit për shkak të përshtatjes me çmimet e konkurrentëve. Nga një këndvështrim mikroekonomik, këto efekte i atribuohen kryesisht diferencimit të produktit dhe konkurrencës jo perfekte (Krugman (1986)). Pas rritjes së kostos së brendshme ose lëvizjeve të kursit të këmbimit, firmat eksportuese kërkojnë të ruajnë

pjesët e tyre të tregut në tregjet e huaja dhe të sigurojnë shitje në të ardhmen. Kjo është kryesisht një tipar i periudhës afatshkurtër, veçanërisht në situata të karakterizuara nga luhatshmëri të konsiderueshme të kursit nominal të këmbimit.

Megjithatë, efektet e "çmimit sipas tregjeve" mund të shfaqen në afat të gjatë, kur furnitorët në konkurrencë jo perfekte, vendosin çmime specifike sipas tregut dhe vendit. Marzhi i fitimit në këtë rast mund të pritët të jetë i varur nga elasticiteti i kërkesës në tregjet përkatëse. Një element i rëndësishëm i argumenteve të mësipërme është se, ndryshimet në strukturën e kostos së eksportuesve dhe lëvizjet e kursit të këmbimit kanë të njëjtin efekt në fitimet e eksportuesve në një çmim të caktuar eksporti. Prandaj, luhatjet në kursin e këmbimit në terma afatgjatë, transmetohen në të njëjtën mënyrë si ndryshimet në kostot e prodhimit. Megjithatë, kjo është një veçori vetëm në një perspektivë afatgjatë. Në krahasim me afatin e gjatë, në lidhje me luhatjet në kostot e brendshme, eksportuesit në afat të shkurtër do të reagojnë ndryshe ndaj luhatjeve në kurset e këmbimit, kështu që përçimi mund të jetë krejt i ndryshëm, jo vetëm sepse kursi i këmbimit është shumë më i luhatshëm se kostot e prodhimit.

Pavarësisht nga aspektet e veçanta të cilat trajtohen nga autorë të ndryshëm, ka prova të qarta për ekzistencën e efekteve të strategjisë "çmimi sipas tregjeve". Me një fuqi të caktuar tregu të vendit importues, një strategji e çmimeve të eksportuesve do të marrë në konsideratë njësoj ndryshimet në kostot e prodhimit dhe lëvizjet e kursit të këmbimit për të ruajtur një marzh fitimi konstant. Me fjalë të tjera, përçimi i kursit të këmbimit ka të njëjtin efekt me përçimin e kostos së huaj. Megjithatë, ky kufizim është i besueshëm vetëm në planin afatgjatë. Veçanërisht paqëndrueshmëritë e kostove të prodhimit dhe të kurseve të këmbimit mund të gjenerojnë dinamika të ndryshme në afat të shkurtër.

Krugman (1986) e etiketoi rregullimin specifik të marzhit të fitimit sipas destinacionit në përgjigje të ndryshimeve të kursit të këmbimit si "çmimi sipas tregjeve". Me fjalë të tjera, "çmimi sipas tregjeve", ndodh kur shitësit ulin çmimet për blerësit, monedhat e të cilëve janë zhvlerësuar kundrejt shitësit, duke stabilizuar kështu çmimet në monedhën e blerësit. Nocioni i strategjive të çmimeve, është megjithatë i arsyeshëm vetëm nëse firmat operojnë në një mjedis jo perfekt konkurrues, ose segmentimi i tregut të eksportit është një kusht i domosdoshëm për ekzistencën e diskriminimit të çmimeve në përgjithësi dhe "çmimit sipas tregjeve" në veçanti. Arsyet e mundshme pse çmimet nuk barazohen ndërmjet blerësve në tregje të ndryshme mund të jenë: faktorët gjeografikë, heterogjeniteti i produktit, informacioni jo i plotë, kostot e transportit dhe barrierat tregtare.

Çmimi i një produkti që tregtohet në tregjet ndërkombëtare do të ishte i njëjtë në tregje të ndryshme, kur ai shprehet në të njëjtën monedhë, sipas "ligjit të një çmimi" nën supozimin e konkurrencës perfekte. Në një mjedis konkurrence perfekte, ndryshimet në kursin e këmbimit, do të kalojnë tërësisht në çmimet e monedhës vendase për të parandaluar arbitrazhin dhe siguruar aplikimin e ligjit të një çmimi, i cili mund të përcaktohet dhe si përçim i plotë i kursit të këmbimit. Megjithatë, kjo nuk ndodh në botën reale.

Në mungesë të supozimit të konkurrencës perfekte, përçimi i kursit të këmbimit nuk do të ishte i plotë duke mos aplikuar ligjin e një çmimi. Luhatjet në kurset e këmbimit mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në sjelljen e çmimeve të eksportuesit në një mjedis konkurrence jo perfekte. Për shembull, nëse vlerësohet monedha e importuesit, furnizuesi duhet të ulë çmimin e tij në monedhën e importuesit sipas ligjit të një çmimi. Megjithatë, nëse eksportuesi ul çmimin e shprehur në monedhën vendase më pak proporcionalisht se ndryshimi në kursin e këmbimit, ligji i një çmimi shtrembërohet dhe furnizuesi do të ketë një marzh fitimi më të lartë në krahasim me rastin përpara vlerësimit të monedhës së destinacionit.

Ndryshimi i kursit të këmbimit do të krijonte një marzh fitimi shtesë midis çmimit të vendosur nga eksportuesi dhe çmimit të paguar nga importuesi, dhe mund të përdoret si një instrument i diskriminimit të çmimeve në tregje të ndryshme ndërkombëtare.

Objektivi është të vrojtohet, nëse ndryshimi i kursit të këmbimit do të rezultojë pikërisht, në diferencimin e marzhit të fitimit, pra ndryshimin e çmimit në termat e monedhës vendase nëpër tregjet e destinacionit.

Eksportuesi mund të stabilizojë plotësisht çmimin në termat e monedhës së importuesit, duke ndryshuar marzhin e fitimit kundrejt luhatjeve të kursit të këmbimit në një rast të dukurisë “çmimi sipas tregjeve”. Eksportuesi përpiqet të stabilizojë çmimin në tregun e destinacionit, pavarësisht luhatjeve të kursit të këmbimit, duke rritur ose ulur marzhin e fitimit. Ekzistenca e “çmimit sipas tregjeve”, varet nga struktura e elasticitetit të çmimit të kërkesës. Kur elasticiteti i kërkesës rritet me çmimin, mund të vihet re dukuria e “çmimit sipas tregjeve” në tregun ndërkombëtar. Kur ka vlerësim të monedhës vendase, kurba e kërkesës që lidhet me çmimin në monedhën e importuesit zhvendoset lart. Nëse ka dukuri të çmimit sipas tregjeve, atëherë eksportuesi rregullon marzhin e fitimit dhe në këtë mënyrë dhe çmimin. Pra, një faktor i rëndësishëm që ndikon në rregullimin e çmimit, është mënyra se si ndryshon elasticiteti i kërkesës në lidhje me çmimin e shprehur në monedhën vendase. Ekzistenca e “çmimit sipas tregjeve” varet nga konveksiteti i kërkesës së planifikuar me të cilën përballet firma. Nëse kërkesa bëhet më elastike ndërsa çmimet e shprehur në monedhën vendase rriten për shkak të vlerësimit të saj, atëherë marzhi i fitimit i aplikuar nga eksportuesi do të bjerë. Kjo situatë supozon se lëvizjet e kursit të këmbimit ndikojnë në marzhin e fitimit të aplikuar nga firma eksportuese. Kur ka konkurrencë të përsosur, elasticiteti i çmimit të kërkesës përcaktohet infinit dhe në këtë situatë, ai nuk ndryshon me çmimin prandaj dhe koeficienti i çmimit sipas tregjeve do të jetë i barabartë me zero. Në këtë rast, kurba e kërkesës është horizontale prandaj eksportuesi do të jetë një marrës çmimi. Në këtë rast rregullimi i marzhit të fitimit, amplifikon efektin e kursit të këmbimit.

Përçimi jo i plotë i kursit të këmbimit mund të rezultojë për shkak të dy faktorëve.

Së pari, ndryshimet në koston marxhinale të ndikuara nga ndryshimet e çmimeve të inputeve për shkak të lëvizjeve të kursit të këmbimit.

Së dyti, mund të ndodhë nga rregullimet e marzhit të fitimit nga eksportuesi monopolist. Sjellja monopoliste e eksportuesve është analizuar në literaturë duke aplikuar modelin e çmimit sipas tregjeve dhe modelin e elasticitetit të kërkesës. Kur

ka shumë firma që prodhojnë në një treg, është e vështirë të matet fuqia e tregut të një firme të vetme, pasi do të ketë shumë elasticitete vetjake dhe të kryqëzuara të kërkesës dhe të dhëna të kufizuara.

Rishikimi i literaturës

Koncepti i çmimit sipas tregjeve u përpunua për herë të parë nga Krugman (1986), i cili e identifikoi këtë fenomen të vendosjes së çmimit si një mjet efektiv për prodhuesit, për të përafëruar çmimet e eksportit sipas strategjive të tyre të rritjes në tregjet e huaja. Megjithatë, autori argumenton se strategjia "çmimi sipas tregjeve", zhvillohet vetëm në një mjedis konkurrence joperfekte, ku diskriminimi i çmimeve vjen si rezultat i segmentimit të tregut, pavarësisht nga faktorët që ndikojnë në prodhim si, gjeografia, asimetria e informacionit, kostot e transportit dhe marrëdhëniet tregtare dypalëshe. Në mënyrë të ngjashme, Froot dhe Klemperer (1989) konceptojnë një model dinamik, të bazuar në supozimin se pesha e tregut është e rëndësishme për të përcaktuar fitimet afatgjata për firmat eksportuese dhe duke pasur parasysh paqëndrueshmërinë e kursit të këmbimit, ato duhet të bëjnë kompromise ndërmjet fitimeve dhe pjesës së tregut. Literatura ofron dëshmi të mjaftueshme për ekzistencën e "çmimit sipas tregjeve", në ekonomitë e avancuara dhe ato në zhvillim. Knetter (1989), Marston (1990), Knetter (1993), Swamy dhe Thurman (1994), Gagnon dhe Knetter (1995) sjellin prova empirike që strategjia "çmimi sipas tregjeve" e eksportuesve, nga ekonomitë e mëdha globale, realizohet duke bërë një rregullim të marzhit të fitimit që është specifik për çdo treg destinacioni, duke stabilizuar çmimin përfundimtar të eksportit, në mënyrë që të përballet efektivisht me konkurrencën lokale dhe të mbajë pjesën e tregut. Në këtë drejtim, kursi i këmbimit është përcaktuesi kryesor në procesin e "rregullimit" të çmimeve, ndërkohë që ndryshimet në të ardhurat ndërmjet vendeve shihen jo të njëjtit nivel rëndësie.

Në funksion të kësaj strategjie Knetter (1989, 1993) aplikoi një model me efekte fikse, që analizon variacionet e çmimeve në tregjet e eksportit. Qëllimi është të kushtëzohen variacionet e vëzhguara në çmimet e eksportit me ndryshimet e zakonshme në kosto dhe marzhe, të dyja të pavëzhgueshme, të cilat përafrohen nga një grup variablash dummy: efektet kohore dhe efektet e vendit të destinacionit

Një qasje alternative është ajo e Marston (1990). Ky autor identifikon kushtet e kërkesës dhe kostos të cilat gjenerojnë elasticitete të ndryshme, të përcaktuara si ndryshime në çmimet relative midis tregjeve të huaja dhe atyre vendase, për shkak të luhatjeve të kursit të këmbimit. Në këtë rast ekzistenca e strategjisë "çmimi sipas tregjeve", rrjedh drejtpërdrejt nga regresioni dhe për rrjedhojë, nuk është e nevojshme të zbatohen kufizime të ndryshme në parametrat e vlerësuar, për të testuar ekzistencën e saj. Marston (1990), modelon një monopolist diskriminues të çmimit që shet në tregun vendas dhe atë të eksportit. Duke diferencuar një kusht të rendit të parë, ai arrin në përfundimin se përgjigja e çmimit të eksportit ndaj një ndryshimi të kursit të këmbimit varet nga dy faktorë: konveksiteti i kurbës së kërkesës në tregun e eksportit dhe çdo ndryshim në koston marxhinale që mund të rezultojë nga ndryshimi i niveleve të prodhimit. Konveksiteti i kërkesës përcakton se si ndryshon elasticiteti i kërkesës

me çmimin. Në përgjithësi, nëse kërkesa bëhet më (më pak) elastike me rritjen e çmimeve të monedhës vendase, atëherë vlera optimale e marzhit të fitimit ngarkuar nga eksportuesi do të bjerë (rritet) ndërsa çmimi në monedhën e blerësit rritet, p.sh., ndërsa monedha e blerësit zhvlerësohet kundrejt asaj të eksportuesit. Modeli i Marston gjithashtu lejon që ndryshimet e kursit të këmbimit të kenë efekte në çmimet e brendshme nëpërmjet kostos marxhinale. Në të dyja rastet, qasja empirike bazohet në analizën e përgjithshme. Në këtë kontekst, problemi kryesor empirik është vështirësia për të pohuar ekzistencën e diskriminimit të çmimeve sipas tregjeve të destinacionit, duke qenë se çmimi u referohet produkteve të ndryshme.

Nga një këndvështrim teorik, Brauer (1999) përdor një kornizë oligopolistike për të shpjeguar përcimin e efekteve të ndryshimeve të kursit të këmbimit ose kostos të çmimit. Faktori më me ndikim për vendosjen e çmimeve, është elasticiteti i kërkesës, i cili është funksion i çmimeve të rezervuara dhe zëvendësueshmërisë ndërmjet produkteve. Shembuj për rastet e studimeve empirike të "çmimit sipas tregjeve" përfshijnë Khalaf dhe Kichian (2000) për rastin e industrisë së pajisjeve të transportit, Bernhofen dhe Xu (2000) për rastin e industrisë petrokimike ose Gross dhe Schmitt (2000) për rastin e automobilave. Jaeger e të tjerë, (2001) gjejnë prova empirike se regjimet me inflacion të ulët, priren të minimizojnë efektet e përcimit të kursit të këmbimit dhe si rezultat eksportuesit aplikojnë marzhe fitimi më të larta, për të mbajtur çmimet e eksportit të qëndrueshme drejt këtyre ekonomive.

Në një analizë të njëmbëdhjetë vendeve të industrializuara, Bailliu dhe Fujii (2004) argumentojnë se, rënia e përcimit të kursit të këmbimit në çmimet e brendshme i atribuohet një mjedisi me inflacion të ulët. Yang (2007) duke hetuar për asimetri të mundshme në përcimin në çmimet e importit në SHBA, arrin në përfundimin se efekti i përcimit të kursit të këmbimit gjatë periudhave të vlerësimit të dollarit, ndryshon nga një industri në tjetrën.

Çmimet e mallrave të eksportit dhe importit ndikohen nga zhvillimet në tregjet ndërkombëtare dhe lëvizjet e kursit të këmbimit. Në këtë drejtim, ekonomitë e vogla të hapura, janë supozuar gjerësisht në literaturë se nuk kanë fuqi tregu në procesin e vendosjes të çmimeve të mallrave të tyre të tregtuara. Në këtë rast, çmimet e tregut pritët të përcaktohen thjesht nga ecuria e çmimeve ndërkombëtare dhe e kursit të këmbimit, duke përthithur kështu një përcim të plotë. Megjithatë, gjetjet empirike kanë zbuluar një përcim jo të plotë në ekonomitë e përparuara dhe ato në zhvillim. Kjo merret si dëshmi e të ashtuquajturit efekt "çmimi sipas tregjeve", që supozohet se pasqyron fuqinë e tregut të eksportuesve dhe importuesve të një vendi. Rezultatet tregojnë se elasticitetet e çmimeve të eksportit janë më të larta në ekonomitë në zhvillim sesa në ato të përparuara, dhe ndër të tjera elasticitetet tregtare ndikohen kryesisht nga faktorët makroekonomik. Studimi i përcaktuesve të çmimit sipas tregjeve në nivel firme, në dymbëdhjetë ekonomi në zhvillim, i Asprilla e të tjerë, (2015), zbulon se eksportuesit përthithin 10% deri në 15% të luhatjeve të kursit të këmbimit dhe përçojnë diferencën, dhe efektet e çmimit sipas tregjeve, rriten me madhësinë e firmës. Bussiere, Delle Chiaie dhe Peltonen (2014) vlerësojnë ekuacionet për çmimet e eksportit dhe importit për dyzet vende, nga të cilat njëzet e dy ekonomi në zhvillim,

duke synuar të kuptojnë rolin e heterogjenitetit midis vendeve në shkallën e përcimit të kursit të këmbimit, në çmimet e importit dhe eksportit.

Në një analizë empirike mbi vendet me të ardhura të mesme-të ulëta (përfshirë Shqipërinë), Rollo (2014) hedh poshtë supozimin se ekonomitë e vogla të hapura janë marrës të pastër të çmimeve, dhe si rrjedhim janë të afta të vendosin çmimet në treg. Konkluzioni i saj buron nga konstatimet se, eksportuesit nga këto vende aplikojnë çmime të ndryshme për të njëjtat mallra, në tregje të ndryshme. Sipas Rollo (2014), "çmimi sipas tregjeve" mund të udhëhiqet nga mënyra se si produktet perceptohen nga konsumatorët. Cilësia e një produkti mund të perceptohet ndryshe në vende të ndryshme, dhe kjo do ta bënte cilësinë një koncept subjektiv dhe jo objektiv, i cili mund të shfrytëzohet nga eksportuesit duke ngarkuar marzhe fitimi të ndryshme, ose duke markuar mallra të specializuara si produkte me cilësi të ndryshme në tregje të ndryshme. Në mënyrë të ngjashme, Penkova dhe Sinclair (2010) kanë testuar për sjelljen e mundshme "çmimi sipas tregjeve" të eksportuesve bullgarë të tekstileve dhe makinerive industriale gjatë periudhës 1998-2008. Rezultatet empirike të gjetura nga autorët, ofrojnë dëshmi të reja mbi reagimin optimal të çmimit të eksportit të një firme ndaj ndryshimeve të kursit të këmbimit, në varësi të një sërë faktorësh që transmetohen përmes dy kanaleve kryesore: ndikimi i kursit të këmbimit në koston marxhinale dhe marzhi i fitimit mbi koston marxhinale.

Rama dhe Vika (2019) në një studim të eksporteve dhe importeve shqiptare, duke marrë në konsideratë koston e brendshme dhe mjedisin ndërkombëtar, arrijnë në konkluzionin se, efektet e strategjisë "çmimi sipas tregjeve" janë të konsiderueshme në sjelljen çmim vendosëse të tyre. Ata vlerësojnë se, lëvizjet e çmimeve ndërkombëtare dhe luhatjet e kursit të këmbimit influencojnë gjysmën e ecurisë së çmimeve të eksporteve të të mirave të prodhuara në Shqipëri dhe përcimi i tyre në çmimet e importeve është diçka më shumë se kaq. Meqënëse pesha e Shqipërisë në tregtinë e jashtme të Eurozonës është e vogël dhe në përputhje me madhësinë e saj ekonomike relative, kjo sugjeron se sjellja e firmave eksportuese shqiptare për vendosjen e çmimeve mund të ndikohet nga faktorë të tjerë përveç pjesës së tregut, si p.sh. diferencimi i produktit që u lejon atyre të krijojnë avantazhe specifike konkurruese.

Konkluzione

Në kushtet e një konkurrence jo perfekte, efektet e strategjisë "çmimi sipas tregjeve" janë të rëndësishme dhe duhen marrë në konsideratë në sjelljen çmim vendosëse të eksportuesve. Reagimi i çmimeve të eksportit ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit, është në varësi të një sërë faktorësh (i një rëndësie të veçantë, elasticiteti i kërkesës), që transmetohen përmes dy kanaleve kryesore: ndikimi i kursit të këmbimit në koston marxhinale dhe marzhi i fitimit mbi koston marxhinale. Studimet e shumta empirike, të fokusuara fillimisht në ekonomitë e zhvilluara, pretendonin se vetëm këto ekonomi ishin të afta të aplikonin strategji të çmimit sipas tregjeve. Por, gjatë dekadës të fundit ka pasur shumë studime empirike mbi ekonomitë e vogla të hapura, rezultatet e të cilave, sugjerojnë se dhe këto ekonomi, janë të afta të vendosin çmime të ndryshme sipas tregjeve të ndryshme, duke rrëzuar hipotezën se janë marrëse çmimi. Pavarësisht

pjesës së vogël të tregut të tyre, ato mund të ofrojnë produkte të diferencuara, gjë që i lejon të aplikojnë "çmimin sipas tregjeve".

Literatura

- Asprilla, A. and N. Berman, O. Cadot, M. Jaud (2015), "Pricing-to-market, Trade Policy, and Market Power", Graduate Institute of International and Development Studies Working Paper Series, Working Paper N IHEIDWP04-2015
- Bacchetta, P. and E. van Wincoop (2005), "A Theory of the Currency Denomination of International Trade", *Journal of International Economics*, 67.
- Bailliu J. and E. Fujii (2004), "Exchange Rate Pass-Through and the Inflation Environment in Industrialized Countries: "An Empirical Investigation", Bank of Canada, Working Paper 2004-21
- Brauer H. (1999), "Price setting in international markets", Kiel Working Paper No. 915
- Bussière, M., and S. Delle Chiaie, T. A. Peltonen (2014): "Exchange Rate Pass-Through in the Global Economy: The Role of Emerging Market Economies" *IMF Economic Review*, Vol.62, No.1
- Bussière M, Gaulier G, Steingress W (2017), "Global Trade Flows: Revisiting the Exchange Rate Elasticities" Bank of Canada Staff Working Paper 2017-41
- Engel C. (2017), "The Role of Exchange Rates in International Price Adjustment", *Macroeconomic Review*, April 2017
- Froot, K. and D. Klemperer (1989), "Exchange Rate Pass-Through when Market Share Matters", *American Economic Review*, 79.
- Gagnon, J. and M. Knetter (1995), Mark-up Adjustment and Exchange Rate Fluctuations: Evidence from Panel Data on Automobile Exports, *Journal of International Money and Finance*, 14(2).
- Gil-Pareja, S. (2000), "Exchange Rates and European Countries Export Prices: An Empirical Test for Asymmetries in Pricing to Market Behaviour, *Weltwirtschaftliches Archiv*.
- Goldberg P, Knetter M. Goods prices and exchange rates: What have we learned? National Bureau of Economic Research, December 1996.
- Jaeger A., and K. Ross, Z. Kontelemis, M. Kieler, G. Meredith [2001], "Monetary and Exchange Rate Policies of the Euro Area", International Monetary Fund Report
- Knetter, M. (1989), Price Discrimination by US and German Exporters, *American Economic Review* 79.
- Knetter, M. (1993), International Comparisons of Pricing to Market Behaviour, *American Economic Review* 83 (3).
- Krugman, P. (1986) "Pricing to Market When the Exchange Rate Changes." NBER Working Paper 1926, National Bureau of Economic Research, Cambridge, Massachusetts
- Moreno Martin L, Rodriguez D. Pricing to market at firm level, *Review of World Economics*, February 2002
- Penkova E, P. Sinclair (2010), "Bulgaria's Export Prices and Pricing to Market Behaviour"
- Rama A, Vika I. Pricing to markets effects in Albania, *International Journal of Economics, Commerce and Management*, United Kingdom, 2019.
- Rollo, V. (2014) "Unexpected pricing to market in goods classified as homogeneous." The Graduate Institute of International Development Studies Paper Series 2014. Institute of International and Development Studies Working Paper Series, Working Paper N IHEIDWP04-2015
- Warmendinger TH. Import prices and pricing to market effects in the Euro area. January 2004.
- Yang, J. (2007), "Is Exchange Rate Pass-through Symmetric? Evidence from US Imports", *Journal of Applied Economics*, 39, Younder E. Pricing to market. An evaluation for Turkey. Middle East Technical University, July 2007.

KOMITETI SHKENCOR



Dr. Zef PREÇI - ka një eksperiencë prej mbi 30 vite pune si studiues në fushën e kërkimeve social-ekonomike, ideimin dhe drejtimin e kryerjes së studimeve, prezantimeve publike, hartimit të vrojtimeve kombëtare, interpretimeve dhe analizave, etj. Ai ka kryer një sërë detyrash publike si: Ministër i Ekonomisë dhe Privatizimit (1999); Këshilltar Ekonomik i Presidentit të Republikës (2002-2004); Kryetar i parë i Autoritetit të Konkurrencës (2004-2005); gjithashtu ka kryer detyra të përfaqësimit në nivele të ndryshme brenda komunitetit të biznesit dhe të shoqërisë civile. Dr. Preçi ka dhënë një kontribut të konsiderueshëm për institucione të ndryshme financiare, sistemin e Kombeve të Bashkuara dhe komunitetin e biznesit, duke ofruar ekspertizë në ndërtimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e shërbimeve të ndryshme, me njohuri të gjerë në rajon dhe veçanërisht në Kosovë. Ai ka një serë kualifikimesh brenda dhe jashtë vendit. Ai është autor shumë artikujsh dhe studimesh dhe pjesëmarrës në shumë konferenca shkencore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Aktualisht, Dr. Preçi është kryeredaktor i Revistës Shqiptare Social-Ekonomike, përfaqësues i shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për barazinë gjinore si dhe Drejtor Ekzekutiv i QShKE (www.acer.org.al). E-mail: zef.preçi@gmail.com



Prof. Dr. Ana Paula FERREIRA FERNANDES LOPES - Ph.D. në matematikë. Eshtë profesoreshë në Institutin e Kontabilitetit dhe Administratës së Politikave të Porto (ISCAP/P.PORTO) që nga viti 2000. Eshtë autor dhe bashkëautor i shumë botimeve. Ka qenë koordinatore e projekteve që lidhen me përdorimin e teknologjisë dhe inovacionin pedagogjik në arsimin në distancë. Në vitin 2015, mori Çmimin për Inovacion Pedagogjik në Arsimin në Distancë. Ka qenë anëtare e Komitetit Shkencor të disa Konferencave Ndërkombëtare dhe është anëtare e Bordit Shkencor të Hyperion Economic Journal (HEJ). Ajo është recensues dhe anëtare e komitetit të programit për disa Konferenca Ndërkombëtare. Kërkuese në Qendrën e Kërkimit për Komunikim dhe Edukim (CEOS.PP) dhe studiues në Qendrën Kërkimore për Studimin e Popullsisë, Ekonomisë dhe Shoqërisë (CEPESE). Fokusi kryesor i saj në fushën e kërkimit është LMS përkrah platformat, teknologjitë informative në arsim, mësimin elektronik, paradigmen e mësimdhënies, Analizën e të mësuarit, vendimmarrjen me shumë kriterë. E-mail: aplopes@iscap.ipp.pt



Prof. Dr. Antonio DA SILVA ROBALO ka më shumë se 35 vjet përvojë në institucionet e arsimit të lartë. Ai ka marrë PhD nga universiteti i Trier (Gjermani) në vitin 1992. Në vitin 2005 ai merr titullin profesor në ISCTE-IUL Institutin Universitar të Lisbonës. Ai ka qenë dekan për Marrëdhënie Ndërkombëtare në shkollën e Biznesit në ISCTE, ku ka dhënë mësim në fushën e metodave sasiore dhe menaxhimit. Aktualisht fusha e tij kryesore e hulumtimit është menaxhimi ndërkulturor dhe krahasues. Ai është autor dhe bashkautor i shumë artikujve kërkimore, kumtesave në konferenca dhe studimeve. Prof. Robalo ka një eksperiencë të konsiderueshme ndërkombëtare, duke dhënë mësim në shumë vende të ndryshme, duke përfshirë Mozambik dhe Cape Verde (në portugalisht), Austria (në gjermanisht), Francë, Kinë, Makau, Japonia, Koreja, Poloni, Rep. Çeke, Rusia, Gjeorgjia (në anglisht). E-mail: Antonio.robalo@iscte.pt



Prof. Dr. Dorota WITKOWSKA - Departamenti Finances dhe Menaxhimit Strategjik Universiteti i Lodzit, Poloni. Ka marrë titullin Doktor në vitin 1985 në Universitetin e Lodzit. Prof. Ëitkoëska ka kryer kërkimet e saj shkencore në Universitetin e Shkencave të Natyrës në Varshavë, Politeknikën e Lodzit, gjithashtu në Princeton University, Pennsylvania University dhe Georg August University në Göttingen (Gjermani). Kryen kërkimet mbi Tregun Financiar, Ekonometri Financiar, Studime Krahasuese, Analiza Multidimensionale Statistike, Studimet Gender të cilat financohen nga qeveria polake dhe nga grantet e BE-se. Prof. Ëitkoëska është autore dhe bashkautore e mbi 200 artikujve shkencorë të publikuar në polonisht, anglisht dhe rusisht si dhe e 6 monografive dhe 9 teksteve universitare. Prof. Ëitkoëska është pjestare e disa organizatave shkencore ndërkombëtare në Poloni dhe në Botë. Prof. Ëitkoëska ka pasur funksionin e Zv/dekanit për çeshtjet shkencore në Fakultetin e Informatikës së Aplikuar e Matematikës në Universitetin e Shkencave të Natyrës në Varshavë dhe pjestare e bordit ekzekutiv të International Atlantic Economic Society. E-mail: dorota.witkowska@uni.lodz.pl



Prof. Dr. Ing. Elena HORSKÁ - Aktualisht është profesoreshë e Marketingut dhe Menaxhimit në Departamentin e Marketingut dhe dekanë e Fakultetit të Ekonomisë dhe Menaxhimit, Universiteti Slovak i Bujqësisë në Nitra. Në vitet 2003-2010 ka qenë zëvendës dekan për marrëdhënie ndërkombëtare dhe 2010-2014 zëvendës-rektore për marrëdhëniet ndërkombëtare. Në vitin 2011 ajo u nderua me titullin "Profesor Honoris Causa" nga ana e Shkollës së Studimeve Profesionale dhe Kërkimeve të Delhit, Neë Delhi, Indi. Orientimi i saj kryesor i kërkimit përfshin internacionalizimin brenda dhe jashtë kufijve të BE-së, identifikimin e mundësive për të bërë biznes në tregjet fqinje (Visegrad), Evropë, vendet më pak të zhvilluara dhe ato në zhvillim (fokus agrobiznesi dhe tregu agro-ushqimor), studime të konsumatorëve, neuromarketing. Ajo

ka qenë profesor vizitore në Shkollën e Studimeve Profesionale dhe Kërkimeve Delhi në Nju Delhi, Indi, në Universitetin Kombëtar Kazakistik të Kazakistanit në Almaty, në Finlandë, Itali, Portugali, Spanjë dhe Irlandës dhe në programin CEEPUS në Kroaci, Hungari, Austri dhe Poloni. Ajo ka qenë një koordinatorë e 6 projekteve kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe 22 projekte ndërkombëtare. Ajo është autore e më shumë se 200 botimeve, përfshirë 6 tekste kombëtare / ndërkombëtare, 10 monografi kombëtare / ndërkombëtare të botuara në Sllovaki, Çeki, Poloni, Austri, Spanjë, Rumani dhe Kroaci dhe pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare në Tajlandë, Kinë, Maltë, Ganë, Hungari, Greqi, Poloni, Çeki, Austri, Brazil, Indonezi, SHBA dhe Singapor. Ajo është koordinatorë e programit të diplomës së dyfishtë "Marketing dhe Tregti Agrare" të organizuar së bashku me Universitetin Agrare të Rusisë - Akademia Timiryazev e Moskës dhe anëtare e Agjencisë Evropiane të Akreditimit për Bordin e Shkencave të Jetës (me Sekretariatin EALS në Francë). Elena.Horska @ gmail.com



Prof. Dr. Fatmir MEMAJ- ka një eksperiencë më shumë se 30 vite në institucionet e arsimit të lartë si Lektor i Statistikës dhe Demografisë. Mori gradën PhD në vitin 1996. Në Maj të vitit 2011, Profesor i Asociuar dhe në Mars të vitit 2007 Profesor. Prof. Memaj ka një eksperiencë të gjerë në arsimim dhe ekonomi, duke theksuar: Zëvendës Ministër i Mbrojtjes për çështjet ekonomike (1992-1993); Lektor, Fakulteti i Biznesit dhe i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës (1994-1997); Drejtues i Departamentit të Statistikës në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës (1997-1998), Zëvendës Dekan, Fakulteti i Ekonomisë, UT (2003-2016), etj. Aktualisht, ai është profesor në Fakultetin e Ekonomisë, UT dhe Drejtor Ekzekutiv i Forumit Shqiptar Social-Ekonomik (ASET) eëë.aset-al.com. Autor dhe bashkë-autor i shumë librave dhe monografive dhe mbi 50 artikujve në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, i më shumë se 80 punimeve të konferencave dhe i një sërë studimesh dhe punimesh kërkimore në fushën e tij. E-mail: fmema@yahoo.com ose fatmirmemaj@feut.edu.al



Prof. Dr. Dr.h.c. Heinz-Dieter WENZEL- ka një eksperiencë të gjerë në çështjet ekonomike. Ai ka studiuar matematikë në Universitetin e Munster-nit dhe mori gradën PhD në vitin 1975 në Universitetin e Heidelberg-ut. Ai ka qenë Profesor i Financave Publike në Universitetin e Heidelberg-ut (1983-1985) dhe Profesor i Teorisë së Ekonomisë në Universitetin Ludëig-Maximilian, Munihi (1985-1989). Nga viti 1989, ai ka qenë Profesor i Ekonomisë Publike në Universitetin e Bamberg-ut, ku ai doli në pension në vitin 2011. Nga viti 1989 deri në vitin 2011, ai ishte Drejtues i Grupit të Kërkimeve Ekonomike të Bamberg-ut për Qeverisjen dhe Rritjen (BERG). Gjithashtu, në vitin 2000 ai mori përsipër menaxhimin e një projekti bashkëpunues midis Univ të Bamberg-ut, Budapest, Sarajevë, Tiranë, Tetovë, që formoi bashkëpunim ekonomik në kërkim dhe mësimdhënie. Ai është autor i shumë librave dhe artikujve shkencorë. E-mail: heinz-dieter.enzenel@uni-bamberg.de



Prof. Dr. Iraj HASHI- ka përfunduar studimet e tij të Masterit në Shtetet e Bashkuara (Universiteti i Maryland) dhe studimet e doktoraturës në Britaninë e Madhe (Universiteti i Keele). Ai e filloi karrierën e mësimdhënies në Universitetin e Staffordshire në vitin 1978 si Lektor për lëndën e Ekonomisë. Aktualisht është Profesor i Ekonomisë dhe Drejtor i Qendrës për Kërkime mbi Ekonomitë në Zhvillim, në Universitetin e Staffordshire-it. Ai është i specializuar në Mikroekonomi, Ekonomi Industriale dhe që nga viti 1990, Ekonomia në Tranzicion. Ai ka koordinuar Projektin Erasmus, Socrates dhe programet e Tempus-it dhe aktivitetet e tij në Evropën Qendrore dhe Lindore. Dr. Hashi ka qenë i përfshirë në mënyrë aktive në kërkime, mësimdhënie dhe konsulencë në ekonomitë në tranzicion të Evropës Qendrore dhe Lindore që nga viti 1992, dhe ka punuar me universitetet dhe institucionet kërkimore dhe konsulencës në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Kroaci, Republikën Çeke, Kosovë, Maqedoni, Poloni dhe Rusi në një gamë të gjerë projektesh që kishin në qendër të tyre sfidat e tranzicionit në këto vende. Interesat e tij kërkimore përfshijnë: privatizimin dhe ristrukturimin, qeverisjen e korporatave, konkurrencën industriale, falimentimin dhe riorganizimin, risinë dhe ndryshimet teknike. Ka botuar shumë artikuj në revista shkencore dhe libra. E-mail: i.hashi@staffs.ac.uk



Prof. Dr. Janez PRAŠNIKAR- Profesor i Ekonomisë, është Drejtor Ekzekutiv i Institutit për Evropën Juglindore dhe themelues dhe drejtor i Programit Master i Biznesit dhe Organizimit në Fakultetin e Ekonomisë, në Universitetin e Lubjanës, program me diplomë të njohur në nivel ndërkombëtar. Ai ka qenë anëtar i Bordit Strategjik të Kryeministrit të Sllovenisë dhe të komitetit të programit të Presidentit të Sllovenisë. Si një hulumtues ai është i lidhur me Institutin Ëilliam Davidson në Shkollën e Biznesit, Universiteti i Michigan, SHBA, dhe Qendrën për Hulumtime të Politikave Ekonomike (CEPR) në Londër, Mbretëria e Bashkuar. Fushat e ekspertizës të Dr Prašnikar përfshijnë ekonomitë në tranzicion, sjelljen e ndërmarrjeve, sipërmarrjen, ekonominë menaxheriale dhe marrëdhëniet e punës. Dr. Janez Prašnikar mbaruar Ph.D. në Universitetin e

Lubjanës (1982). Ka qenë profesor vizitor në Universitetin e Berkeley (vjeshtë 1984), Universitetin Cornell (pranverë 1985) dhe Universiteti Pitsburg (vjeshtë 1987). Nga pranverë 1997-2005 ai ishte profesor i afliuar në në Shkollën e Biznesit në Universitetin e Michiganit. Profesor Prašnikar ka kryer hulumtime dhe këshillime të politikave për kompanitë dhe qeveritë për ish-Jugosllavinë, Kinën dhe Slloveninë. Ai ka shërbyer si president apo anëtar i Bordeve mbikëqyrës në firmat e shumta. Email: janez.prasnikar@ef.uni-lj.si



Prof. Dr. Justina SHIROKA PULA- ka më shumë se 35 vjet përvojë në institucionet e arsimit të lartë. Ajo filloi si asistente dhe mori gradën PhD në vitin 2004. Ajo ka qenë lektore në Universitetin e Tetovës (1994-1999) dhe Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë (2004-2004), si dhe universiteteve private në Prishtinë: Iliria (2006-2007), Fama (2006-2007) dhe Globus (2011). Prof Shiroka - Pula ka drejtuar Departamentin e Matematikë dhe Statistikës të Fakultetit të Ekonomisë nga 1999 deri në 2001, si dhe ka qenë Drejtuese e Bordit të Studimeve Master të Programit të Manaxhimit të Shëndetësisë (2002-2003). Përveç angazhimit të saj akademik, Prof Shiroka - Pula ka qenë Ministre e Energjisë dhe Minierave (2007-2011). Aktualisht ajo është deputete në parlamentin e Kosovës nga viti që nga viti 2011. Ajo gjithashtu

ka shumë tekste në fushën vendim-marrjes manaxheriale, programimit operacional dhe sipërmarrjes. Dr. Pula është certifikuar nga programet e shumta mbi Bizneset e vogla dhe të mesme, Sipërmarrjes, dhe Gruaja në ekonomi, në Francë (Qeveria Franceze), në SHBA (Departamenti i Shtetit) dhe UNIFEM. Aktualisht Prof Shiroka - Pula është profesoresh e Menaxhimit të SME-ve, Vendimmarrjes Manaxheriale dhe Mjedisit të Biznesit në ciklin e studimeve Bachelor; Sipërmarrja e SME-ve dhe Metodave të Kërkimit në Manaxhim në ciklin e studimeve Master. E-mail:justinapula@hotmail.com



Prof. Dr. Luigi D'AMBRA- Profesor Statistike, Departamenti i Ekonomiksit, Institucionet e Manaxhimit (Universiteti i Napolit-Itali). Ai ka realizuar një aktivitet të thelluar didaktik dhe shkencor në Universitetin e Napolit. Aktiviteti i tij është i përqendruar në analizën me shumë ndryshore, matricat, shkallët shumëdimensionale, analizat jo simetrike dhe analizat kumulative korresponduese. Subjekt tjetër e kërkimit të tij kanë qenë modelet log-bilinear dhe log-trilinear. Ka realizuar kurse mbi analizën e të dhënave dhe regresion me variabla diskrete të varura. Ka organizuar disa konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, në të cilën janë diskutuar vlerësimet e sistemeve universitare. Ai gjithashtu ka redaktuar hartimin e disa librave në kuadër të cilësishë së shërbimeve. Në korrik 2015 kam marrë emërimin nga ana e Shefit të Sektorit të Vlerësimit

në Agjencinë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë në Shqipëri si pedagog i jashtëm për të vlerësuar programin e studimit të ciklit të tretë, "Ph.D në Statistike "ofruar nga Universitë Nostra Signora del Buon Consiglio të Tiranës. Nga viti 2011 ai është anëtar i Bordit Këshillimor JAQM (Revista e Metodave Sasiore e aplikuar) dhe Editor i Revistës Elektronike për Analizat Statistike e Aplikuar (EJASA) E-mail: dambra@unina.it



Prof. Dr. Nasir SELIMI është profesor në Fakultetin e Biznesit dhe Ekonomisë në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë që nga viti 2002. Në vitin 2004 - 2008 kreu funksionin e Dekanit në FBE. Lëmit në të cilat më së shumti është i përkushtuar, prof. Selimi janë ato të ekonomiksit dhe ekonomisë ndërkombëtare. Ka botuar një numër të punimeve shkencore në revista shkencore ndërkombëtare. Prof. N. Selimi poashtu ka të botuar disa libra dhe teksteve universitare në sferën e ekonomiksit dhe ekonomisë ndërkombëtare. E-mail: n.selimi@seeu.edu.mk



Prof. Dr. Statty STATTEV- Rektori i Universitetit National and World Economy (UNWE). Zëvendëskryetari i Konferencës së Rektorëve në Bullgari. Nga 2003-2011 ai ka qenë zëvendës Rektori i parë i UNWE, dhe 1999-2003 -Dekani i Fakultetit të Ekonomisë së Përgjithshme të të njëjtit universitet. Në 1984-1985 është specializuar në Departamentin e Ekonomisë Politike në Universitetin shetror "M. Lomonosov ", Moskë, Rusi. Në 1989-1990 ai ka kryer një specializim Fulbright si hulumtues në Departamentin Ekonomik të Universitetit Boston, Massachusetts, USA. Si një profesor vizitor në Universitetin e Bostonit ai jep kurse të rregullta dhe verore lidhur me ekonomitë e vendeve të Evropës Lindore. Ai ka punuar si konsulent i Bankës Botërore. Ka udhëhequr dhe ka marrë pjesë në një numër të madh projektesh kombëtare dhe ndërkombëtare.

Prof. Stattev është përfaqësues i Republikës së Bullgarisë dhe Anëtar i Bordit Ekzekutiv të Nismës së Evropës Qendrore për Rrjetin e Universiteteve. Ai ka më shumë se 170 publikime në bullgarisht, rusisht, anglisht, polonisht, greqisht,

serbisht, dhe shqip. Ai është anëtar i Këshillit Drejtues të Bankës Kombëtare Bullgare dhe Kryetar i Bordit të Drejtorëve të kompanisë Mint. E-mail: sstatte@unwe.bg



Prof. Dr. Shyqyri LLACI - është pedagog në FEUT, në fushën e Menaxhimit të Biznesit, Lideri i bashkëautorit të qeverisjes së korporatave. Ai ka titullin Doktor në fushën e menaxhimit të produktivitetit dhe është pedagog në FEUT që nga viti 2001. Prof. Dr. Shyqyri Llaci është autor dhe bashkëautor i disa teksteve universitare, një monografi dhe ka qenë i përfshirë në projekte të ndryshme dhe aktivitete lidhur me kërkimet shkencore. Gjithashtu, ka botuar shumë artikuj në Shqipëri dhe jashtë vendit, në revista dhe konferenca të njohura shkencore. Gjatë viteve 1993-1994 dhe 2008-2012 ka qenë Zv/ Dekan dhe në vitet 1994-1995 Dekan i Fakultetit të Ekonomisë. Që nga viti 2012 mban postin e Shefit të Departamentit të Menaxhimit. Anëtar i komisionit të Lartë të Akreditimit të Arsimit të Lartë për 8 vjet deri në vitin 2012. Ka botuar artikuj dhe studime shkencore mbi menaxhimin dhe biznesin, aspekte të organizimit të firmave dhe të efektivitetit organizativ, dimensione të lidërshiptit në mjedisin shqiptar. Menaxhimi dhe motivimi i punonjësve në shekullin e ri, qeverisja e shoqërive aksionere dhe atyre tregtare në tërësi, qeverisja e shoqërive aksionere në sektorin publik dhe në vendet e EJL, menaxhimi i produktivitetit. Fushë e interesit shkencor është edhe menaxhimi krahasues, si edhe reformimi, financimi dhe akreditimi i arsimit të lartë në Shqipëri. E-mail: shyqyrrllaci@feut.edu.al



Prof. Dr. Tomasz MROCKOWSKI - ka një eksperiencë të gjerë në mësimdhënie. Ai ka qenë lektor në universitete në Japoni dhe Evropë, duke përfshirë edhe Akademinë Kombëtare të Mbrojtjes në Japoni, Shkollën e Biznesit të Kopenhagen-it, Universitetin e Cambridge, Universitetin e Paris-Sorbonne, dhe ESCP-EAP në Paris. Ai ka realizuar shumë seminare ekzekutive të zhvillimit për kompani lider në Amerikë dhe Evropë, siç janë GM, AT&T, Union Carbide, GE dhe Polaroid. Ai ka qenë anëtar i Bordeve Redaktuesish, i shumë revistave shkencore duke përfshirë Revistën e Zhvillimit të Biznesit Global në Azinë Jugore, Revista e East-Ëest Business, dhe Ëorlndvieë-një publikim shkencor amerikan. Ai ka fituar një numër të madh grandesh nga kompanitë private dhe fondacione publike, duke përfshirë Fondacionin i Andreë A. Mellon, Agjencia Amerikane për zhvillim ndërkombëtar, dhe German Marshall Fund i Shteteve të Bashkuara. Aktualisht, ai është profesor dhe drejtues i Departamentit të Biznesit Ndërkombëtar, Shkolla Kogod e Biznesit, Universiteti Amerikan, Ëashington DC. Ai jep mësim mbi Biznesin Ndërkombëtar dhe Menaxhimin e Tregjeve që janë në Zhvillim, në cilin e studimeve Master. Ai është autor i shumë artikujve shkencorë, raporteve kërkimore dhe librave. E-mail: mrock@american.edu



Prof. Dr. Yannis TSEKOURAS - Profesor Emeritus i Universitetit të Maqedonisë, Selanik, Greqi. Ka studiuar në Fakultetin e Shkencave Ekonomike e Politike të Universitetit të Bazelit (1962-1968), dhe Ph.D. 1968-1971 në Universitetin e Bazelit. Prof. Tsekouras u bë menaxher i projektit në Programin e Zhvillimit Ekonomik të Kantonit të Baselit, Zvicër 1971-1974. Në 1977 ai u zgjodh Profesor extraordinarius i Universitetit të Maqedonisë (ish-Shkollës së Lartë të Industrisë) Selanik, Greqi. Në 1980 ai u zgjodh profesor i Universitetit të Maqedonisë, në vitin 2004 ai u zgjodh anëtar i Parlamentit grek dhe Sekretar i Komisionit Parlamentar të Punëve të Jashtme dhe të Mbrojtjes dhe gjatë 2007-2015 ai ishte këshilltar i Presidentit të të Greqisë. Prof. Tsekouras ishte kryetar i Departamentit të Shkencave Ekonomike në Universitetin e Maqedonisë (1987-1991), rektor i Universitetit të Maqedonisë (1991-1997). Ai është zgjedhur Kryetar i Departamentit dhe Politikës Sociale, Kryetari i Departamentit të Ballkanistikës, Sllavistikës dhe Studimeve Orientale, Drejtor i Institutit të Kërkimeve të Universitetit të Maqedonisë. Gjatë periudhës 1998-2015, Prof. Trsekouras është themelues i Shoqatës së Universiteteve Ekonomike të Europës Jugore dhe Lindore dhe Rajonit të Detit të Zi (ASECU). Ai është autor dhe bashkautor i 36 teksteve universitare, monografive dhe artikujve, si dhe 22 kumtesa të paraqitura në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare E-mail: tsekourj@uom.gr



Prof. Dr. Zhaklina PETO - Ka përfunduar studimet e larta në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Tiranës në vitin 1995, me rezultate shumë të mira. Në vitin 1996, është emëruar pedagoge efektive pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universitetit të Tiranës, në Departamentin e të Drejtës Civile, detyrë të cilën vazhdon ta kryej aktualisht. Gjatë kësaj periudhe, ka realizuar hap pas hapi të gjitha shkallët e kualifikimit shkencor dhe profesional dhe tashmë mban titullin Profesor Doktor. Përvoja shumëvjeçare në procesin e mësimdhënies si lektore e disa moduleve në nivelet Bachelor, Master dhe Doktoraturë e ka ndihmuar për të qenë një njohëse e mirë e doktrinës dhe jurisprudencës vendase dhe asaj të huaj. Formimi i saj akademik dhe profesional, si autore e disa teksteve universitare dhe publikimeve shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare me një shtrirje kohore, dëshmon për një veprimtari shkencore të pandërprerë në fushën e së drejtës. Ndër vite ka ushtruar disa pozicione drejtuese në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës si: Anëtare e

zgjedhur në Këshillin Shkencor të Fakultetit të Drejtësisë, anëtare e Senatit të Universitetit të Tiranës, anëtare e Këshillit të Profesorëve, Përgjegjëse e Departamentit të së Drejtës Civile e zgjedhur në dy mandate, pozicion të cilin e ushtron aktualisht. E-mail: zhaklinpeto@gmail.com



Prof. As Dr. Dorina HOXHA dorina.hoxha@fdut.edu.al ka përfunduar studimet e larta në Drejtësi në Universitetin e Padovës (Itali) në 2004. Në 2008 ka përfunduar studimet master të nivelit të dytë LL.M në Itali. Temën e masterit si kërkuese shkencore e ka përfunduar pranë PAMECA-s në 2007. Në 2008 ka punuar si eksperte ligjore në programin “Shteti ligjor” një projekt i USAID-it, me detyra kryesore si koordinimi i ndihmës teknike në gjykata pilot duke përfshirë edhe zbatimin e reformës ligjore. Në 2013 ka marrë gradën shkencore “Doktor” me një temë në të drejtën penale, duke analizuar lidhjen e kohës dhe veprës penale. Ajo ka fituar gradën shkencore “Profesor i asociuar” në 2016 dhe është bashkëautore në publikime të ndryshme si “E drejta penale, Pjesa e përgjithshme”, një libër i detyrueshëm në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Mbi 15 vjet ajo jep leksione në lëndën “E drejta penale, Pjesa e përgjithshme”. Ajo është avokate në çështjet civile dhe penale me një eksperience mbi 15 vjet dhe në vitin 2019 ajo ka fituar çmimin “Toga e artë” nga Shoqata e Avokatëve Penalistë. Ajo është autore e disa artikujve shkencorë brenda dhe jashtë vendit.



Prof. Asoc. Dr. Etleva LESKAJ, është përgjegjëse e Departamentit të Manaxhimit, në Fakultetin e Ekonomisë. Ajo mban titullin akademik Professore e Asociuar. Gjatë periudhës 2018-2020, ka qenë zv. dekane për kërkimin shkencor dhe marrëdhëniet me jashtë, në Fakultetin e Ekonomisë. Ajo ka mbaruar studimet Master në Administrim Biznesi pranë Fakultetit të Ekonomisë, UT në 2005. Doktoruar në fushën e kulturës organizative në 2009, në fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës. Ajo është lektore e Manaxhimit Strategjik, Planifikimit Strategjik dhe Marrjes së Vendimeve Menaxheriale. Ka marrë pjesë në programe të ndryshme shkëmbimi, për trajnim apo si lektore e ftuar, në Francë, Spanjë, Gjermani, Danimarkë, Angli, Slloveni etj. Prej vitit 2012 është eksperte vleresimi e jashtme pranë Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë. Fushat e saj të ekspertizës janë, vendimmarrja manaxheriale, manaxhimi strategjik dhe kultura organizative. E-mail: etlevaleskaj@feut.edu.al



Prof. Asoc. Dr. Florian NUTA- Diplomuar në Financë (2003). Në vitin 2005, ai mori Diplomën e Masterit në Administrim Biznes në Universitetin e Dunarea-s, Galati. Në vitin 2009, ai mori gradën e PhD në Ekonomiks. Prof. Nuta ka realizuar studimet e tij post-doktorale në Universitetin e Messinës (IT) dhe CNAM Paris (FR) në fushën e Përgjegjësisë Sociale dhe Mjedisore e SME-ve. Ai është Redaktor Ekzekutiv i Revistës së Kontabilitetit dhe Menaxhimit dhe anëtar i disa bordeve këshilluese të revistave shkencore. Prof. Nuta është koordinator i Laboratorit të Kontabilitetit dhe Kërkimeve Fiskale, dhe ka një përfshirje aktive në nismat kombëtare dhe ndërkombëtare kërkimore. Ai është autor dhe bashkautor i shumë librave, më shumë se 30 artikuj të botuar në revista shkencore të njohura ndërkombëtare dhe më shumë se 40 punime nëpër konferenca. Aktualisht ai është Lektor në Universitetin e Danubius Galati, Fakulteti i Shkencave Ekonomike, Rumania, i përfshirë në aktivitetet e menaxhimit kërkimor dhe mësimdhënies në fushën e financave dhe kontabilitetit. E-mail: floriann@univ-danubius.ro



Prof. Asoc. Dr. Laura TAFARO - është Professore e Asociuar në Universitetin e Barit (Departamenti Jonico i Sistemeve të Ekonomisë dhe Ekonomisë së Msdheut). Ajo ka më shumë se 20 vjet përvojë didaktike në Kurset Universitare të të Drejtës civile dhe private, fillimisht si lektore, pastaj si Asistent Professore dhe më në fund si Professore e asociuar. Ka mbaruar doktoraturën në të Drejtën Civile në 2003. Në vitin 1997 u pranua në Shkollën e Specializimit në të Drejtën Civile në Universitetin e Camerino; në vitin 2001 fitoi pozicionin e asistent profesoresh në të drejtën private, në vitin 2004 fitoi titullin profesoresh e asociuar. Nga viti 2006 deri në vitin 2012 ka qenë anëtare e Bordit të Mësimdhënies të programit PhD të të Drejtës Civile; nga viti 2007 e në vazhdim ajo është anëtare e Komiteteve të ndryshme të Fakultetit dhe ka disa detyra Institucionale (Zëvendëseshfe e Departamentit, Zëvendës dekane, Kryetare e Këshillit të Kualifikimeve). Aktualisht, ajo është Dekane e Shkollës në Shkencë dhe Menaxhim Teknik Nautical. Ajo ka një përvojë të gjerë në arsimin universitar dhe pasuniversitar, si drejtuese, propozuese dhe koordinatorë shkencorë të disa kurseve të avancuara dhe kurse trajnimi (2007-2013). Prej vitit 2000 e në vazhdim, ajo ka bashkëpunuar dhe ka

qenë Koordinatorë Shkencore për projekte të ndryshme kërkimore. Prej vitit 2005 e në vazhdim ka realizuar punime shkencore dhe leksione të ndryshme, të paraqitura në takime të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare në fushat e saj kërkimore. Është autore dhe bashkëautore e monografive dhe eseve të botuara në takime Kombëtare dhe Ndërkombëtare dhe është anëtare e redaksisë dhe e Komitetit Shkencor në disa Komitete Shkencore Kombëtare dhe Ndërkombëtare Email: laura.tafaro@uniba.it



Prof. Asoc. Dr. Zamira SINAJ Lindur, më 30 janar 1982 në Vlore, Shqipëri, U diplomua (2006) si Menaxher Turizmi, në Fakultetin Ekonomik, Universiteti “Ismail Qemali”, Vlore. Studime Doktorature në Institutin e Studimeve Evropiane, UT, me teme: "Ndikimi i zhvillimit të biznesit midis Shqipërisë dhe Italisë në zhvillimin ekonomik dhe integrimin Evropian të Shqipërisë (Fokus rajoni i Vlorës)" - në Universitetin e Tiranës. Në 2016 mbrojti gradën shkencore “Doktor” në Universitetin e Tiranës dhe në vitin 2023 titullin Profesor i Asociuar. Pedagogje e lendeve: Menaxhimi i performancës, Administrim Publik Evropian, Zhvillimi i Planeve të Biznesit në Universitetin “Ismail Qemali” të Vlorës që nga viti 2014. Autore dhe bashkëautore në shumë punime shkencore, konferenca, workshope që lidhen me menaxhimin, biznesin, administratën publike, planet e bizneseit, etj. E-mail: zamira.sinaj@univlora.edu.al dhe

zamira.sinaj20@gmail.com

Recenzentë në këtë numër: (në rend alfabetik)

Armira LAZAJ
Eglantina ZYKA
Elena MYFTARAJ
Etleva BAJRAMI
Etleva LESKAJ

Ines DIKA
Fatmir MEMAJ
Frederik ÇUÇLLARI
Kreshnik VUKATANA
Ledina ALOLLI

Mira ANDONI
Mirela MERSINI
Zamira SINAJ
Zef PREÇI

KRITERET PËR BOTIMIN E ARTIKUJVE

Të nderuar bashkëpuntorë,

Redaksia e Revistës Shqiptare Social - Ekonomike, nisur nga dëshira e mirë për të patur një nivel sa më të lartë shkencor të artikujve të botuar në këtë revistë, ju paraqet kriteret bazë për pranimin e një artikulli për tu shqyrtuar për botim.

1. Artikulli duhet të dërgohet në dy gjuhë (shqip edhe anglisht). Versioni anglisht do të botohet elektronikisht në faqen eeb të Revistes Shqiptare Social Ekonomike <http://ëëë.aser.revieë-al.org>
2. Artikujt do të pranohen për tu shqyrtuar për botim në numrin e radhës së revistës në se dërgohen jo më vonë se 1 muaj përpara mbylljes së tremujorit respektiv.
3. Artikulli nuk duhet të jetë më i shkurtër se 2.500 fjalë dhe zakonisht jo më i gjatë se 4.000 fjalë.
4. Artikulli duhet të jetë i shkruar në MSËord.
5. Artikulli duhet të ketë një strukturë relativisht standarte. Ai duhet të përmbajë një pjesë të shkurtër dhe koncize në formën e hyrjes dhe të jetë i ndarë në çështje dhe nënçështje. Në fund të artikullit duhet të ketë konkluzione dhe rekomandime.
6. Në artikull është shumë e rëndësishme referimi i burimeve bibliografike në formën e literatures se konsultuar. Ajo duhet të jetë e renditur sipas mbiemrit të autorëve; titullit të botimit, vitit, etj (P.sh. Kodra, A., “Probleme të ekonomive në tranzicion”, Revista Shqiptare Social Ekonomik Nr. 1 (5), 2011, Tiranë, 2011)
7. Tabelat statistikore duhet të kenë titullin dhe numrat e tyre në një rend vijues. (P.sh. Tabela 4. Numri i popullsisë në Shqipëri)
8. Grafikët duhet të kenë titullin dhe numrat e tyre, ku numërimi të bëhet me numra arab, pavarësisht nga numri i tabelave, dhe në rend vijues. (P.sh. Grafiku 4. Struktura e popullsisë sipas gjinisë)
9. Bëni përpjekje të eliminoni tabelat në formate të mëdha. Është e këshillueshme që tabela të tilla të përfshihen në material vetëm kur gjykohen tepër të domosdoshme dhe në një aneks të artikullit duke e referuar në tekst.
10. Artikulli duhet të përmbajë trajtimin e problemeve praktike të ekonomisë shqiptare në tranzicion minimalisht në masën 40%.
11. Artikulli duhet që të ketë të dhëna relevante që i përkasin një periudhe jo më tepër se një vit nga periudha aktuale.
12. Artikulli duhet të mos ketë gabime gjuhësore dhe të punohet patjetër duke përdorur shkronjat ë dhe ç.
13. Në rastet kur përdoren footnotes ato duhet të vendosen me numërim të automatizuar “auto Number”.
14. Artikulli duhet të shoqërohet patjetër me një përmbledhje në gjuhën angleze, e cila duhet të jetë midis 150-250 fjalë.

Artikulli do të pranohet si i mundshëm për tu gjykuar për botim vetëm pas përmbushjes strikte të kushteve të mësipërme. Për çdo artikull do të ketë recensa, vërejtjet themelore të së cilave janë të detyrueshme për tu reflektuar përpara botimit.

Në bazë të politikës së ndjekur nga bordi i revistës dhe të raporteve në trajtimin e temave të ndryshme, stafi i revistës ruan të drejtën për spostimin në kohë të botimit të artikujve të ndryshëm.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe duke pritur bashkëpunimin tuaj të frutshëm!

Redaksia

REPUBLIKA E SHQIPERISE
 MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES
 Drejtoria e Kerkimit Shkencor
 Tel/Fax: + 355 42 40468
 E-mail: magim@rotary.org.al

1379
 Nr. Prot.

Tirane, 23.04.1999

Lenda. Miratim periodiku shkencor

Qendres shqiptare për kërkime ekonomike

Ne pergjigje te shkrese suaj date 9.04.1999, Komisioni i Rikonsiderimit te Periodikeve Shkencore prane Drejtorise sone, ju tjofton, se ne mbledhjen e tij te dates 23.04.1999, mori vendimin, qe periodiku Ekonomia dhe Tranzicioni, i botuar prej jush, te konsiderohet periodik shkencor, per tu marre ne konsiderate nga Komisioni i Kualifikimit Shkencor

DREJTORI

Agha M. KROZI



Per dijeni,

- Universiteteve/ Fakulteteve Ekonomike
- Organizatave Jo-qeveritare Ekonomike
- Akademi se Shkencave / Inst. Shkencore
- Ministrite dhe Institucionet Qendrore
- Parlamentit / Komisionit Ekonomi-Finance-Privatizim, Komisionit te Punes dhe Ceshjteve Sociale